


KONTRIBUTI
I SHQIPTARËVE
NË DITURITË ISLAME

Hasan Kaleshi




© LOGOS·A

S H K U P

PRISHTINË

T I R A N Ë

2 0 1 3



LOGOS·A

Hasan Kaleshi
KONTRIBUTI I SHQIPTARËVE NË DITURITË ISLAME

Boton: LOGOS-A
Biblioteka: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Pasthënie: Nexhat Ibrahim
Redaktor gjuhësor: Nazif Zejnullahu
Redaktor artistik & diseni: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Halil Berisha
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus Print - Shkup

ISBN 978-9989-58-479-4


www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2013

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

KONTRIBUTI I SHQIPTARËVE NË DITURITË ISLAME

Hasan Kaleshi



PËRMBAJTJA:

| | |
|---|------------|
| HYRJE | 7 |
| I. POEZIA | 17 |
| II. POEZIA E TEQEVE | 37 |
| III. HISTORIOGRAFIA | 47 |
| IV. DISIPLINAT SHKENCORE | 65 |
| V. GRAMATOLOGJIA DHE LEKSIKOGRAFIA | 79 |
| VI. PUBLICISTIKA | 85 |
| VII. LETËRSIA E MEMOAREVE | 103 |
| | |
| PËRFUNDIM | 111 |
| | |
| LITERATURA KRYESORE | 112 |
| | |
| PASTHËNIE | 113 |

HYRJE

Qysh nga koha e Rilindjes e këndej, në shumë shkrime të shqiptarëve, qofshin në gjuhën shqipe apo në gjuhë të huaja, përfshi dhe turqishten, kur flitet për popullin shqiptar dhe të kaluarën e tij historike përmenden njerëz të shquar të lindur nga gjiri i tij: afër njëzetepesë sadrazema (vezirë të mëdhenj, kryeministra), shumë vezirë e pashallarë, e njëkohësisht edhe shumë shkrimtarë, poetë e dijetarë me origjinë shqiptare, të cilët kanë shkruar në gjuhët orientale¹, e kryesisht turqisht. Mirëpo, deri më sot, thuhet se kurrkush nuk ka bërë ndonjë përpjekje më serioze që këta së paku të regjistrohen, qoftë edhe përciptazi. Vetëm autori i këtij punimi, me dy raste, ka ofruar një pasqyrë të autorëve nga Kosova që kanë shkruar në gjuhët orientale². Prandaj, mund të themi se gjurmimet tona në këtë drejtim nuk janë ende as në fazën fillestare. Në “Historinë e letërsisë shqipe” (botim i Prishtinës, fq.191) për këtë letërsi dhe për këta letrarë thuhet sa vijon:

“Si e pamë më sipër, në shekujt e parë të pushtetit turk, u zhvillua në Shqipëri një letërsi shqiptare në gjuhët turqisht e arabisht. Edhe në këtë letërsinë turke u shquan mjaft shqiptarë.

Në shekullin XV la emër me një Divan Mesihî Prishtina, në shekullin e mëpasme Jahje bej Dukagjini. Në *Divanin* e tij

¹ Kur themi *gjuhët orientale*, mendojmë për arabishten, persishten e turqishten.

² Krah. Hasan Kaleshi, Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda, “Gjurmime albanologjike” I, Prishtinë 1965; i njëjti: Autorët e Kosovës në gjuhët orientale, “Kosova dikur e sot”, Ekonomska politika, Beograd 1973. Për disa autorë shqiptarë nga Maqedonia kemi shkruar shkurtimisht në punimin “Neki problemi Izučavanja kulturne istorije Pologa za vreme turskog perioda”, Bigorski naučno-kulturni sobiri 1971, Shkup, 1973. Për veprat e disa autorëve, si p.sh. të Samiut, Naimit, dr. Ibrahim Temos, kemi shkruar punime të posaçme.

turqisht, ku mburret me origjinën e vet shqiptare: ‘e sojit të shqiptarit është origjina ime’, aty-këtu shpreh ndonjë shprehje mërie kundra turkut, pushtuesit të Shqipërisë... ‘i merr një turku të egër vajzën’. Po nga ajo familje në shekullin XVI shquhet me një *Divan* edhe Ahmet bej Dukagjini.

Vetë poetët që kishin mësuar nëpër medresetë dhe shkruanin divane turqisht ose persisht nisën të shkruajnë poezi shqip për publikun që kishte kaluar nëpër mektebet, që ishte familjarizuar deri diku me temat, gjinitë dhe stilin e letërsisë orientale, po s’ishte në gjendje t’i kuptonte aq mirë e t’i shijonte d.m.th. për feudalët, klerin, shtresën e pasur tregtare. Pranë kësaj letërsie të shkruar në fillim zakonisht në një gjuhë tepër të përzier me fjalë turke, arabe e perse, vijoi të lëvrohet në Shqipëri edhe letërsia shqiptare turqisht. Nezimi, poet i parë i rëndësishëm i letërsisë së re, shkroi edhe dy divane turqisht. Në fillimin e shekullit XIX shquhet Haxhi Et’hem bej Tirana (1783-1846) me katër divane turqisht”.

Vetëm kaq! Nga ana tjetër, në të njëjtën vepër iu është kushtuar një kapitull humanistëve shqiptarë (fq. 129-142), sado që edhe ata nuk kanë shkruar në gjuhën shqipe, por latine apo italiane³. Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e letërsisë në gjuhët orientale është krejt laike, shkruar në shumicë nga laikë. Një pjesë e madhe e këtyre shkrimtarëve lindi dhe jetoi në vend, aty u shkollua, u mor me ndonjë zanat apo bëri punë nëpunësie, bashkëjetoi me fatin e popullit të vet. Në qoftë se i studiojmë si duhet veprat e tyre, do të gjejmë edhe një vulë të vendit dhe të rrethit ku jetuan dhe punuan, sado që një pjesë e tyre jetonin në Stamboll apo gjetiu. Përveç kësaj, pa e pasë studiuar rrën-

³ Kjo vlen, pak a shumë, për tërë letërsinë e Veriut dhe të Jugut deri në kohën e Rilindjes, shkruar me qëllime krejt fetare, kryesisht që të edukohet populli në frymë fetare që të ndalohet përhapja e mëtejshme e Islamit.

jësisht këtë letërsi, ne nuk kemi të drejtë të themi se krijuesit e saj ishin të shkëputur nga trualli i tyre, se kishin shkruar vetëm për shtresat e larta feudale e fetare, se nuk kishin ide mbi përkatësinë e tyre etnike. Përkundrazi, shumë veta prej tyre lindën nga shtresat më të ulëta, jetuan me to, me varfërinë e tyre. E përse i përket përkatësisë kombëtare, disa prej tyre e theksojnë haptazi prejardhjen e vet shqiptare. Kështu, Jahja bej Dukagjini në një vend thotë:

*Arnavudun haslari yegleri
Arnavud asli olbedir aslim*

*Nga më të mirët shqiptarë
Raca shqiptare është raca ime e ndritshme*

*Nesl-i kadim Dukagin begleri
Kiliçla derilur neslim*

*Të parët e mi kanë qenë princa të Dukagjinit
E gjithë familja ime jeton nga shpata.*

Jahja beu jetoi në shekullin XVI. Edhe në atë kohë edhe më vonë, vazhdimisht, nëpër kronikat turke gjejmë vepra biografike, të shkrimtarëve apo të dinjitarëve të lartë të Perandorisë, se ky apo ai shkrimtar, ky apo ai vezir, është me origjinë shqiptare. Vallë, përse? Me siguri nga shkaku se vetë shqiptarët nuk e kanë mohuar prejardhjen e tyre. Se, të ishte me origjinë shqiptare, nuk ishte kurrfarë fyerje, por, përkundrazi, ishte edhe nder. Zaten edhe më vonë, në shekullin XIX e XX, kur kemi edhe konflikte të rënda midis pushtetit osman dhe shqiptarëve, shumë njerëz të shquar me origjinë shqiptare nuk e mohonin origjin-

ën e tyre, por këtë e thoshin haptas. Kështu, poeti i madh dhe filozofi dr. Riza Teufiku, me origjinë nga Dibra, për të cilin do të flasim më poshtë, në një vend thotë:

*Bilmehen varsa bilsin herkes
Babam Arnavut Anam çerkes*

*Kush nuk e di, tash le ta dijë.
Babën e kam shqiptar, nënën çerkeze.*

Mehmet Akifi, nga një katund i Pejës, poet i madh dhe autor i himnit kombëtar turk, më 1913 i shkroi këto vargje:

*Benden bunu duyunuz, ben ki evet Arnavudum
Baska bir sey diyemem iste perisan yurdum*

*Dëgjoje këtë prej meje: po, unë jam shqiptar
Tjetër s'kam ç'të them; ja, u shkatërroua atdheu im.*

Këta pak shembuj provojnë qartë se shumë shqiptarëve, sado që të inkorporuar krejtësisht në shoqërinë osmane, në kulturën dhe mënyrën e jetesës orientale, madje disa edhe krejtësisht të asimiluar, nuk iu mungoi vetëdija kombëtare. Një fenomen i këtillë nuk mund të gjendet midis popujve të tjerë, me përjashtim, deri diku, të boshnjakëve. E, nga ana tjetër, mund të themi lirisht se shqiptarët janë të vetmit të cilët nuk i kanë kushtuar kurrfarë rëndësie kësaj letërsie, madje u kushtojnë dhe u kanë kushtuar më pak vëmendje se sa u kushtohet shqiptarëve orientale nga terreni i Serbisë dhe i Maqedonisë në shkencën serbe dhe maqedonase, sado që ata nuk kanë qenë as serbë as maqedonas. E unë, me përgjegjësi të plotë, e theksoj se roli i shqiptarëve në

letërsitë orientale është më i madh se ai i boshnjakëve; vetëmse, boshnjakët i kanë studiuar shkrimtarët e tyre⁴, e ndër ne kjo punë merret me nënçmim, të mos themi me përbuzje.

Gjurmimi rreth kësaj teme, megjithëqë premtion rezultate të reja shkencore dhe hap rrugë të panjohura kërkimore dhe i jep një dimension të ri kulturës sonë, është tejet i komplikuar dhe i gërshetuar me një varg vështirësish. Është e vërtetë se në bazë të veprave të botuara, pikësëpari në sajë të enciklopedive, të biografive të botuara të poetëve (*tezkiretu s'su'ara*), të historive të letërsisë së divaneve të botuara, katalogjeve etj., mund të bëhet një pasqyrë, mbetet si problem shfrytëzimi i këtyre veprave, sepse ato nuk gjenden këtu. Kështu, mbetet si e vetmja mundësi puna në Stamboll. Mirëpo, kjo vlen vetëm për ata të cilët përmenden nëpër burimet e cekura. E, nëpër bibliotekat e Stambollit, sidomos në Sulejmanije, Bajazit dhe në Bibliotekën Universitare, si dhe në Bibliotekën Kombëtare të Ankarasë, ndodhen ndoshta 50.000 dorëshkrime të painventarizuara dhe për to nuk ka kurrfarë katalogu. Kush mund t'i kontrollojë të tëra këto dorëshkrime dhe t'i kërkojë autorët me origjinë shqiptare? Unë kam bërë prova dhe kam kërkuar sipas mbiemrave

⁴ Krhs: p.sh. Safet-beg Bašagić, Bošnjaci i Hercegovci u islamskoj knjizevnosti, Sarajevë, 1912; I njëjti: Znameniti Hrvati, Bošnjaci i Hercegovci u Turskoj carevini, Zagreb 1931; Mehmed Handžić, Rad bos. herc. *Muslimana na knjizevnom polju*, "Glasnik Islamske vjerske zajednice" për vitet 1933 dhe 1934; Hazim Šabanović, Knjizevnost muslimana BiH na orijentalnim jezicima, *Svetlost*, Sarajevë, 1974, 726 f. (Biblioteka: Kulturno nasljedje); Smail Balić, Kultura Bošnjaka – Muslimanska komponenta, Wien 1973. Balić ka botuar një seri artikujsh gjermanisht mbi shkrimtarët boshnjakë në letërsinë turke në revistat austriake *Osterreichische Ost-hefte* dhe *Donau-Raum*, duke e bërë të njohur këtë letërsi edhe në qendrat ndërkombëtare. Në kohët e fundit ka filluar gjurmimi i kësaj letërsie edhe në Serbi (Radmila Tričković, *Islamske škole u našim zemljama*, "Istorija škola i obrazovanja kod Srba", Beograd, 1974), dhe në Maqedoni (Istorija na makedonskiot narod, I, f.315-330). Kjo letërsi në Bosnjë merret si integrale, e kulturës dhe e traditës letrare të boshnjakëve.

Janjâvî (Janinas), Ilbasânî (Elbasanas), Perzerînî (Prizrenas), Pristineli (Prishtinas), Iskodralî (Shkodran) dhe kam gjetur afër dhjetë veta që nuk përmenden në asnjë katalog, as në ndonjë burim tjetër. Nga ana tjetër, dihet se në disa biblioteka të mëdha botërore (Vjenë, Berlin, Paris, Londër, Vatikan, Leningrad ekzistojnë koleksione të pasura dorëshkrimesh orientale, për të cilat, pjesërisht, kemi katalogje të botuara, disa herë në dhjetëra vëllime. Gjurmimet rreth kësaj teme kërkojnë që të kontrollohen këto katalogje, madje edhe vetë koleksionet. Kush do të besonte, për shembull, se një dorëshkrim i “Vehbijes” se Tahir Boshnjakut, e sipas mendimit tim autografi, të ndodhet në koleksionin e dorëshkrimeve orientale të Bibliotekës Kombëtare të Vjenës?

Mirëpo, kjo vlen vetëm për ata shkrytarë me origjinë shqiptare të cilët kanë pasur fatin të jetojnë në Stamboll dhe të përmenden në ndonjë burim nga ana e bashkëkohanikëve të tyre ose që dorëshkrimet e tyre të kenë zënë vend në ndonjë bibliotekë të Stambollit apo të Evropës. Përveç tyre, ne kemi pasur ndoshta qindra njerëz, shumica të panjohur, të cilët kanë jetuar nëpër vendet e ndryshme në Ballkan, nëpër vendlindjet e tyre, kanë shkruar vepra, ndoshta jo më pak të vlefshme se bashkatdhetarët e tyre në Stamboll, por veprat e tyre nuk janë përmendur kurrkund, ato ose janë zhdukur ose gjenden edhe sot të mbuluara me pluhur në ndonjë tavan. Ne sot nuk jemi në gjendje të imagjinojmë se sa njerëz të ditur ka pasur ndër vendet tona, sa vepra të shumta janë shkruar⁵, sa ditarë qytetesh të

⁵ Se deri në ç’skallë një shtresë qytetare është familjarizuar me këtë letërsi, mund të shihet qartë nga disa pjesë të udhëpërshkrimeve të Evlija Çelebisë, i cili thotë se Elbasanin e kanë quajtur *dâr sh-shu’arâ* (qytet poetësh), se Berati kishte në atë kohë gjashtë kafene ku zhvilloheshin diskutime letrare dhe shkencore. Ashik Çelebiu, autor i një biografie të famshme të poetëve (shek.XVI), i cili kishte lindur në Prizren, thotë se prizrenasit qysh para se të lindnin djemve iu jepnin një ofiq poetik (mahlas).

ndryshme janë plaçkitur, gërmuar në tokë apo djegur “*që të mos shkilet jazija, qitapi*”. Jam i vetëdijshëm se shumë dorëshkrime janë zhdukur në mënyrë të ndryshme, është zhdukur një fond i çmueshëm i historisë së kulturës sonë. Por, ajo që është më e dhimbshme, është fakti se edhe sot nuk kemi bërë asnjë përpjekje që t’i shpëtojmë ato vepra që kanë mbetur, që të krijojmë pranë ndonjë biblioteke një koleksion librash orientale, ashtu si kanë bërë në Sarajevë me Bibliotekën e Husref beut, e cila sot numërohet ndër koleksionet më të bukura të dorëshkrimeve orientale në Evropë dhe është bërë qendër e studimeve të kulturës së boshnjakëve gjatë periudhës osmane. Pra, që tema jonë mbi shkrimtarët me origjinë shqiptare në letërsinë orientale të mund të rrumbullakohet deri diku, kërkohet edhe një punë e madhe në terren, të bisedohet me njerëz, të fitohet besimi i tyre, të bëhet kontrollimi i dorëshkrimeve të pluhurosura, leximi e përshtkrimi i tyre etj. Si shembull do të përmend faktin se rastësisht e kam gjetur dhe fotografuar një pjesë të *Divanit* të Axhize babës në Gjakovë, dorëshkrimi i cili sot nuk gjendet kurrkund; kam në dorë dy vepra arabisht të kopjuara nga njëfarë Osmani, i biri i Jusuf Gjakovës, pastaj kam një vepër të njëfarë Abdullah efendi Belegut me titull “*Tarihu l-vekai*” (Historia e ngjarjeve), ku kemi të dhëna tejet interesante mbi personat dhe ngjarjet e ndryshme në Pejë nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX.

Një problem tjetër i rëndësishëm, i cili gjatë gjurmimeve kërkon një kujdes të veçantë, e mbi të gjitha një qëndrim objektiv, është çështja e identifikimit etnik të letrarëve. Kjo për arsye se një shkrimtar nga Shkupi apo Manastiri mund të jetë edhe shqiptar, edhe turk, por ka mundur të ketë qenë edhe sllav, sepse kemi edhe sllavë të zënë rob ose të marrë si devshirme që kanë bërë karrierë ushtarake apo letrare. Prandaj, kriteri i

parë është burimi turk, ku shpesh përmendet përkatësia kombëtare e autorit. Si kriter i dytë është vendlindja e autorit apo të jatit, d.m.th. kriteri gjeografik. Nëse është me origjinë nga Korça, Tirana, Shkodra, Janina, Gjakova, Dibra, Elbasani, pra nga vendet ku sipas burimeve të mia në kohën e poetit kanë qenë me shumicë dërrmuese shqiptare, unë e kam marrë si shqiptar. Përsa i përket një numri të madh shkrimtarësh nga Maqedonia, ata i kam marrë si të tillë vetëm nëse në burim përmendet si shqiptar, ose kur, fjala vjen në shekullin XIX, e di se në këtë apo atë mënyrë ka qenë i angazhuar në Lëvizjen shqiptare, si p.sh. Dervish Hima nga Ohri, Dr. Ibrahim Temo nga Struga, Rexhep Voka nga Tetova, Ali Jusuf Albani nga Kërçova etj. Ne me të vërtetë nuk kemi nevojë të marrim kurrgjë nga historia apo kultura e të tjerëve- mjafton që t'i studiojmë ata që na takojnë neve. Këtij parimi unë i jam përmbajtur në mënyrë rigorozë. Ndoshta në listën tonë ka hyrë ndonjë për të cilin nuk jemi krejtësisht të bindur se është shqiptar, por në raste të këtilla këtë gjë e kemi vënë në pah.

Në këtë kuadër, nuk do të jemi në gjendje të japim një pasqyrë më të plotë të shqiptarëve në letërsinë orientale, ose më mirë të themi, nuk do të mund t'i japim të gjitha ato rezultate të cilat i kemi arritur deri sot, nuk do të mund t'i citojmë të gjitha veprat e shkrimtarëve të ndryshëm, nuk do të mund t'i përmendim katalogjet në të cilat përmenden dorëshkrimet, nuk do të mund ta japim literaturën mbi ta, madje, siç do të shihet, për disa do të japim të dhëna më të hollësishme, sepse thuajse për ta gjurmimet i kemi kryer, kurse për disa duhet t'i vazhdojmë. Natyrisht se disa shkrimtarë meritojnë shumë vend; për ta ka shumë burime, kurse disa meritojnë më pak; burimet për ta janë të kufizuara, shpesh përmenden me disa fjali vetëm në një burim. Prandaj, ky punim duhet të konsiderohet më tepër si

një koncept për një vepër më voluminoze sesa si një punim i kryer. Njëkohësisht, ky punim do të shërbejë si një pikënisje për gjurmime të mëvonshme.

Për arsye praktike, shkrimtarët nuk do t'i japim sipas rendit alfabetik, por sipas gjinive letrare dhe disiplinave shkencore, duke iu përmbajtur, deri diku, edhe kriterit kronologjik. Gjithash-tu, fusnotat dhe citimet e burimeve janë reduktuar në minimum.

I. POEZIA

Në mesin e të gjitha gjinive letrare dhe disiplinave shkencore që kultivoheshin në atë kohë shqiptarët u dalluan më së shumti në poezi. Shqiptarët i kanë dhënë poezisë osmane disa poetë, të cilët i vunë një vulë epokës së tyre, futën një frymë të re në poezinë osmano-turke, treguan një origjinalitet të vetëm dhe hapën rrugë të reja. Historiani i njohur i poezisë osmane, anglezi Gibb, për disa nga këta thotë se “ata futën një origjinalitet në poezinë osmano-turke, sepse ishin shqiptarë, d.m.th. evropianë”⁶. Për shkak se nëpër teqetë e tarikateve të ndryshme ishte zhvilluar një poezi e cila mbante një vulë të posaçme dhe janë përfaqësuar në të shumë shqiptarë nga teqetë e vendeve të ndryshme, kësaj poezie do t'i kushtohet një kapitull i veçantë.

Jahja bej Dukagjini. – Në bazë të burimeve të shumta, mund të vërtetohet se Jahja beu është marrë nga Shqipëria si djalë i krishterë dhe është futur në oxhakun e jeniçerëve. Se rrjedh nga origjina shqiptare, e thonë të gjitha burimet; madje, sikurse e pamë më lart, atë e thotë edhe vetë. Mirëpo, mbetet e panjohur vendlindja e tij. Nuk dimë në bazë të çfarë burimi Latifi, Ibrahim Nexhmi dhe Mual-lim Naxhi si vendlindje të tij përmendin Tashlixhen dhe prandaj e quajnë Tashlixheli Dukagjini zade Jahja bej. Nga ata e kanë marrë këtë mbiemër edhe disa të tjerë. Mirëpo, të gjitha këto janë të gatuara, për shkak se, sipas gjurmimeve të fundit, Jahja beu vetëm kishte qëndruar një kohë në Tashlixhe, në një çiflig. Madje, edhe Bursali Mehmet Tahir (Osmanli Muellifleri, II 497) e ka korrigjuar qysh me

⁶ Gibb, *A History of Ottoman Poetry, II*, Londër, 1902, faqe 16 e në vazhdim.

kohë, duke thënë se ai do quajtur vetëm Gugagjinzade, si e shënon ai vetë mbiemrin e tij. Në oxhakun e jeniçerëve Jahja beu përparon shpejt dhe ngarkohet t'i edukojë jeniçerët e rinj. Në këtë punë ai tregon aftësi të madhe, i përvetëson maniret e bujarëve, gjë që i hap rrugën e depërtimit në rrethet aristokratike të Stambollit. Eprori i tij, njëfarë Shibaudin beu, duke i parë aftësitë e tij për letërsi, i linte mjaft kohë të lirë që t'u kushtohet studimeve për letërsi, i linte mjaft kohë të lirë që t'u kushtohet studimeve letrare. Për një kohë të shkurtër kasidet e tij u bënë mjaft të njohura. Përveç kësaj, Jahja beu u dallua edhe me trimëri. Trimërinë e tregoi edhe në një rast: Dihet mirë se Sulltan Sulejmani, i shtyrë nga gratë e oborrit dhe nga intrigat e ndryshme, e vrau princ Mustafën, i cili ishte tejet popullor edhe në ushtri. Jahja beu hartoi një elegji kushtuar Princit, e cila së shpejti u përhap kudo. Veziri i madh, Rustem pasha, e thirri Jahja beun dhe e pyeti se si kishte guxuar të shkruante elegji për dikë të cilin e kishte dënuar Sulltani. Jahja beu u përgjigj: "Ne e dënuam Princin bashkë me Sulltanin, por e vajtua bashkë me popullin." Veziri i madh, i cili ishte armik i poetëve, bëri çmos që t'i mbushte mendjen Sulltanit që t'i priste kryet Jahja beut, por ai s'pranoi. E vetmja e keqe që mund t'i bënte veziri i madh ishte që ta shkarkonte nga detyra. Atëherë poeti u tërhoq në një çiflik në sanxhakun e Zvornikut, në Bosnjë, ku në vitin 1575 e takoi historiani i madh Ali. Jahja beu në atë kohë ishte plak 80-vjeçar dhe e përfundonte divanin e vet. Vdiq më 1576¹. Ali na njofton se i biri i poetit, Adem Celebi, ia solli parathënien e divanit, meqenëse dëshira e poetit ishte që Aliu t'ia lexonte e t'ia vlerësonte parathënien. Sipas disa burimeve, nuk

⁷ Sipas Sami Frashërit (Komus-ul-a'lam, VI, s.v.), Jahja bej ka vdekur 9 vjet më vonë në vendlindjen e vet, por nuk e thot emrin e vendit.

vdiq në Bosnjë, por nga Zvorniku kaloi në vendlindjen e vet (nuk thuhet se cila është), ku vdiq.

Poezia e Jahja beut nuk është më pak interesante se jeta e poetit. I lartpërmenduri Gibb thotë se “nga të gjithë të huajt, domethënë joturq, qofshin aziatë apo evropianë, të cilët guxuan të shkruajnë poezi turke, vetëm ai zë një vend me vlerë të vërtetë. S’ka gjë në gjuhën e tij që do të tregonte se nuk ishte turk i lindur. Ka një thjeshtësi, fuqi dhe orgjinalitet të përcaktuar në mënyrën e të shkruarit të tij që e ndan rrënjësisht nga poetët më të mëdhenj të asaj kohe, Zati dhe Hajali, të cilët ishin bashkëkohanikët e tij”. Për ta kuptuar origjinalitetin e tij duhet të theksojmë se e tërë poezia e divaneve ndjek gjurmët e mjeshtrëve persianë, këndon mbi motivet e shfrytëzuara nga arabët e persianët, këndon të ashtuquajturat motive islame, me ç’rast sa më i madh të ishte imitimi i klasikëve persianë, aq më tepër lavdërohej poezia e ndokujt. Jahja beu nuk deshi të ishte vetëm epigon; ai nuk do të jetë vetëm përkthyes – siç thotë vetë. Madje, edhe në poemën “Jusufi e Zulejhaja”, aq të kënduar në letërsinë persiane, arabe e turke (e dimë se edhe Firdusi e kishte shkruar një poemë mbi këtë tregim kur’anor e bibliq), ai është origjinal, e rrëfen tregimin në mënyrë krejt specifike, siç thotë edhe vetë:

Ky libër fisnik

Ky xhevahir urtësie

Është krijesë e fantazisë sime

Sepse përkthimi s’i përshtat dot fjalët,

Unë kurrë s’i kisha vënë në gojë

Fjalët e njeriut të vdekur.

Në veprën “Usulname” (Libri i parimeve) ai thotë:

*Unë s’i kam përkthyer fjalët e tjetërkujt
S’kam përzier fjalët e huaja në vjershën time.*

*Gjuha ime nuk është përkthyesë e persianëve,
Unë nuk e ha bukën e persianëve të vdekur.*

Në veprën “Sah-u Geda” (Shahu dhe lypësi) ai përsëri thotë:

*Ky libër nuk ka në vete pupla të huaja,
Në të nuk ka fjalë përkthimi*

*Kurrë gjë s’kam marrë nga tjetërkush,
Zoti e di, ndoshta ka përkime,*

*Qoftë të fantazisë, qoftë gjëra të mira apo të këqija,
Por, ky libër është imi; është trishtimi im.*

Jahja beu kishte shkruar pesë poema të mëdha dhe një divan (përmbledhje poezish të ndryshme). Në të gjitha këto vepra fantazia gërshetohet me realitetin, eksperiencia me mjeshtrinë poetike.

Sado që Jahja beu ka hyrë në të gjitha antologjitë e poezisë së divaneve dhe numërohet si një nga poetët e mëdhenj të klasicizmit turk, vlefata e tij shtohet gjithnjë e më tepër në kohët e fundit. Kështu, gjurmuesi i poezisë turke M. Çavusoglu është duke i përgatitur për shtyp të gjitha veprat e tij. Sipas fjalëve të tij, Jahja beu është pa kurrfarë dyshimi poeti më i madh dhe më origjinali i klasicizmit turk (koha e sulltan Sulejmanit). Një fotokopje e divanit të tij ndodhet në Arkivin e Kosovës.

Prishtinasi Mesih. – Për Mesihun nga Prishtina (Pristinali Mesih) thuhet se është lindur në Prishtinë më 1470. Vetë mbiemri i tij e tregon se është nga Prishtina dhe thuhet se është me origjinë shqiptare. Duhet të ketë kryer ndonjë medrese këtu në Kosovë apo në Maqedoni, e pastaj ta ketë vazhduar medresenë edhe në Stamboll. U dallua në kaligrafi. Pasi i kreu studimet, hyri në shërbim të vezirit të madh Hadim Ali pasha, si sekretar i tij. Në këtë detyrë mbeti deri në vitin 1511, kur u vra Ali pashai. Vdiq në Bursë më 1512. Ka lënë pas vetes një divan (përmbledhje) vjershash, që merret si shkalla më e lartë e poezisë turke të asaj kohe, kurse vetë turqit e konsiderojnë si lirikun më të madh para Bakisë, Fuzulisë dhe Jahja bej Dukagjinit. Ai hartoi edhe një vepër me titull “Sehregiz” (e cila është vepra e parë e poezisë humoristike në letërsinë turke). Pas këtij, kjo gjini u bë shumë popullore dhe lindën një varg epigonësh të rinj. Mirëpo, famën botërore Mesihu e fitoi me vjershën me titull “Kënga e pranverës” (Behariye), e cila është vjersha e vetme e poezisë turke e cila ka hyrë në antalogjitë e poezisë botërore. Qysh në vitin 1774 orientalisti anglez Ser Vilijam Xhons e futi këtë vjershë në një përmbledhje, “Vjersha të Azisë”, përkthyer latinisht. Në vitin 1787 këtë vjershë e ribotoi Toderini në veprën e vet “Letteratura turchesca”, botuar në Venedik, mandej pasuan dy përkthime në gjuhën gjermane, një nga Viland dhe një nga Hammer Purguhtal. Dora D’Istria, të cilën e njohim edhe për nga interesimi i saj për letërsinë popullore shqiptare, e përktheu në gjuhën franceze, Misho e futi në biografinë e përgjithshme, Resheri dhe Annemari Shimel e përkthyen përsëri në gjuhën gjermane dhe më në fund Ettore Rossi në gjuhën italiane e botoi në “Oriente Moderno”, pak para vdekjes. Para afër dhjetë vjetësh hyri në një an-

tologji gjermane të vjershave më të bukura të poezisë botërore “Orfej”. Fehim Bajraktareviqi para dhjetë vjetësh e përktheu në gjuhën boshnjake. Edhe kjo vjershë e Mesihut dallohet nga vjershat e kohës. Ajo është refleksi i plotë i ndjenjave dhe idealeve jetësore të Mesihut; ajo na e paraqet Mesihun e vërtetë, i cili ndodhej rrallë në vendin e punës, më shpesh nëpër kafenetë e bahçet, e kjo është refleksi i një botëkuptimi anakreon, fahizian. Si e tillë, duke pasur një notë të përgjithshme humaniste, munda t’i kalonte kufijtë e Turqisë. Ja vetëm disa vargje:

*Dëgjo si këndon bilbili; ja, erdhi pranvera,
Në çdo bahçe lulet çelën; ja, vallja si po merr.*

*Dhe prej drurit të bajames behari vjen fluturim,
Pij dhe bëj qejf, se shpejt kalon ky zgjim.*

Prizrenasi Suzi. – Në anën e majtë të Bistricës, në Prizren, ndodhet një xhami e cila mban emrin e Suziut. Pranë xhamisë ndodhet edhe një krua, pastaj një urë e ndërtuar gjithashtu nga Suziu, si dhe një ndërtesë e cila kishte qenë shkollë, në të cilën mbante mësim vetë Suziu, poet i madh nga fundi i shekullit XV dhe fillimi i shekullit XVI. Prapa xhamisë ndodhet një tyrbe e shkatërruar, në të cilën ndodhen varret e Suziut dhe të të vëllait Neharit, i cili ishte gjithashtu poet. Në një gur ndodhet mbishkrimi arabisht mbi vdekjen e tij, i cili thotë:

“I ndjeri Suzi Prizrenasi vdiq më datën 931 (1525)”.

Ndërtuesi i këtyre objekteve, Suzi Prizrenasi, është një figurë shumë interesante, si nga pikëpamja letrare, ashtu edhe nga pikëpamja historike. Mbi origjinën e tij nuk mund të thuh-

et gjë me siguri: mund të ketë qenë edhe shqiptar, edhe turk, edhe serb. Në shkencën evropiane të dhënat e para mbi të i dha Hammer Purgstall në veprën e vet “Geschichte der Osmanischen Dichtung”, e pastaj shkroi edhe Babingeri, i cili i dha thujtë të njëjtat të dhëna. Disa punime të mira mbi të i shkroi gjithashtu A.Olesnicki. Autori i këtij punimi, në një shkrim, gjithashtu i zgjeroi studimet mbi Suziun, duke dhënë dhënë edhe shënime të reja. Studimi i Suziut sot u bë më i lehtë, pasi u gjet dhe u botua dorëshkrimi i veprës së tij poetike “*Gazavatname-i Mihaloglu Ali Bey*” (Libri i pushtimeve të Mihaloglu Ali bej), vepër e cila ka 1.500 bejte (dyvargëshe). Të dhëna mbi rininë e tij kemi shumë pak. I ati quhej Abdullah, që provon se ishte i krishterë. Ka shumë gjasa të jetë marrë si jeniçer dhe të jetë dërguar në Stamboll, në sarajin mbretëror. Një kohë Suziu shërbeu si kadi (gjyqtar), e pastaj gjendet në shoqërinë luftarake të Mihaloglu Ali beut, një nga komandantët më të shquar të akinxhinjve turq dhe sekretar i tij. Mendohet se ky, Ali bej Mihaloglu, është Gjergj Elez Alija i këngëve popullore boshnjake dhe i këngëve kreshnike shqiptare. Çeta e tij luftarake bënte inkursione nëpër të gjitha vendet veriore në kufi me Austro-Hungarinë, depërtonte thellë në tokat e armikut, bënte vrasje e plaçkitje e pastaj tërhiqej. Kjo ishte taktikë turke, që të demoralizohej popullsia në prapavijën e armikut. Pas vdekjes së tij Suziu bëhet sekretar i Mihaloglu Mehmet beut. Më 1513 Suziun e gjejmë në Prizren, kur e legalizon një dokument mbi themelimin e një vakëfi. Duket se punoi si imam, vaiz e hatip në xhami dhe si mësues në shkollën që vetë e ndërtoi. Ka lënë edhe një varg dorëshkrimesh, midis të cilave gjejmë edhe vepra të mjeshtërve persianë. Vdiq më 1524/5.

Thamë se vepra e vetme që ka mbetur nga Suziu është “Libri i pushtimeve të Mihaloglu Ali beut”, i cili ka 1.500 bejte

(3.000 vargje). Vepra është e ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë përshkruhen fitoret e Ali beut kundër jomuslimanëve, kurse pjesa e dytë është një tregim romantik në vargje ku përshkruhet dashuria romantike e Ali beut me Merjemen, të bijën e një princi të Vllahisë. Veprat e Suziut kanë rëndësi jo vetëm letrare, por edhe historike, se ai përshkruan, në pjesën e parë, ngjarje të vërteta historike, në të cilat kishte marrë pjesë edhe vetë. Kështu p.sh. ai e përshkruan një depërtim të turqve në Srem në vitin 1458, kur u shkatërrua Mitrovica e Sremit. Në një pjesë tjetër përshkruan aktin heroik të Ali beut më 8 nëntor 1460, kur turqit korrën një fitore të shkëlqyeshme kundër hungarezëve dhe kur u zu rob Mihail Szylagy.

Në letërsinë turke kemi një varg veprash në të cilat lavdërohen pushtimet, të cilat quhen Gazavat-name, Zafer-name, Fetih-name – që do të thotë “libër pushtimesh”, “libër fitorësh”. Vepra e Suziut është vepra më e mirë poetike e kësaj gjinie dhe si të tillë atë e botoi shoqata filologjike turke². Ja disa mendime të Suziut mbi vanitetin e botës në lidhje me fatin e Mihail Szylagysë, i cili ra rob i turqve:

*Ruaju, mos i kalo kufijtë tu, se fati
të bën qesharak përpara njerëzve të botës.*

*Vëlla, bëhu i matur, mos e ngre lart kokën,
Qielli është gjakësor, çdo ditë shkurton nga një qafë.*

*Ec, por me kujdes, mos i zgjat shumë hapat,
Se në çdo hap ka mijëra pengesa e po ngatërrohesh!*

² Ağâh Sirri Levand. Gazavaât-nameler ve Mihaloglu Ali Bey'in Gazavât-nâmesi, Tütük Tarih Korumu, Ankara, 1956. Më shumë mbi këtë vepër: H. Kaleşi, Prizren kao kulturni centar...

*Mos ia hap botës kraharorin si mburojë
Se do bëhesh nishan i shigjetave qiellore,*

*Princ, mos mendo se përgjithmonë të mbetet kulltuku
Sepse Husrefit (mbret persian – H. K.) fati kurorën i zhduku!*

Duke qenë se e kemi fjalën për një poet nga Kosova, do të japim një pasqyrë edhe të një vargu poetësh të tjerë nga vendi ynë .

Nehar Prizrenasi. – Suziu e kishte vëlla Neharin, gjithashtu poet. Ai përmendet në shumë burime turke, ku gjejmë edhe nga ndonjë bejte (dyvargësh), por nga veprat e tij më të mëdha nuk ka mbetur kurrfarë gjurme. Nehari vdiq më 1522 dhe u varros afër Suziut.

Prizrenas Sa’ji. – Në shumë burime të asaj kohe përmendet edhe Prizrenasi Sa’ji, por të dhënat janë mjaft kontradiktore. Me siguri jetoi në shekullin XVI, në kohën e sulltan Sulejmanit. Ai la një vepër me titull *Ta’rîfat* (Definicione), ndërsa sipas Hammerit edhe një përmbledhje poezish, e cila nuk është gjetur. Sa’ji kishte hartuar edhe një vepër poetike mbi pushtimin e Beogradit nga ana e sulltan Sulejman Ligjvënësit me titull “Feth-i kal’ a-i Belgrad” (Pushtimi i kalasë së Beogradit). Mirëpo në atë kohë paraqitet edhe një Sa’ji tjetër dhe disa mendojnë se kjo vepër është nga ky i dyti.

Shem’i. – Në periudhën e famshme të sulltan Sulejmanit jetoi poeti mistik Shem’i, i lindur në Prizren. Ai shkroi shumë vjersha dashurie dhe alegorike. Disa bejte të tij përmenden në disa burime. Gjithashtu thuhet se në Stamboll ishte shoqëruar me poetin e madh prishtinas Mesih.

Texhel-li. - Është gjithashtu me origjinë nga Prizreni. Vdiq më 1689. Ai shkroi një divan vjershash që qe botuar dhe përfaqëson një kuriozitet të veçantë: në gjithë divanin, nuk ka përdorur asnjë germë me pikë përmbi germë apo nën të.

Divani e ka titullin “Binukat dîvân-i Tecelli” (Divani pa pika i Texhel-lit).

Behari. – Në dy burime turke përmendet edhe poeti Behari nga Prizreni. Në të njëjtat burime botohen edhe disa fragmente të shkurtra të vjershave të tij. Njëkohësisht, theksohet se ishte kalorës i aftë dhe poet i talentuar i vargjeve simbolike dhe alegorike. Mjerisht, të dhëna të tjera për të nuk kemi.

Axhize Baba. - Në vendin më të bukur të Prizrenit për piknik në kohën e Turqisë, në Marash, pranë Bisticës, deri më 1945 ka pasë qenë një nga teqetë më të bukura të Prizrenit. Afër teqesë është edhe një tyrbe. Në të është varrosur Sulejman efendiu, i quajtur Axhize Baba. Aty rreth vitit 1700 Axhize Baba, pas mbarimit të studimeve teologjike në Stamboll, erdhi në Gjakovë, ku e ndërtoi një teqe e cila është ruajtur deri më sot. Quhet “Teqja e madhe” dhe e përhapte tarikatit e sa’dive. Kur u rrit i biri, Danjalli, Axhize Baba e la Gjakovën dhe shkoi në Prizren, ku e ndërtoi teqenë e përmendur në Marash. Në burimet turke përmendet si *pîr-i sâni* (mjeshtër i madh i dytë) i tarikatit të sa’dive, d.m.th. vjen në vendin e dytë pas themeluesit të tarikatit, Sa’dudin Xhebavisë. Axhize Baba ishte edhe poet mistik. Ka lënë një përmbledhje vjershash (divan). Në disa burime thuhet se ka shkruar vjersha turqisht, persisht e arabisht, mirëpo në fotokopjet e divanit që ekziston edhe sot të gjitha vjershat janë vetëm turqisht. Pa dyshim se Axhize Baba, i cili qe një shqiptar nga një katund i Shkodrës, meriton t’i kushtohet një kujdes i veçantë.

Prishtinasi Buhari. – Në letërsinë turke kemi një varg vep-rash në të cilat lavdërohet pushtimi i Budimit (Budapestit). Një vepër të këtillë e kishte shkruar edhe prishtinasi Buhari me titull “Fetihnâme-i Budim” (Libër mbi pushtimin e Budimit). Vepra mbeti në dorëshkrim dhe ruhet në bibliotekën “Sulejma-nije” të Stambollit.

Mehmed Aqifi. – Peja i dha letërsisë bashkëkohore turke një ndër poetët më të mëdhenj – Mehmed Aqifin. Mehmed Aqifi lindi në Stamboll më 1873, kurse i ati, profesor i një shkollë të lartë teologjike në Stamboll, rrjedh nga katundi Shu-shicë i Pejës dhe prandaj është quajtur Ipekli (Pejani) Mehmed Tahir. Sado që i lindur në Stamboll, ku e kaloi rininë, Mehmed Aqifi, sikurse thamë në hyrje, ishte i vetëdijshëm se ishte shqip-tar, duke thënë “Bunu benden duyunuz, ben ki evet Arnavu-dum” (Dëgjojeni këtë prej meje, po, unë jam shqiptar). Mësim-et e para Mehmed Aqifi i mori nga i ati. Si i ri, e mësoi mirë arabishten dhe persishten. Mandej studioi në Shkollën e Lartë Administrative të Stambollit. E kreu edhe Fakultetin e Veteri-narisë. Në këtë shkollë ai e mësoi edhe frëngjishten dhe u entu-ziazmua nga poezia e Lamartinit, Ygosë dhe e Alfred de My-se. Prej vitit 1908 iu kushtua jetës letrare. Mehmet Aqifi është i pari në letërsinë turke i cili e zbriti poezinë nga sferat mbitokë-sore, e shliroi nga motivet e tashme stereotipe dhe mori t’i përshkruante ngjarjet nga jeta, rrugët, filloi të shkruante mbi të varfërit, lypësit, njerëzit e rrugëve. Prandaj vjershat e tij, të mbledhura në një vëllim të madh me titull “Safahat” (Periu-dha), janë botuar e ribotuar shumë herë. Veç kësaj, në kundër-shtim me një varg poetësh të fillimit të këtij shekulli, për të cilët është thënë se gjuha do t’i varrosë, sepse kurrkush nuk i kupton, Mehmet Aqifi shkruan me një gjuhë të thjeshtë, të ku-

ptueshme, kështu që shumë kritikë letrarë mendojnë se Mehmet Aqifi me vjershat e tij patriotike i dha një kontribut të madh revolucionit qemalist. Vjersha e tij “Istiklâl Marsi” (Marshi i Pavarësisë) është bërë himn kombëtar turk. Këtë vjershë Mehmet Aqifi e shkroi më 1921 dhe ministri i atëhershëm, shkrimtari dhe poeti Hamdullah Suphi, ia paraqiti Asamblesë së Madhe turke dhe ia propozoi për himn kombëtar. Me të lexuar, të gjithë deputetët u çuan në këmbë në shenjë nderimi dhe me brohoritje entuziaste e pranuan unanimitisht si himn kombëtar. Ja disa vargje nga ky himn:

Mos kij frikë, se nuk zhduket flamuri i kuq që valon në dritë të agimit.

Derisa të zhduket flaka e së mbramës vatër të atdheut tim,

Ai është ylli i kombit që do të shkëlqejë,

Ç’prej amshimit i lirë jetova, i lirë do të jetoj,

Cila është ajo fuqi që mua do të më lidhë, do të më pengojë,

Unë jam si një përrua i rrëmbyeshëm, q’i tejkalon pengesat,

Q’i çan malet dhe i shemb ndërtesat.

Abdurrahim efendi Prizrenasi. – Muhamed Nur al-Arabi kishte ardhur në Prizren kah fillimi i shekullit XIX nga Tanta e Egjiptit dhe kishte filluar ta përhapte tarikatën e melamijve. Në fillim në Prizren, e më vonë në Shkup e në Koçanë, ai kishte mbledhur rreth vetes shumë nxënës e dervishë. Një nga nxënësit e tij ishte edhe Abdurrahim efendiu, i cili kishte lindur në Prizren, ku i pati kryer edhe mësimet fillestare. Më vonë kishte shkuar në Shkup dhe kishte studiuar në një medrese. Aty, njëkohësisht, e kishte studiuar edhe mistikën islame të Muhammed Nur-al-Arabiut. Më vonë ishte bërë dhëndër dhe zëvendës i tij në tarikat. Jepte mësim në një medrese të Shkupit. Vdiq

në Egjipt, duke u kthyer nga haxhillëku dhe u varros në Ajin Musa, në brigjet e Suezit. Kishte shkruar një varg veprash poetike me motive mistike dhe kishte komentuar vepra të mistikut të madh arab Muhjidin al-Arabi. Veprat e tij numërohen në “Osmanli Müellifleri” 2, 38-39.

Këtë plejadë poetësh nga Kosova e kurorëzon *Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi* nga Prizreni - poet, shkrimtar, punëtor shoqëror dhe revolucionar. Ymer Lutfiu lindi në Prizren më 1871, u shkollua në Prizren, në Stamboll dhe në Kajro – në Universitetin e famshëm al-Az’har. Me 1905 u kthye në Prizren, ku filloi të zhvillonte një aktivitet jo vetëm letrar, por edhe shoqëror. Ai mori pjesë aktive në revolucionin xhonturk, por shpejt u zhgënjye nga politika nacionaliste e xhonturqve. Nuk pranoi të hynte në ndonjë shërbim shteti, por preferoi të jetonte njëkohësisht edhe detyrën e shehut. Ai shkruante me të njëjtën mjeshtri - edhe turqisht edhe arabisht, me të njëjtën lehtësi - edhe prozë edhe poezi. Vetëm një pjesë të vogël të vjershave dhe të artikujve i botoi në disa revista dhe fletore të Stambollit dhe të Shkupit. Nga Ymer Lutfi Paçarizi kanë mbetur afër 30 vepra në prozë dhe në poezi në gjuhën arabe dhe turke, nga të cilat më i rëndësishëm është *Divani* (përmbledhje e poezive). Shumica e veprave të tij-disa të kopjuara, disa autografe-ndodhen në Arkivin e Kosovës.

Selim Sirri pashë Tepelena. – Selim Sirri (në shumë burime vetëm Sirri) është i biri i Veli pashë Tepelenës dhe nipi i Ali pashë Tepelenës. Lindi më 1800 në Janinë. Pas vrasjes së të tatit, atë e sollën në Stamboll. Në disa burime shqiptare thuhet se turqit i morën të gjithë nipat e Ali pashë Janinës, i çuan në Stamboll dhe atje i mbytën. Përkundrazi, rasti i Selim Sirri pashës

provon të kundërtën. Për ta përgatitur për shërbime shtetërore, atë e dërguan në Er-zerum si nënpunës pranë valisë së Erzerumit dhe komandantit të Armatës lindore, Rauf pashës. Pas një kohe u kthye në Stamboll, ku iu dha grada civile “haxhegian” me një rrogë të madhe. Pastaj u dërgua si mutesel-lim në disa vende në Anadoll dhe Rumeli. Më 1829 u emërua sekretar në Ministrinë e Financave. Më vonë u dërgua në mision në Izmir, Bejrut dhe Vidin e pastaj në Erzurum si defterdar (shef i financave) të vilajetit, i ngarkuar me mision ta bënte riorganizimin e administratës financiare të vilajetit. Më 1846 u emërua kajmekam në Ajvallik, ndërsa më 1847, me gradën e vezirit, u emërua muhafi i Beogradit. Por, pas një kohe vdiq në Beograd, ku e ka edhe tyrben.

Në të gjitha burimet thuhet se ishte poet i talentuar, se kishte shkruar poezi. Mirëpo, se a ka mbetur diçka nga poezia e tij, se ku ndodhen vjershat e tij, nuk ka kurrfarë të dhënash.

Muidi Tetovasi (Kalkandereli Mu'idi) – ishte nga Tetova. Të dhënat mbi të mungojnë thujse krejtësisht. Vitet e fundit të jetës kishte kaluar në Egjipt. Kishte shkruar një divan me shtatë pjesë (Kutub-i seb'a). Veprat e tij nuk janë botuar.

Vasif Osman Enderuni rrjedh nga familja e Arnaut Halil pashës. Shërbeu në sarajin mbretëror. Vdiq më 1824. E shkroi një divan vjershash, i cili qe botuar. Divani i tij është i njohur për shkak të gjuhës së thjeshtë dhe të injorimit të traditës së mëparshme në poezi.

Fehmi beu ishte nga Peqini, i biri i Sulejman pashës. Divanin e tij e botoi i nipi, njëfarë Salim beu, në vitin 1870.

Aqif Mehmet pashë Tetova (Kalkandereli Akif Mehmet pasha) rrjedh nga një familje e shquar shqiptare nga Tetova. Lindi më 1822 në Tetovë. U shkollua në Shkup, ku mixha i tij, Ali Hivzi pasha, ishte vali. Kur qeveria osmane, kah viti 1835, internoi një varg pashallarësh shqiptarë, midis tyre ishin edhe mixhallarët e tij Ali Hivzi pasha, Hasan pasha dhe Abdurrahman pasha me gjithë familje. Pas disa vjetësh i liruan dhe Aqifi hyri në shërbimin ushtarak. Në luftën kundër Malit të Zi, bashkë me serdarin Eqrem Omer pashën, tregoi trimëri të madhe dhe aftësi të jashtëzakonshme, gjë që i solli një përparim të shpejtë në karrierën e tij. Më 1825 u bë vali i Shkupit, më 1858 vali i Bosnjës, pastaj vali në shumë anë të ndryshme, midis të cilave edhe vali i Prizrenit më 1875/6 dhe i Janinës. Në fund u bë kryetar i Këshillit të Lartë të Shtetit (Meclis-i Sûrâ). Vdiq më 1893. Aqif Mehmet pasha ishte njeri jashtëzakonisht i ditur. E dinte turqishten, shqipen, persishten, arabishten, frëngjishten dhe greqishten. Shkroi vjersha arabisht, persisht e turqisht, por nuk i botoi.

Musa Qazim pasha është i biri i Hysejn Hysni beut nga Konica. Lindi në Konicë më 1821. Si i ri, bashkë me të jatën erdhi në Stamboll. Pasi kreu shkollimet, u emërua nëpunës në Sarajin mbretëror dhe më vonë në Ministrinë e Financave. Në fund u bë sekretar në Gardën mbretërore, ku përparoi mjaft shpejt. Por, duke shkruar satira kundër njerëzve të shquar të asaj kohe, shkaktoi urrejtjen e shumë vetave, të cilët ia arritën që t'i shtyjnë organet më të larta që ta internojnë në Qipro dhe t'ia heqin gradën e majorit. Më 1863 u fal, iu kthye grada dhe iu paguan të gjitha rrogat që nuk i ishin dhënë. Duke përparuar gradualisht, arriti deri në gradën e ferikut (gjeneralit të divizionit). Në luftën ruso-turke më 1877 ishte komandant i shtabit të

Armatës së Katërt. Pas kësaj, një kohë të gjatë shërbeu në Sektionin e financave të Shtatmadhorisë dhe pastaj u bë anëtar i përhershëm i Shtabit të Përgjithshëm. Ndërroi jetë më 1889.

Musa Qazim pasha botoi një vepër elegjish dhe një përmbledhje poezish me titull “Divan-i Kâzim pasa” (Divani i Qazim pashës). Botoi edhe poezi nëpër revista të ndryshme. Shkroi sipas stilit të vjetër të poezisë së divaneve, duke mos u influencuar nga rryma e re, e cila në atë kohë e kishte përfshirë poezinë turke, si pasojë e ndikimit evropian.

Xhelaludin efendi, ose Mahmud Xhelaludin efendi, lindi më 1876. Vdiq në moshën 20-vjeçare, duke qenë në punë si sekretar i Vilajetit të Izmirit. Me origjinë ishte nga Janina. Ishte poet dhe shkrimtar. E përktheu nga arabishtja në turqishte antologjinë arabe “Mekhâni l-edeb”, e cila qe botuar në Izmir. Vetëm disa nga poezitë e tij u botuan. Ishte jashtëzakonisht i talentuar, por vdekja e hershme e ndërpreu aktivitetin e tij letrar.

Rauf Leskoviku lindi në Leskovik më 1879. Mësimet i kreu në Leskovik dhe në Selanik dhe më 1893 u regjistrua në Shkollën e Lartë Administrative (Mülkiye). Kur ishte në vitin e fundit, për shkak të një shkrimi, të cilin pushteti e gjeti të rrezikshëm, u dërgua me gjithë familje në Selanik, ku u emërua ndihmës drejtor i Shkollës së Mesme Teknike. Pastaj u tërhoq në çifligun e të jatit. Njëherë u përpoq të ikte në Evropë, por e kapën dhe e sollën në Selanik. Pastaj u emërua kajmekam në Menlik, Voden, Koçkiri dhe më vonë edhe mytesarif në Menteshë, Mersin, në Lazikije të Sirisë dhe përsëri në Mersin. Në fund u pensionua dhe kaloi të jetojë në Stamboll. Nuk dimë se kur vdiq. Në të gjitha burimet thuhet se shkroi vjersha, por të dhënat e tjera na mungojnë.

Salih Rashid pasha ishte i biri i tetovarit Mehmet Aqif pasha, për të cilin folëm më lart. Lindi më 1863 në Janinë, ku e kishte të jatin vali. E kreu Shkollën e Lartë Administrative (Mülkiye). Më 1882 e filloi karrierën ushtarake dhe më 1895 u bë anëtar i Këshillit të Shtetit, e më vonë anëtar i Këshillit të Lartë Administrativ, ndërsa më 1902 u emërua vali i Vilajetit të Sivasit. Me shpalljen e Revolucionit xhonturk, u emërua ministër i Punëve të Brendshme dhe u thirr të vinte në Stamboll. Ai erdhi, por nuk e pranoi detyrën, duke u justifikuar se nuk e lejonte gjendja shëndetësore ta merrte këtë detyrë. Më 1909 u emërua anëtar i Senatit, e më 1918 u kryetar i Këshillit të Shtetit. Vdiq më 15 prill 1920. Në burimet turke gjejmë shumë fjalë lavdëruese për të. Konaku i tij në Stamboll ishte gjithmonë plot me mysafirë, si të ishte han. Shumica e tyre nga vendi i tij. Në kohën kur ishte vali, qe dalluar për nga drejtësia dhe aftësia administrative. Konsiderohej si një nga valinjte më të aftë. Kishte shkruar shumë vepra, por kur iu dogj saraji në Stamboll, bashkë me shtëpinë i janë djegur biblioteka dhe dorëshkrimet. Vetëm pak vjersha i janë botuar nëpër revista të ndryshme.

Qamil H. Tepelena (Tepedelenlizade Kâmil) është i biri Ismail Rahmi pashë Tepelenës, i nipi i Ali pashë Tepelenës. Lindi më 1865. Ruzhdijen dhe idadijen i kreu në Stamboll. Me intervenimin e Aqif pashë Tetovës, i cili ishte kryetar i Këshillit të Lartë të Shtetit, hyri të punojë vullnetarisht në Komisionin e Tanzimatit, por duke qenë se nuk i dhanë menjëherë rrogë, e la punën. Dy herë udhëtoi në Tesali dhe atje shiti disa pasuri të trashëguara. Gjatë gjithë jetës nuk punoi gjë, por merrej vetëm me letërsi. Kishte ambicie të mëdha letrare, por ato nuk ishin në përputhje me talentin dhe mundësitë. Vdiq më 1921 në shtëpinë e vet në Hajdar pasha në Stamboll.

Qamil Tepelena botoi një varg veprash, por këtu do të japim shënime të elementare:

1) *Barbaros Hayreddin pasa* (Meshur Preveze Muharebe-i bahriyyesinin müsavverdir), në të cilën, si shihet nga vetë titulli, lavdëron admiralin më të famshëm turk Barbaros Hajrudin pashën dhe e përshkruan Betejën e Prevezës, në të cilën flota turke korri fitoren më të famshme kundër flotës aleate të Venedikut, Spanjës, Portugalisë dhe Maltës.

2) *Yazdiklarim* (Shkrimet e mia), është një përmbledhje poezish të shkruara sipas modelit të poezisë së divaneve me rregullat e metrikës kuantitative.

3) *Mühaberelerimiz* (Korrespondenca jonë) është një përmbledhje që përmban korrespondencën letrare midis dy vëllezërve, Qamil Tepelena dhe Hasan Tepelena, i cili gjithashtu kishte ambicie letrare. Në këtë korrespondencë Qamili luan më tepër rolin e mësuesit e Hasani rolin e nxënësit; Hasani i dërgon ndonjë shkrim e Qamili jep mendimin mbi të. Korrespondenca është interesante se nga ajo del në dritë kultura letrare e Qamilit, pikëpamjet e tij, qëndrimet ndaj poezisë së re e cila depërtonte në atë kohë në letërsinë turke. Aty-këtu jep mendimin duke u bazuar në poezinë evropiane.

4) *Bir müteverrimenin hissiyyati* (Ndjenjat e një vajze tuberkuloze). Në *Parathënie* Qamil Tepelena thotë se në këtë veper e ka imituar poetin e madh turk Abdulhak Hamidin, i cili kishte shkruar në prozë dhe në vargje veprën *Bir Sefilenin hasabahali* (Gjendja e një të mjere). Ky është një poemth i shkruar me mjaft mjeshtri poetike.

5) *Validem* (Nëna ime) – është një poemë e vogël kushtuar nënës së vdekur. Më tepër ka retorikë, mjeshtri për të hartuar bejte sesa ndjenja të vërteta poetike.

6) *Nümne-i Secaat* (Shembull trimërie), vepër e botuar, për të cilën nuk ka të dhëna të afërta.

7) *Ma'suka yahud muhafeza-i ask* – dramë njëaktëshe me katër skena. Drama është me përmbajtje historike; ngjarja ndodh në Granadë kur ajo ishte islame. Në të vërtetë, këtu më tepër kemi monologje e dialogje në vargje se një konflikt dramatik.

Përveç këtyre, në një vepër të veten ai shënon se i kishte botuar edhe këto vepra: *Mecmu'a-i as-ar* (Përmbledhje poezish), *Mektubat* (Shkrime), *Manzum* (Vargje), *Manzume-i tarihiyye* (Poema historike), *Mersiyye* (Elegji). Njëkohsisht, ai thekson se i kishte shtypur edhe 12 vepra të tjera, midis të cilave tri përmbledhje vargjesh dhe një përmbledhje tregimesh të shkurtër (küçük hikâyeler) etj.

Kur flasim mbi poetët bashkëkohorë, nuk mund të mos e përmendim poetin e madh me origjinë nga Dibra dr. Riza Teufikun. Ai ishte poet, prozator dhe filozofi i parë turk në kuptimin modern. Lindi në Dibër më 1869. Më 1876 shkoi në Stamboll. Si djalosh 10- vjeçar e mësoi frëngjishten dhe hebraishten. Shkollën e mesme e kreu si nxënës më i mirë dhe pastaj u regjistrua në shkollën e lartë administrative “Mülkiyye-i Sultaniyye”, por pas një kohe e la dhe iu kushtua leximit. Shumë herët filloi të shkruante vjersha. Më 1890 u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë. Një kohë banoi në Arnautköy, në shtëpinë e Ismail Qemalit. Pas një varg peripecish, pasi që dy tri-herë ra në burg, njëherë edhe e përzunë...ia doli të kryente fakultetin. Në parlamentin xhonturk më 1908 ai u zgjodh deputet i Edrenes. Në fillim ishte ithtar i ideve xhonturke, por shpejt u prish me xhonturqit dhe kaloi në opozitë. Më 1918 u bë ministër arsimit, pastaj kryetar i Komisionit legjislativ e në fund qe i detyruar të emigrojë nga Turqia si kundërshtar i Qemal Ataturkut. Pas vdekjes së Qemal Ataturkut u kthye në Turqi dhe e vazhdoi

aktivitetin letrar. Vdiq më 1945 në Stamboll dhe u varros me nderime të mëdha. Botoi këto vepra më të rëndësishme:

Ligjërata filozofike,
Përmbledhje vjershash,
Fjalor filozofik
Filozofia e Omer Hajamit.

Sado që gjithë jetën e kishte kaluar në Stamboll, dr.Riza Teufiku thoshte haptas se i jati i tij është shqiptar.

Natyrisht se me kaq nuk mbaron lista e shqiptarëve që shkruanin poezi në gjuhën turke, ndërsa një varg edhe në gjuhën arabe. Por, me këtë rast të përmendim vetëm emrat e disave: Xhafer Sadik pasha, i biri i Sulejman pashë Peqinit, botoi vjersha; Mustafa Safi, poet bohem, i cili veten e quante “Sâribu l-lejli ve n-nehar” (ai që pi natë e ditë), ishte poet i talentuar që botoi një divan vjershash; Osman Vasifi, i vëllai i vezirit Halil pashë Elbasani, botoi një përmbledhje vjershash në Kajro më 1824; Çakir efendi, poet nga Shkodra, Fehmi beu nga Peqini, Haki pasha, i biri i Mustafa pashë Shkodrës, Hulusi aga nga Kruja, Xhafer Sadik pasha nga Peqini, Zihniu nga Shkodra – të gjithë këta shkruan vjersha. Sa për kuriozitet do të përmendim se edhe Mustafa pashë Shkodra kishte shkruar vjersha me mbiemrin poetik (mahlas) Sherifi. Gjithashtu, në këtë përmbledhje ne nuk i kemi përmendur edhe ata poetë turq, për të cilët kemi disa shënime, për arsye se kanë shkruar edhe poezi në gjuhën shqipe, siç janë Nazim Berati, Sheh Maliqi e të tjerë, të cilët doemos duhet të hyjnë në një përmbledhje komplete të kësaj poezie.

II. POEZIA E TEQEVE

Nën ndikimin e letërsisë arabe, e sidomos të asaj persiane dhe me përhapjen e tarikateve të ndryshme qysh nga themelimi i Perandorisë Osmane, në letërsinë turke lind një rrymë shumë e fortë e poezisë mistike (tesavvuf). Një lloj specifik i kësaj poezie është ai i cili është zhvilluar nëpër teqetë e ndryshme, shkruar nga shehlerë dhe dervishë të ndryshëm, të cilët izololeshin nëpër teqe, jetonin në mënyrë asketike dhe merreshin me shkrime. Midis tyre kemi një numër jo të vogël shqiptarësh. Një pjesë e tyre, sidomos bektashi, jetuan dhe krijuan nëpër teqe të ndryshme në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. Në bazë të shënimeve të mbledhura deri tash, do të japim një pasqyrë të shkurtër të këtyre poetëve.

Ahmet bej Dukagjini – Ahmet bej Dukagjini (Dukagjinza-de Ahmed bey) ishte i biri i Ahmet pashë Dukagjinit dhe i princeshës Xhevher-i Mülük, të motrës së sulltan Selimit. Sado që Ahmet Dukagjini përmendet në shumë burime kur flitet për poetët e periudhës së sulltan Sulejmanit, të dhënat mbi të janë mjaft të varfra. Dihet se kishte qenë në oxhakun e jeniçerëve, spahi, e pastaj kishte fituar edhe zeamet dhe kishte arritur të bëhej sanxhakbej. Mirëpo, nën ndikimin e letërsisë mistike dhe i zhgënjyer në njerëzit, kishte ardhur në përfundim se kjo jetë është e rrejshme dhe e mbushur vetëm me helm e dhembje dhe pastaj është tërhequr në vetmi, në skamje dhe vetëmohim të vetëdijshëm, duke iu kushtuar vetëm hartimit të vargjeve me karakter mistik. Nuk dihet se kur vdiq. Nga Ahmet bej Dukagjini ka mbetur një divan në dorëshkrim,

pesë ekzemplarë të të cilit ndodhen në bibliotekat e ndryshme të Stambollit.

Dervish Summân “Sineçak” ishte nga Elbasani. I takonte tarikatis të melamive dhe jetoi i pamartuar në teqenë e Mevlive, në Gallata të Stambollit. Në burime ka mbetur i njohur sipas ofiqit “Sineçak” (Gjokslakuriq), se si dervish, gjithmonë e kishte pasur gjoksin lakuriq. E kishte shkruar një vepër në dhjetë vëllime me titull “Gülsen-i Irfan” (Trëndafilishtja gnostike) dhe ia kishte dorëzuar të vëllait Kara Mustafa pashës. Kush ishte ky Kara Mustafa pasha nga Elbasani, nuk dimë tash për tash. Sipas të gjitha gjasave, jetoi në kohën e sulltan Sulejmanit, d.m.th. në gjysmën e parë të shekullit XVI.

Sersem Ali Dede ishte një figurë me rëndësi në historinë e bektashizmit turk e ballkanik. Me origjinë ishte nga Tetova. Jetoi nga fundi i shekullit XV dhe deri kah mesi i shekullit XVI. Sipas disa të dhënave që duhen vërtetuar, ai ishte vezir i sulltan Sulejmanit, por pastaj ishte tërhequr nga detyra, ishte bërë bektashi dhe kishte shkruar të jetojë në teqenë e Haxhi Bektash Veliut, e cila është kryeteqja e bektashizmit në përgjithësi. Më 1550 qe bërë kryegjysh në këtë teqe, d.m.th. njeri më i lartë në hierarkinë bektashiane. Vdiq më 1569. Në bazë të amanetit që kishte lënë, tërë pasurinë e tij, duke përfshirë edhe atë të trashëguar, e la që të ndërtohet një teqe në vendlindjen e tij, në Tetovë. Amanetin e tij e zbatoi *Harabati baba*, i cili e ndërtoi teqenë bektashiane të Tetovës, e cila edhe sot quhet “*Teqja e Harabati babës*”. Më vonë këtë teqe e zgjeruan dhe në të ndër-tuan objekte të reja pashallarët e Tetovës, kështu që u bë një nga teqetë më të bukura në Ballkan. Edhe sot ekziston, por është shndërruar në objekt turistik.

Nga Sersem Ali Dede kanë mbetur shumë vjersha me përmbajtje mistike, nga të cilat disa janë edhe të botuara.

Ummî Sinan – është themelues i degës sinanije të tarikatit halvetije. Burime rreth vendlindjes së tij janë kontradiktore; në një burim thuhet se është nga Brusa, kurse në një tjetër nga Karamani, por shumica e marrin se është nga Prizreni, se edhe në Sallnamet e Vilajetit të Prizrenit ai merret si Prizrenas. Në Prizren ndodhej edhe një teqe e Sinanive te Tabakët, për të cilën thuhet se e kishte ndërtuar Ummî Sinan. Vdiq në Stamboll më 1551. Ishte poet mistik i shquar. Për fëmijët, nipat dhe dhëndrin e tij sulltan Sulejmani e ndërtoi një teqe në afërsi të Topkapisë në Stamboll. Mbi origjinën e tij shqiptare nuk jemi të sigurt, sepse në burime kjo gjë nuk përmendet në mënyrë eksplicite. Ka shkruar vjersha.

Axhize baba (Acizi Süleyman efendi) është themelues i degës axhizije të tarikatit të sadive, ose më mirë të themi ringjallësi i këtij tarikati dhe popullarizuesi i tij në Kosovë. Me origjinë ishte nga një katund afër Shkodrës. Pasi i kreu studimet në një medrese në Stamboll, iu kushtua mistikës islame. Nga Stambolli erdhi në Gjakovë, ku ndërtoi “Teqenë e madhe” të sadive. Kur iu rrit i biri, Danjali, Axhize baba shkoi në Prizren, ku ngriti teqenë në Marash, e cila u shkatërrua më 1945. Ka qenë një nga teqetë më të bukura në Kosovë. Për Axhize babën ka edhe një varg legjendash. Vdiq më 1738 dhe u varros në një tyrbe në Prizren afër teqesë, e cila ka mbetur deri sot. Përveç divanit, ku shumica e vjershave janë truqisht, e më pak arabisht e persisht, në burime gjejmë shënime se ka shkruar edhe disa trajtesa. Ka shkruar edhe një vepër në vargje mbi moralin dhe mistikën islame, e cila, sipas një burimi, ndodhet në bibliote-

kën Atik Valide në Üsküdar të Stambollit. Një pjesë e divanit të tij është gjetur në Gjakovë, kurse fotokopjet e kësaj pjese ndodhen tek unë.

Shemimi – Qemaluddin Shemimi babai është propagatori më i madh i bektashizmit ndër shqiptarët. Burimet nuk thonë gjë se cila është origjina e tij, por ne supozojmë se është me origjinë shqiptare. Sipas të dhënave që kemi sot në dispozicion, Shemimi ishte profesor medreseje, d.m.th. musliman ortodoks (sunnit), por më vonë ishte bërë bektashi. Së pari kish shkuar në teqenë bektashiane në Veles (Köprülü), ku kanë shërbyer shumë bektashinj shqiptarë. Kah fundi i shekullit XVIII Shemimiu me një shok të vet vjen në Krujë, ku themelon një teqe. Nga këtu bëri shumë shëtitje nëpër Shqipëri, duke përhapur bektashizmin, por suksesin më të madh e korri në Shqipërinë e Jugut në sajë të Ali pashë Tepelenës, i cili mori dorë nga Shemimiu dhe u bë bektashi. Me ndihmën e Ali pashës, Shemimiu ndërtoi teqenë e Meleçanit në Korçë, pastaj ndihmoi në themelimin e teqesë së Xhefaj babait në Elbasan, në hapjen e teqesë së Sadik babait në fushën e Koshtanit të Tepelenës etj. E vranë armiqtë e tij në teqenë e Krujës. U varros në tyrben e teqesë së tij në Fushë-Krujë. Shkroi poezi mistike.

Hatemi – Hatemiu ishte shok i Shemimiut. Së bashku qëndruan në teqenë e Velesit dhe shkuan në Krujë. Hatemiu e helmuan armiqtë e bektashizmit. Edhe atij i ndërtuan një tyrbe në teqenë e fshatit Gjorm. Edhe prej tij mbetën vjersha turqisht me frymë mistike.

Nesibi Tahir babai – Sami Frashëri (Kâmûs al-a'lâm, VI, 4580) është i vetmi i cili na jep të dhëna mbi të. Samiu thotë se

Nasibiu lindi në Frashër, ku edhe e zgjodhi rrugën e bektashizmit. Nga Frashëri shkoi për një kohë në Anadoll dhe prej këtu në haxhillëk. Kur u kthye, themeloi një teqe në Frashër, e cila me kohë u zhvillua në një teqe të madhe dhe të përparuar. Vdiq më 1835 dhe u varros në një tyrbe pranë teqesë së tij. Samiu thekson se Nasibiu kishte shkruar shumë vjersha në gjuhën shqipe. Përveç kësaj, kishte shkruar edhe gazele (vjersha lirike) turqisht dhe persisht. Kur po kthehej nga haxhillëku, arriti në Leskovik, ku filluan t'i bëjnë pyetje të ndryshme. Nasibiu iu përgjigj dijetarëve të atjeshëm me vjersha; aq ishte i zoti në poezi.

Nga kjo teqe dolën patriotë të shquar si p.sh. baba Alushi, Abidin babaj etj. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashëri e kishte në këtë teqe pikëmbështetjen më të madhe.

Muharrem Mahzumi babai është një nga bektashinjtë e shquar shqiptarë të shekullit XIX. Rrjedh nga Gjirokastra. Shërbeu në teqenë e famshme të Durballisë në Farsalla të Thesalisë, një nga teqetë më të famshme dhe më të vjetra bektashiane në Ballkan, e themeluar në shekullin XV. Muharrem Mahzumi shkroi vjersha shqip dhe turqisht. Vdiq më 1867.

Haxhi Et'hem beu (Shehidi) – Lindi kah fillimi i shekullit XIX në Tiranë, ku e ndërtoi edhe një xhami të madhe, Xhaminë e Et'hem beut. Në vjershat e veta thotë se është frymëzuar nga Haxhi Hysejn babai i Krujës. Shkroi shumë vjersha në gjuhën turke, të mbledhura në një divan. Sadeddin Nüzhet Ergün i botoi dy vjersha të tij në veprën “Bektasi Sairleri”. Sipas zakonisht të atëhershëm, kishte përdorur pseudonimin poetik (mahlas) *Shehidi*. Vjershat e tij ndodhen në Institutin e Gjuhësisë në Tiranë.

Haxhi Ali Haqi babai – lindi në Elbasan në vitin 1827. Edhe lindja, edhe rinia e tij janë të shoqëruara me një varg legjendash bektashiane. Mësimet fillestare dhe medresenë i kreu në Elbasan. Qysh në medrese filloi të interesohet për mistikën islame (tesavvuf). Aliu, bashkë me një shok, i frymëzuar nga librat mistikë të lexuar, vendosën të bëheshin dervishë dhe shkuan në Melçan të Korçës. Pas një kohe, Aliu shkoi në teqenë e Haxhi Bektash Veliut dhe u dorëzua dervish më 1854. Në vitin 1861, kur mbeti vakant posti i teqesë së Gjirokastrës, erdhi baba Aliu, i cili ndërtoi një teqe të re. Ai kontribuoi shumë në përhapjen e bektashizmit jo vetëm në Gjirokastrë, por edhe në Delvinë, Libohovë, Tepelenë, Kurvelesh, Përmet etj. Thuhet se ka pasur 2.000 dervishë aktivë dhe se ka kurorëzuar 12 baballarë. Ai kishte fituar aq autoritet, sa që kur mbeti vakant posti i kryegjyshit në kryeteqenë e Haxhi Bektashit në Anadoll, e thirrën ta ushtrojë këtë detyrë, por ai nuk e pranoi. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit qeveria turke e internoi në Janinë, por nuk mbeti gjatë në internim. Teqeja e tij shërbente edhe si çerdhe për përhapjen e librit shqip. Njerëzit më të shquar të asaj kohe, qofshin në pozita fetare apo administrative, ishin ithtarë të tij, madje edhe myftiu, kadiu dhe myderrizët, si dhe disa pashallarë shqiptarë. Udhëtoi shumë (Turqi, Persi, Irak, Mekë, Palestinë) dhe udhëtimet e veta i përshkroi në një udhëpërshkrim (Siyahat-name), një dorëshkrim me mbi 1.000 faqe në gjuhën turke. Po kështu shkroi edhe një libër 500 faqësh me titull “Instilâhat-i Sûfiyye” (Terminologjia mistike), në të cilin i shpjegon gjerësisht fjalët dhe termat që përdoren në mistikën islame dhe në letërsinë e saj. E la edhe një fjalor të dialektit turk të çagataishtes (özbekishtes), si dhe vjersha në gjuhën arabe dhe persiane. Veprat e tij kanë mbetur në teqenë e Gjirokastrës.

Adem Vexhhi babai, lindi në Gjakovë më 1841. Pasi e kreu shkollën fillore turqisht në Gjakovë, hyri në medresenë e Gjakovës, por nuk e kreu, sepse i vdiq i jati. Më 1860 mori dorë në teqenë bektashiane të Gjakovës nga Adem baba Prizreni. Nga këtu shkoi në teqenë e Melçanit, ku shërbeu dy vjet. Nga këtu shkoi në teqenë e Frashërit, te patrioti i njohur baba Alushi, mbi patriotizmin e të cilit ka edhe këngë popullore. Më 1872 baba Alushi shkoi në Anadoll, në teqenë e Haxhi Bektashit, duke vizituar me këtë rast edhe Persinë, Irakun dhe Indinë. Më 1877 baba Ademi u kthye në Prizren, ku hapi një teqe të re. Këtu tregoi një aktivitet të madh kombëtar. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit baba Ademi ndodhet midis udhëheqësve më të shquar. Në dokumentet e Arkivit të Vjenës baba Ademi përmendet si një nga njerëzit e rrallë nga Kosova që kishte ndjenja të zhvilluara kombëtare. Më 1927, kur mbeti vakant posti i teqesë së Gjakovës, atje u dërgua baba Ademi, ku mbeti gjer në vdekje, më 1927. Ishte njohës i mirë i arabishtes, i persishtes dhe turqishtes. Shkroi vjersha në gjuhën turke me pseudonimin poetik *Vexhhi*.

Selim Ruhi babai, lindi në Elbasan në vitin 1869. Pasi e kreu shkollën fillore dhe medresenë, më 1885, si gjashtëmbëdhjetëvjeçar shkoi në Gjirokastrë te baba Aliu, bashkë me të jatin dhe të dy morën dorë. Selimi nuk u kthye në Elbasan, por i vazhdoi mësimet në një medrese në Gjirokastrë edhe dy vjet, ku i mësoi mirë arabishten, persishten e turqishten. Më 1891 u dorëzua dervish te baba Aliu. Në teqe, ku kishte një bibliotekë të pasur, pjesën më të madhe të kohës e kalonte duke lexuar. Kur më 1907 vdiq baba Aliu, postin e tij e zuri baba Selimi. Ai kishte aq autoritet, sa që të gjithë studentët e medresesë së Gjirokastrës, nëpunësit, madje edhe disa oficerë të ushtrisë turke, u bënë ithtarë të tij. Këtu e vizitoi edhe dijetari i njohur gjerman,

albanologu dhe orientalisti Franz Babinger, i cili edhe shkroi një artikull mbi të dhe teqenë e tij në një gazetë vjeneze. Kur në vitin 1908 doli në mal Çerçiz Topulli dhe formoi një çetë, teqeja e tij ishte një nga vendet ku gjente më së shpeshti strehim, sepse edhe Çerçiz Topulli ishte muhib (ithtar) i tij. Baba Selimi dha një kontribut të madh edhe në formimin e klubit shqiptar “Bashkimi” të Gjirokastrës. Ai vuajti shumë në kohën e okupacionit grek gjatë Luftës së Parë Botërore; grekët e plaçkitën teqenë dhe ia lanë vetëm muret. Kur u tërhoqën grekët, ai e rindërtoi teqenë me ndihmën e popullit dhe të shqiptarëve të Amerikës. Vdiq më 1944.

Baba Selimi shkroi tri divane të mëdha –arabisht, persisht dhe turqisht, të cilat kanë mbetur në dorëshkrim në teqenë e tij. E shkroi, gjithashtu, edhe një me titull “Ra’y al-Irsâd” (Mendimi mbi udhërrëfimin), ku përshkroi hollësisht se si bëhet udhërrëfimi bektashian.

Baba Hamzai, lindi në Gjakovë më 1882. Mësimet e para turqisht i kreu në vendlindjen e tij. Mori dorë te Haxhi Adem babai në teqenë bektashiane të Prizrenit. Nga këtu shkoi në teqenë e Haxhi Bektashit në Anadoll, ku shërbeu shumë kohë. Me këtë rast vizitoi shumë vende të shenjta të bektashizmit. Kur u kthye prapë, u emërua baba në teqenë bektashiane të Shtipit (Köprülü), aty kah viti 1812. Këtu shërbeu plot 38 vjet. Pastaj shkoi në teqenë e Gjakovës, ku posti ishte vakant. Këtu qëndroi deri më 1952, kur vdiq. Shkroi shumë vjersha turqisht e persisht. Vjershat e tij duhet të ndodhen në teqenë e baba Qazimit në Gjakovë.

Baba Ahmet Turani – Lindi në Tepelenë në çerekun III të shekullit XIX. Kur u rrit, shkoi në teqenë Hajderije të Gjirokastrës. Atje shërbeu shumë kohë dhe mori dorë. Më vonë shkoi

në vizitë në teqenë e Haxhi Bektashit në Anadoll. Kur u kthye, shkoi në teqenë e Turanit në Tepelenë, pranë baba Ali Turanit dhe u vendos aty. Kur më 1908 ndërroi jetë baba Ali Turani, vendin e tij e zuri baba Ahmeti. Më 1910 shkoi në teqenë e Haxhi Bektashit dhe atje u dorëzua gjysh. Më 1914 teqenë e tij e dogjën grekët, ndërsa ai shpëtoi duke ikur në Vlorë. Në luftën e Vlorës luajti një rol me rëndësi në mobilizimin e masave. Kur u rivendos pushteti shqiptar, u kthye në teqenë e vet, të cilën e ndërtoi përsëri me ndihmën e shqiptarëve të Amerikës dhe të popullsisë lokale. Shkroi vjersha me karakter mistik dhe ilahije.

Baba Abidin Leskoviku - ishte në shërbim në teqenë e Durballisë. Ky e themeloi teqenë bektashiane në Leskovik nga fundi i shekullit XIX. Shkroi vjersha shqip e turqisht.

Salih Nijazi Dede, ishte nga Starja e Kolonjës. Lindi nga fundi i shekullit XIX. Pasi i kreu mësimet fillestare në vendlindje, emigroi në Anadoll. Meqë rridhte nga një familje bektashiane, kishte dëshirë të flaktë ta vizitonte kryeteqenë bektashiane të Haxhi Bektashit, në Anadoll, ku shkoi dhe u bë dervish. Në vitin 1908 u bë baba dhe u dërgua në Shqipëri me një mision të posaçëm. Pasi e kreu detyrën, përsëri u kthye në kryeteqenë e Haxhi Bektashit. Më 1916 u emërua kryegjysh. Kur u mbyllën teqetë në Turqi, u detyrua të largohej që andej.

Në kongresin e bektashinjve, që u mbajt më 1928 në teqenë e Turanit të Korçës, u vendos të krijohet Kryegjyshata shqiptare dhe për kryegjysh u thirr Salih Nijazi Dede, i cili erdhi në Shqipëri nga fundi i vitit 1931. Ai e transferoi selinë e kryegjyshit në Tiranë, ku u ndërtua edhe ndërtesa e posaçme e Kryegjyshit. Në vitin 1942 u vra në kushte misterioze.

Shkroi shumë nefese dhe ilahi në gjuhën turke me pseudonimin poetik Nijazi.

III. HISTORIOGRAFIA

Edhe në historiografi kontributi i shqiptarëve nuk është për t'u nënçmuar. Madje, ka disa personalitete që qëndrojnë në majë të piramidës së historiografisë osmano-turke. Natyrisht se edhe në trajtimin e tyre nuk do të hyjmë në hollësi, se s'na lejon vendi, por do të tentojmë të japim një pasqyrë të shkurtër për ata për të cilët kemi disa shënime. Nuk dyshojmë se ka edhe shumë të tjerë, të cilët gjatë gjurmimeve të deritanishme nuk i kemi zbuluar.

Lutfi pasha. – Një nga historianët më të shquar të epokës së sulltan Sulejmanit është Lutfi pasha. Dihet se si djalosh dhjetëvjeçar ishte marrë nga Vlora dhe ishte sjellë në oborrin mbretëror në Stamboll. Këtu i fillon studimet e veta, që zgjasin plot 15 vjet. Nëse e marrim se hyri në shërbimin e parë ushtarak në moshën njëzetvjeçare, duhet të ketë lindur kah viti 1488. Bëri një karrierë të shkëlqyeshme. Gjatë periudhës së sulltan Selimit të Parë, të atit të sulltan Sulejman Ligjvënësit, e gjejmë vazhdimisht në afërsi të tij. Në vitin 1522 është sanxhakbej në Ajdin e më vonë në Janinë, ku e ndërtoi një urë. Me rastin e rrethimit të parë të Vjenës nga sulltan Sulejmani, Lufti pashën, bashkë me sanxhakbeun e Vlorës Sulejman beun, e gjejmë në vijat e para. Kah viti 1533 u bë guvernator i Karamanit, më 1536 guvernator i Rumelisë, me 1537 komandant i marinës (Kapudan Derya), me ç'rast e pushtoi Korfuzin. Më vonë e gjejmë komandant të ushtrisë (serdar) në luftën kundër venedikasve. Më 1538 u bë vezir i dytë, kurse më 1539 vezir i madh (kryeministër). Sado që në këtë detyrë mbeti vetëm dy vjet, ndërmori refo-

rma të rëndësishme si asnjë paraardhës i tij. U martua me motrën e sulltan Sulejmanit. Në vitin 1541, si vezir i madh, u nda nga e shoqja, motra e Sulltanit, dhe duket se kjo që arsyeya që u detyra të japë dorëheqjen dhe u tërhoq në një çiflig në Dimotok, afër Edrenes, ku njëzet vjet me radhë u mor me shkrime. Ai hartoi 12 vepra; më të rëndësishmet janë dy: *Asafname* dhe *Historia e Perandorisë Osmane*. Mu për shkak të këtyre dy veprave, historianët turq dhe evropianë e konsiderojnë Lutfi pashën si historianin më të rëndësishëm të periudhës së vet. Në veprën “*Asafname*”, të cilën e përktheu gjermanisht orientalisti Çudi më 1918, Lutfi pasha jep biografinë e vet nga ardhja në saraj e deri sa pensionohet, paraqet bazat e organizimit shtetëror osman, detyrat e çdo udhëheqësi, organizimin e timareve e zeameteve, qëndrimin që duhet të kenë nëpunësit ndaj rajës së krishterë etj. Si e tillë, kjo vepër paraqet burim me rëndësi për të njohur bazat e sistemit administrativ dhe ekonomik të Perandorisë Osmane.

Në veprën e dytë, e cila mban titullin *Tevarih-i Al-i Osman* (Historia e perandorisë osmane), Lutfi pasha përshkruan periudhën e sulltan Selimit dhe të sulltan Sulejmanit, dy sulltanëve më të shquar të dinastisë osmane, ose më mirë të themi përshkruan ngjarjet që i ka përjetuar vetë dhe në të cilat kishte marrë pjesë. Si e tillë, kjo vepër mbetet burim i dorës së parë për të njohur këtë periudhë të hershme të lulëzimit të Perandorisë Osmane. Disa gjurmues boshnjakë janë përpjekur që Lutfi pashën ta nxjerrin si boshnjak, mirëpo, sipas mendimit tim, këto përpjekje nuk kanë baza të forta.

Koçi beu. – Duke vazhduar paraqitjen tonë në mënyrë kronologjike, vijmë te teoricieni dhe kritiku i madh i sistemit feudal turk, Monteskjue i Turqisë, te Koçi beu. Të gjitha buri-

met pajtohen se është me origjinë shqiptare dhe se ofiqi i tij Kuçi apo Koçi vjen nga fjala shqipe “i kuq” për shkak se e kishte fytyrën të kuqe. Po kështu, edhe në burimet ruse, në të cilat përmendet i vëllai, Hurrem beu, i cili iku në Rusi, kaloi në fenë e krishterë dhe mori emrin Andrej, përmendet me ofiqin Koçi, Kuçi. Sipas Babingerit dhe Bursali Mehmet Tahirit, Koçi beu është marrë si devshirme (jeniçer) nga Shqipëria e jugut dhe është quajtur Mustafa. Sipas shumicës së burimeve, vendlindja e tij është Korça (t.Goriçe, Güriçe) dhe prandaj shumë autorë, si Ahmet Vefik pasha, Shani zade M. Syrejja e quajnë Güriçeli (Korçari). Nuk dihet se në cilin vit është marrë si devshirme, çfarë shërbimesh ka kryer deri sa ka arritur të futet në sarajin mbretëror, por s’ka kurrfarë dyshimi se nga sulltan Ahmeti I (1603), Mustafa I (1617, 1622), Osmani II (1618), Murati IV (1623) dhe Ibrahimit (1640), ka shërbyer në disa oda të Sarajit, ku pranoheshin më të zgjedhurit dhe më të besuarit. Në kohën e Muratit IV që pranuar në has oda (njerëzit më konfidentë të Sulltanit). Sulltan Murati kërkoi nga Koçi beu që t’i shkruajë një trajtesë në lidhje me arsyet e dekadencës së Perandorisë Osmane dhe masat që duhet marrë për shërimin e dobësive. Kur më 1631 Koçi beu ia dorëzoi trajtesën Sulltanit, autoriteti u rrit edhe më tepër dhe ai e zuri vendin e parë midis shoqëruesve të Sulltanit. Mori pjesë në luftën e Bagdadit. Pas vdekjes së Muratit IV, u bë musahib (shoqërues) i të vëllait, sulltan Ibrahimit. Në bazë të kërkesës së sulltanit të ri, ai hartoi një trajtesë të re, të cilën ia dorëzoi më 1641. Pas shumë vjetësh shërbimi, kah fundi i qeverisjes së sulltan Ibrahimit (1648) u pensionua dhe shkoi në katundin Plamen të Korçës, ku vdiq dhe aty u varros. Në Korçë (ose në katundin Plamen) kanë vdekur dhe janë varrosur edhe i biri i tij, Sefershahu dhe shoqja e tij – gjë që mund të merret si një provë e fortë se ishte nga Korça.

Në trajtesën (Risâle) e parë të cilën ia dorëzoi sulltan Muratit më 1431, Koçi beu flet mbi problemet e ndryshme shoqërore, ekonomike, politike, por tema kryesore është analiza e dekadencës së Perandorisë Osmane. Në kohën e tij, sado që Perandoria ende shtrihej në tri kontinente dhe ishte mbretëria më e madhe në botë, gjendja në saraj dhe në Stamboll, korrupcioni në administratë dhe në drejtësi, paaftësia e nëpunësve të lartë, gjendja e vështirë ekonomike, kryengritjet në Stamboll dhe në Anadoll – të gjitha këto ishin faktorë të cilët provonin haptazi se Perandoria shkonte drejt dekadencës. Nga trajtesa e Koçi beut merret vesh se rrënjët e kësaj dekadence duhen kërkuar qysh në kohën e sundimit të sulltan Sulejman Ligjvënësit. Këtë tezë, të cilën e paraqet i pari Koçi beu, sot e pranojnë historianët më të mëdhenj të historisë osmane. Koçi beu vë në pah se deri te sulltan Sulejmani njerëzit e sarajit, gratë, konkubinat, nënat e sulltanëve, nuk kishin kurrfarë ndikimi në politikën e brendshme dhe të jashtme, kurse me sulltan Sulejmanin puna merr një kahje të kundërt. Në një sistem autokrat ku, sipas Koçi beut, Sulltani duhet të jetë personalitet i fortë dhe i dijshtëm, të jetë i rrethuar vetëm nga njerëz të mësuar, filluan të mbretërojnë dallkaurët dhe karrieristët, të cilët shikonin interesat personale e jo ato të mbretërisë. Ky grup i sarajit kishte bërë një zinxhir rreth Sulltanit, kurse të aftit, të diturit dhe patriotët kishin mbetur larg nga pushteti. Selimi i Dytë, Murati III dhe Mehmeti III qenë përfaqësues tipikë të kësaj gjendjeje. Me trajtesën e vet Koçi beu përpiqet që sulltanit të ri, sulltan Muratit IV, t'ia tërheqë vëmendjen se si është degjeneruar shkallë-shkallë organizimi ekonomik dhe ushtarak. Ai i analizon arsyet e degjenerimit të jeniçerëve, shkaqet e korrupsionit të parimit të timareve dhe zeameteve, marrjen e ryshfetit publikisht, të shiturit e pozitave të larta dhe, si pasojë, eksploatimin

dhe shtypjen e shtresave të ulëta të popullit dhe të rajës. Nga zullumet e nëpunësve katundarët në Anadoll kishin lënë pronat, shtëpitë, pasurinë e tyre, kështu që katunde të tëra kishin mbetur të zbrazëta. Esnafët ishin shkatërruar. Ushtria jeniçere nuk i ngjante më ushtrisë së disiplinuar, por bashibozukëve; në krye të kësaj ushtrie gjendej njëfarë mafie, e cila nuk hezitonte ta hiqte edhe Sulltanin nga froni dhe t'i vriste njerëzit më të lartë të shtetit. Ata ishin bërë çerdhe e degjenerimit moral, e poshtërsive, e amoralit dhe korrupsionit. Koçi beu jo vetëm që kritikon, por edhe propozon mjete për shërimin e kësaj gjendjeje. Ai kërkon të riorganizohet nga themeli sistemi i tatimeve, të përmirësohet gjendja e rajës e cila jeton në mizori etj. Fjalët e veta Koçi beu i përforcon herë me numra e statistikë, herë me fjalë të Kur'anit dhe të Muhamedit dhe kohë pas kohe përdor një gjuhë shumë të ashpër. Sado që nuk ishte zakon që një historian apo shkencëtar të kritikojë shtetin dhe organizimin shtetëror, administrativ dhe ekonomik përpara Sulltanit, qëndrimi i Koçi beut, sipas mendimit unanim, provon se është fjala për një njeri me karakter të fortë dhe mendim të qartë e guximtar të pashoq. Një kritikë e tillë, si thotë edhe Hammeri, i cili që i pari që e analizoi trajtesën e Koçi beut, është gjë e jashtëzakonshme në historiografinë dhe shkencën turke. Kjo trajtesë pati një ndikim të fortë te sulltan Murati IV, i cili erdhi në pushtet shumë i ri në vitin 1623. Koçi beu ia mësoi sulltanit të ri mekanizmin e shtetit, dobësitë e tij dhe rrugët e përmirësimit. Sulltani ndërmoi një varg masash të ashpra dhe guximtare, madje edhe hapa që janë karakterizuar si brutalë dhe gjakatarë. Deri në atë kohë që ai ishte nën ndikimin direkt të së ëmës, kurse pas leximit të trajtesës vetë i mori të gjithë frenat në dorë. Në ndikimin e Koçi beut Sulltani menjëherë mori një varg masash të rrepta: ndaloi pijen dhe duhanin, dha urdhër që fizikisht të

zhduken krerët e jeniçerëve dhe të spahive turbullues, nëpunësit e korruptuar dhe përtacë filloi t'i ndjekë dhe t'i dënojë, mori disa masa për riorganizimin e sistemit të timareve dhe të zeameteve, filloi luftën kundër ryshfetit dhe protekcionizmit.

Thamë se Koçi beu ia dorëzoi trajtesën e dytë sulltan Ibrahimit, të vëllait të Muratit IV, menjëherë pas ardhjes së tij në fron. Kjo trajtesë dallohet nga ajo që ia dha sulltan Muratit IV. Këtë të dytën Koçi beu e shkruan me një gjuhë tejet të thjeshtë – madje ia shpjegon disa terma; ajo është në të vërtetë një abetare se si duhet të mbretërohet. Këtë e bëri Koçi beu për shkak se, duke qëndruar një kohë të gjatë në sarajin mbretëror, e dinte shkallën e diturisë së Sulltanit, nivelin e kulturës së tij, për shkak se sulltani i ri vite me radhë kishte qëndruar gjysmë i konfinuar në saraj. Për këtë arsye, edhe kur flet mbi problemet administrative, financiare, ushtarake, mbi ceremonitë e pallatit, ai i thotë të gjitha me një gjuhë të thjeshtë. Pozita midis tyre është e qartë: Koçi beu ka rolin e profesorit, kurse sulltan Ibrahimin rolin e nxënësit. Me këtë trajtesë ai e mëson se si është i organizuar shteti, si duhet të jetë sjellja e njerëzve të lartë të shtetit, me çfarë fjalësh duhet t'u drejtohet atyre, për çfarë arsye shkruhen fermanet dhe me cilat raste. Të gjitha këto i bën, sikurse thamë, me një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme, në kundërshtim me trajtesën e parë, e cila ishte shkruar me një stil të lartë, me përdorimin e shumë fjalëve arabe e persiane, sepse Murati IV ishte i ditur, e dinte mirë arabishten dhe persishten. Sipas disa burimeve, Koçi beu e bënte edhe korrespondencën në emër të Sulltanit. Për çdo nevojë që kishte Sulltani, i drejtohej Koçi beut; atij ia dërgonte fermanet dhe beratet që t'i korrigjonte e t'i përmirësonte.

Dy trajtesat e Koçi beut, sipas mendimit të përgjithshëm, janë burimi i dorës së parë në lidhje me organizimin shtetëror,

administrativ, juridik, mbi ceremoninë e oborrit, jetën ekonomike, ushtarake etj. E, kur merret parasysh se ato u shkruan për dy sulltanë, se këto trajtesa ndikuan tek ata, atëherë mund të shihet më së miri se sa e madhe është vlera e tyre. Prandaj edhe sot, kur bëhet studimi i shkaqeve të dekadencës së Perandorisë Osmane, gjithmonë fillohet nga Koçi beu. Mu këto janë arsytet që këto trajtesa janë botuar shumë herë turqisht dhe janë përkthyer gjermanisht, frëngjisht, ruisht dhe hungarisht.

Mustafa Safi është bashkëkohanik apo diçka më i vjetër se Koçi beu. Me origjinë ishte nga fshati Hurpishtë, i Shqipërisë së jugut. Ishte imam dhe vaiz në xhaminë e Xherrah pashës në Stamboll. Njëkohësisht, ishte edhe imam i Sulltanit. Vdiq më 1616. Në burime thuhet se ishte pajisur me dituri të mëdha në shumë disiplina shkencore. Kishte shkruar vepra nga historia, letërsia dhe predikimet (va'z). Vepra më e rëndësishme e tij është *Zübdetüt-Tevarih* (Esenca, kajmaku i historisë), vepër historike në dy vëllime. Në këtë vepër ai bën plotësime dhe e vazhdon veprën e njohur "Tacu t-Tevarih" (Kurora e historisë) të Hoxha Sa'duddinit. Veprën e shkroi me urdhrin e Sulltanit. Vepra ka rëndësi të madhe, për arsye se autori i saj ishte njeri i Oborrit dhe i njohur edhe me burimet dhe politikën e Oborrit. Vepra mbeti e pabotuar, por dorëshkrimet janë ruajtur në bibliotekën e Stambollit.

Fazil Ahmet pashë Qypriliu. – Tashmë është provuar dhe kurrkush nuk e mohon se Qyprilinjët janë familje me origjinë shqiptare, e cila i dha Perandorisë Osmane disa sadriazemë dhe pashallarë. Ndër më të shquarit ishte Fazil Ahmet pasha. Vdiq më 1675. Shkroi një histori, e cila bën fjalë mbi pushtimin e Kretës, marrëveshjen në Kandije, mbi armët, anijet, ushtrinë e

të dy palëve, planet detare etj. E shkroi edhe një divan të plotë në gjuhën arabe. Veprat nuk janë botuar.

Hajrudin Leskoviku. – Për Hajrudin Leskovikun (Leskoviku Hayruddin) na mungojnë të dhënat biografike. Dimë se ishte nga Leskoviku, Shqipëria e jugut. Në parathënien e një libri thotë se dinte disa gjuhë të huaja. Një kohë ishte nëpunës në zyrën e censurës së shtypit të huaj në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, pastaj përkthyes me rastin e audiencës së ambasadorëve të huaj te kryeministri Halil Rif'at pasha. Bibliografia e veprave të tij, të botuara dhe të pabotuara, është shumë e madhe. Nga veprat më të rëndësishme historike, të botuara, do të përmendim vetëm tri:

1) *Historia politike e luftës së Krimesë*, vepër të cilën nuk e kemi pasur në dorë.

2) *Historia e udhëtimit të një ambasadori* – vepër të cilën e ka botuar “Shoqata historike osmane”, si libër të tretë të botimeve të veta. Nuk është çudi që autori të ketë qenë anëtar i shoqatës. Pas një hyrjeje në të cilën e analizon situatën politike të brendshme dhe të jashtme pas luftës së Krimesë, autori boton memoaret e Rasih Mustafa pashës, i cili ishte ambasador i Perandorisë Osmane në Petrograd dhe kishte zhvilluar bisedime me Kutuzovin. Libri ka një rëndësi të dorës së parë për politikën e atëhershme evropiane, sidomos për njohjen e politikës që ndiqte Rusia ndaj Turqisë. Në libër janë botuar edhe një varg dokumentesh zyrtare mbi këto probleme.

3) *Gjurmime rreth dokumenteve historike dhe politike*, botuar në Stamboll më 1910, me gjithsej 340 faqe. Libri përmban dokumente dhe materiale historike të shekullit XIX, tejet të rëndësishme për historinë diplomatike dhe për diplomatikën osmano-turke. Kemi këtu fermane, berate, dokumente mbi gra-

dimin e personave të ndryshëm, ka edhe dokumente të përkthyer nga gjermanishtja e frëngjishtja, ka një varg dokumentesh në lidhje me reformat, pjesë nga kujtimet e njerëzve të shquar, pjesë nga fjalimet etj. Të gjitha dokumentet i komenton në mënyrë precize dhe shumë moderne. Pra, kemi punë me një burim dokumentesh të botuara me një metodologji krejt bashkëkohore. Duke i njohur gjuhët evropiane dhe publikacionet historike të Evropës, ai përpiqet ta ndjekë metodën evropiane, duke përdorur edhe aparatit shkencor sipas modelit evropian.

Përveç veprave historike, Hajrudin Leskoviku botoi edhe nja dhjetë vepra të ndryshme letrare, një varg përkthimesh nga frëngjishtja, kryesisht autorë të dorës së dytë, si Kamij Flamaron, Zhorzh One etj. Një varg veprash janë adaptime veprash franceze, kryesisht tregime sentimentale, të cilat e tërhiqnin publikun lexues turk në atë kohë. Në një vepër ai i njofton lexuesit se ndodhen në shtyp ose do të botohen së shpejti edhe një varg veprash të tjera, të cilat ai i quan vepra shkencore dhe artistike si:

Kritika për Emil Zolën – ndoshta është fjala për “Unë akuzoj”,
 Fshehtësi (sekretet) e arteve,
 Arti i të shkruarit,
 Filozofia,
 Alfred de Myse,
 Fredriku i Tretë
 Bazat e mësimi të greqishtes.

Hajrudin Leskoviku e themeloi edhe një shtëpi botuese – “Kütüphanë-i sebat”.

Mehmet Mensur efendi. – Ishte i biri i njëfarë Abdullah efendiut nga Kolonja. Lindi në Manastir, ku i jati ishte mësues. Studioi në Manastir dhe në Stamboll. I mësoi në mënyrë të për-

sosur frëngjishten dhe greqishten e vjetër e të re dhe hyri si përkthyes në Portën e Lartë. Përparoi shpejt në shërbim dhe arriti të bëhej anëtar i Këshillit të Shtetit (Suray-i Devlet). Vdiq më 1896. Shkroi një varg veprash, nga të cilat do të përmendim disa, të botuara dhe të pabotuara:

Yunan Tarihi (Historia greke), pjesa e parë e botuar,

Esrar-i Farmason (Sekretet e farmasonëve), e botuar,

Ehl-i Salib vak'asi (Kryqëzatat), dorëshkrim,

Meshur Iskenderiye Kütüphanesine dair Risale-i Tarihiyye (Trajtesë historike mbi bibliotekën e famshme të Aleksandrisë), e botuar etj.

Ahmet Hamdi. – Në librin e vet “Arnavutluk hakkında mütale’a-i mustasara” (Shqyrtime të përmbledhura mbi Shqipërinë), botuar më 1920, Ahmet Hamdiu thotë se është me origjinë shqiptare. Ishte oficer dhe i kishte vizituar apo kishte qëndruar një kohë të gjatë në shumë vende të Shqipërisë, Maqedonisë dhe të Kosovës. Pastaj kishte qenë javer i Sulltanit dhe, si thotë edhe vetë, kishte pasur rast të njihet me shumë njerëz të mëdhenj. Libri i tij i lartpërmendur është shkruar me simpati të madhe ndaj shqiptarëve. Pasi që flet mbi shqiptarët në përgjithësi, mbi rolin e tyre në Perandorinë Osmane, ai i kushton një vëmendje të posaçme pushtetit xhonturk, duke e akuzuar për një politikë kriminale ndaj shqiptarëve. Njëkohësisht ai hedh poshtë shkrimet e shumë publicistëve turq, të cilët i akuzonin shqiptarët se ishin shkaktarë të katastrofës turke në luftërat ballkanike. Ai provon se edhe pushteti edhe ushtria ishin korruptuar, se xhonturqit kishin bërë çmos që shqiptarët t’i kthenin kundër vetes e jo t’i bënë për vete, se e pengonin emancipimin e tyre politik e kulturor etj.

Mufid Libohova. - Ali pashë Tepelena, qysh nga koha e Napoleonit e këndej tërhoqi vëmendjen e historianëve, udhëpërshkruesve, madje edhe të shkrimtarëve e poetëve evropianë. Mbi të kemi një varg veprash në gjuhën frënge, angleze, gjermane etj. Mirëpo, njërën nga veprat më kritike për të e shkroi Ahmet Mufidi, botuar në Stamboll më 1908. Libri ka 219 faqe me alfabet arab.

Autor i librit është Mufid Libohova, njeri i njohur mirë në historinë shqiptare nga 1908 deri më 1928. Mufid Libohova lindi në Libohovë më 1876. E kreu drejtësinë në Stamboll. Si 22-vjeçar ishte emëruar atashe në legatën turke në Bruksel. Më vonë bëhet sekretar i dytë dhe i parë në të njëjtën legatë. Më 1904 emërohet sekretar i parë i legatës turke në Suedi, kurse më 1905 është konsull i përgjithshëm në Larisë. Më 1908, pas shpalljes së kushtetutës dhe revolucionit xhonturk, ai është deputet i Gjirokastrës në parlamentin turk. Në qeverinë provizore të Ismail Qemalit Myfid Libohova në fillim është ministër i Punëve të Brendshme e pastaj ministër i Punëve të Jashtme. Por, për shkak të mosmarrëveshjeve me Ismail Qemalin, dha dorëheqje. Pas një kohe të shkurtër, u emërua delegat i Shqipërisë në Komisionin ndërkombëtar të kontrollit. Është merita e tij dhe e Syreja Vlorës që u demaskua dhe u burgos majori Beqir Grebena, i cili në atë kohë përgatiste një grusht shtet në favor të xhonturqve në Vlorë. Me ardhjen e Princ Vidit, M. Libohova bëhet ministër i Punëve Publike. Edhe në qeverinë e dytë të Turhan pashës në Evropë, M. Libohova figuronte si ministër i Punëve të Jashtme. Më 10 korrik 1914 dha dorëheqje. Në gusht të vitit 1914, duke qenë se Adhamidi refuzoi të shkojë si ambasador në Romë, në vend të tij u emërua M. Libohova. Sipas raporteve të konsullit austriak nga Durrësi, M. Libohova ishte njeriu më i talentuar midis gjithë njerëzve të politikës shqiptare

të asaj kohe. Fliste e shkruante shqip, turqisht, greqisht dhe frëngjisht. Mirëpo, qysh në atë kohë ishte i lidhur me Italinë. Siç shkruan V.Löwenthal-i nga Durrësi, M. Libohova ishte i rezervuar edhe ndaj Princ Vidit dhe pret “të tjera eventualitete” kur ai do të luajë rolin kryesor. Me Esat pashën kalonte mirë, kurse me grekët nuk kishte marrëdhënie të këqija, sado që vazhdimisht e thoshte të kundërtën. Kur bandat greke e pushtuan Libohovën, nuk e prekën shtëpinë e tij. Nga kjo kohë e deri kah viti 1928 M. Libohova vazhdimisht luan një rol me rëndësi në politikën shqiptare, por mjerisht më tepër rol negativ. Ai është kundër qeverisë së Kongresit të Lushnjës; kur erdhi në pushtet Fan Noli me shokët e tij, M. Libohova iku jashtë dhe pastaj, në koordinim me Zogun, depërtoi me ithtarët e vet nga Greqia. Në kohën e Zogut ishte vazhdimisht ministër. Ai, si ministër i Financave, e lidhi marrëveshjen me Italinë, me ç’rast bëri malverzime të mëdha. Prandaj Zogu që i detyruar ta zëvendësonte me një italianofil tjetër, me Fevzi Alizotin.

Por, neve këtu na intereson më tepër M. Libohova si historian i Ali pashë Tepelenës. Në parathënien e librit, Myfid Libohova thotë se veprën e shkroi para gjashtë vjetësh, kur ishte sekretar i ambasadës turke në Belgjikë dhe se e botoi në Kajro. Tash, pas shpalljes së lirisë, domethënë pas shpalljes së Revolucionit xhonturk, librin e boton në Stamboll, por me disa plotësime, ndryshime e rektifikime. Në hyrje ai thotë: “Autorët e huaj, sado që kanë shkruar shumë vepra mbi të, shumica e këtyre veprave u ngjajnë legjendave dhe miteve greke; janë të mbushura me gabime, falsifikime dhe me shovinizëm e urrejtje ndaj fesë islame, njësoj si në kohën e kryqëzatave në mesjetë. Këto vepra jo vetëm që nuk mund ta fitojnë besimin tonë, por nuk përmbajnë as të dhëna dhe informata të sakta.” Autori vë në pah se vite me radhë kishte mbledhur lëndë për këtë vepër, i

kishte studiuar të gjitha veprat e botuara mbi Ali pashën. “Sado që jam bashkëvendas i tij dhe shqiptar si ai – vazhdon autori – jam përpjekur të jem sa më objektiv në paraqitjen dhe vlerësimin e jetës dhe të veprave të tij.” Në “Islam Ansiklopedisi”, artikulli mbi Ali pashë Tepelenën është shkruar kryesisht në bazë të kësaj vepre të Myfid Libohovës, për të cilën autori thotë se është më objektive dhe më kritike.

Syreja Vlora (në burimet turke: Avlonyali Süreyya) – rrjedh nga familja e vjetër feudale Vlora, themelues i së cilës merret Gjergj Sinan pasha, bejlerbej i Konjës dhe admiral i madh i marinës turke, i cili vritet në një betejë në Vlorë më 26.4.1503. Syreja Vlora lindi në Vlorë më 1860. Ai ishte i biri i Mustafa pashë Vlorës dhe vëlla i vezirit të madh Ferid pashë Vlorës, vezir i madh 1903-1908. Mbi shkollimin e tij nuk kemi të dhëna, por në bazë të shkrimeve të tij mund të konkludohet se kishte një dije shumë të thellë të gjuhëve orientale nga historia dhe letërsia. Në skenën politike shfaqet më 1895, kur së bashku me kushëririn e vet Xhemil bej Vlorën u dënua tre vjet nga pushteti turk, por shpëtoi duke ikur në Itali. Meqenëse kishte lidhje të forta në Stamboll, ai u fal dhe më 1903 shkoi në Stamboll dhe u vendos atje. Atëherë, në sajë të të vëllait, Ferid pashë Vlorës, u emërua drejtor i Përgjithshëm i doganave turke, në të cilën detyrë mbeti deri në revolucionin xhonturk. Në luftën që bëhej në Stamboll rreth alfabetit pas revolucionit xhonturk, Syreja Vlora u angazhua në mënyrë direkte dhe më 15 janar 1910 botoi në gazetën “Yeni gazete” një artikull të gjatë në të cilin e mbron alfabetin latin. Në parlament u zgjodh si deputet i Vlorës. Në një diskutim në parlamentin turk më 1912 mbajti një fjalim shumë të ashpër kundër politikës turke në Shqipëri, për çka qe i detyruar të ikë nga Stambolli, me ndihmën e ambasadorit au-

striak, me të cilin vazhdimisht mbante lidhje. Kah mesi i vitit 1912 S. Vlora e kishte të qartë se do të shpërthente lufta ballkanike dhe përpiqet të marrë disa hapa në lidhje me fatin e Shqipërisë, duke llogaritur vazhdimisht në Austro-Hungarinë. Me të filluar lufta midis Malit të Zi dhe Turqisë, ai e dërgoi të birin Eqrem Vlorën në Vjenë të sigurojë përkrahjen për shpalljen e pavarësisë, ose Austro-Hungaria ta pranojë proktetoratin mbi Shqipërinë. Mirëpo, Austro-Hungaria, e cila nuk besonte se Turqia do ta humbte luftën, nuk ndërmoi gjë, as që Syreja Vlora mundi t'i grumbullonte në Vlorë krerët shqiptarë. Atë që s'mundi ta realizonte Syreja Vlora, e siguroi Ismail Qemali. Ndoshta kjo qe arsyeja që shkaktoi një mostolerancë midis shtëpisë së Syreja Vlorës dhe të Ismail Qemalit. Madje, S.Vlora nuk mundi ta bëjë për vete as Esat pashën, motrën e të cilit e mbante për grua, as Prenk Bib Dodën, të cilët mendonin të shpallëshin vetë princa të Shqipërisë. Kur dështoi me planet e veta, S. Vlora nëpërmjet Shën Gjinit dhe Kotorrit udhëtoi në Vjenë. Në qershor të vitit 1913 u kthye në Vlorë, u përpoq t'i pajtojë Ismail Qemalin dhe Esat pashën, por pajtimi i tyre qe jetëshkurtër. Kur e formoi qeverinë Turhan pasha, pas ardhjes së qeverisë së Princ Vidit, Syreja Vlora u emërua ambasador i Shqipërisë në Vjenë. Gjatë luftës botërore pjesën më të madhe të kohës e kaloi në Zvicër. Më 12 tetor 1918, një grup politikanësh shqiptarë të vendosur në Gjenevë, midis të cilëve ishin Turhan pasha, Syreja Vlora, Visarion Dodani, i dërgoi një telegram ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, Soninos, duke i kërkuar që Italia t'i mbrojë interesat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe që ushtria italiane ta okupojë provizorisht gjithë Shqipërinë. Kjo shkaktoi reagim të ashpër të një grupi tjetër shqiptarësh në Zvicër, të grumbulluar rreth revistës "L'Albanie", të cilët dërguan telegram me përmbajtje të kundërt, duke u

përpjekur për pavarësinë e Shqipërisë. Nga Lozana Syreja Vlora kaloi në Romë, ku u vendos. Më 1923 u kthye në Vlorë. Deri sa vdiq më 1940, nuk luajti ndonjë rol në politikën e Shqipërisë. Syreja Vlora shkroi këto vepra:

1) *Fitnetu-l-Islam* (Divergjencat islame), në Stamboll më 1910, 338+45 faqe. Kjo është biografia e Muavijes, të birit të Abu Sufjanit, themeluesit të dinastisë së Omejadëve. Vepra është shkruar në mënyrë shkencore dhe moderne, me shfrytëzimin e shumë veprave arabe. Ai përpiket ta ndriçojë në mënyrë objektive biografinë e këtij halifi, për të cilin autorët shiitë dhe bektashinj kanë shkruar një varg veprash, duke e paraqitur në mënyrë tejet negative. Nga vepra, në mënyrë indirekte, mund të nxirret përfundimi se S.Vlora është musliman sunit dhe se ai në këtë mënyrë bën një polemikë me bektashinjte.

2) *Dherrat* – revistë, botuar në Stamboll në vitin 1886/7. Nga kjo revistë unë gjeta vetëm pesë numra. Numri i parë ka 32 faqe, kurse numrat 2-5 janë të lidhur bashkë dhe kanë së bashku 160 faqe. Revista nuk ka ndonjë fizionomi të caktuar, por si shkruan S.Vlora në *Parathënie*, qëllimi i tij ishte të paraqiste një përmbledhje mbi veprat e ndryshme që i kishte lexuar gjatë qëndrimit të tij në Vlorë. Këtu gjejmë artikuj mbi Bajronin, Velingtonin, Napoleonin, historinë e zanateve, mbi Korenë, Valter Skotin, Makijavelin etj. Të gjithë artikujt i ka shkruar vetë S.Vlora.

3) *Tarih-i osmanide Arnavutluk* (Shqipëria në historinë osmane), botuar në kalendarin “Shqipëtar i ilustruar” (Müsavver Arnavud) të Dervish Himës në Stamboll më 1911. Këtu është botuar vetëm pjesa e parë, por pjesa e dytë nuk u botua kurrë, sepse nuk doli numri i dytë i Kalendarit. Ky punim, që është më i gjati në këtë kalendar, ka shumë të dhëna mbi marrëdhëniet turko-shqiptare. Literatura e cituar provon se S.Vlora kishte dituri të madhe nga historiografia turke.

4) *Hatirat ve Teracim-i Ahval* (Kujtimet dhe biografitë), vepër e cila ka mbetur dhe sot ruhet në Institutin e Historisë në Tiranë, inventarizuar me titullin “Shënime dhe kujtime mbi Shqipërinë”. Mbi këto memoare nuk kemi të dhëna, vetëm që ato citohen në “Historinë e popullit shqiptar”. I citon gjithashtu edhe Eqrem bej Vlora në memoaret e veta.

Mehmet Ali Agaraj, i biri i Abdullah bej Selim Mustafa Agarajt, lindi më 1843. Familja e tij rrjedh nga katundi Kardhiq i Kurveleshit, por që ishte shpërngulur në Delvinë. Për shkak të një kryengritjeje kundër pushtetit turk, e tërë familja i qe internuar në Janinë. Këtu i kreu mësimet fillestare dhe elementet fetare. Pas amnistisë familja kthehet në Delvinë. Këtu Mehmet Aliu mori mësimet private nga arabishtja dhe turqishtja, të cilat i zotëroi mjaft mirë, dhe njëkohësisht e kreu edhe gjimnazin e ulët (Ruzhdije). Mjaft i ri hyri në ushtri dhe pas një kohe bëhet toger, e pastaj shkon në Stamboll dhe pas katër viteve e kryen Akademinë Ushtarake. Kjo ia hapi derën e sarajit të Sulltanit, ku bëhet kapuxhibashi dhe fillon përparimi i tij i shpejtë. Nga Stambolli shkon në Delvinë si kajmekam i Kurveleshit dhe i Himarës. Pas një kohe të shkurtër e tërheqin në mënyrë urgjente në Stamboll, ku bëhet jever (adjutant) i Sulltanit, gradohet kolonel e pas një kohe fiton edhe gradën e gjeneralit. Nga ushtria kalon në administratë – Kajmekam i Delvinës, i Tarsusit, kurse më 1888 bëhet mytesarif (sanxhakbej) i Kandijës në Kretë, si dhe në një varg sanxhaqesh në Anadoll. Më 1895 e gjejmë si mytesarif të Jeni-Pazarit, ndërsa më 1902 mytesarif të Korçës. Duket se në këtë kohë pensionohet. Nuk dimë se kur vdiq, por me siguri pas vitit 1920.

Agaraj shkroi një vepër me titull *Ibret-nâme* (Libër mësimesh, shembujsh), që është një kronikë e kohëve të vështira, të

cilat i përjetoi ai pas vitit 1912 e deri në dëbimin e italianëve nga Vlora. Sado që jep një pasqyrë mbi historinë e Shqipërisë së jugut qysh nga Ali pashë Tepelena, vëmendjen kryesore ia kushton okupacionit të Shqipërisë së jugut nga grekët, flet mbi vrasjet, plaçkitjet, djegiet, pastaj mbi ngjarjet në kohën e Princ Vidit, mbi Esat pashën, shkatërrimet, varfërinë, urinë dhe sëmundjet gjatë Luftës Botërore, mbi okupacionin francez të Korçës, luftën e Vlorës etj., deri sa bëhet stabilizimi i brendshëm në Shqipëri.

Vepra mbeti dorëshkrim dhe ndodhet në Institutin e Historisë në Tiranë.

Hasan Basri Dukagjinzade ka shkruar veprën *Arnavutluk ve Osmanli Buhrani* (Shqipëria dhe kriza osmane), botuar më 1910. Ky Hasan Basri është, në të vërtetë, deputet i Dibrës në parlamentin e parë xhonturk. Për Basri bej Dukagjinin në disa burime thuhej se ishte bullgar, por kjo mua nuk më duket e besueshme. Mbi këto çështje kam folur më shumë në një vend tjetër. Në kohën e Luftës së Dytë Botërore ishte internuar në Austri, nga e çlirojnë trupat aleate dhe kalon në Paris. Në vitet 1920-1923 ai i botoi në Paris tri vepra frëngjisht, ku jep edhe biografinë e vet, duke theksuar se është me origjinë shqiptare dhe vazhdimisht nënshkruhet Basri beg de Dukagin e në një vend edhe Basri beg prince de Dukagin. Parathënien e veprës së tij “L’Albanie independante et l’-Empire Khalifal ottoman”, botuar në Paris më 1920, e botoi *Klod Farer*. Ishte mik i Pjer Lotit, Lord Kiqenerit dhe shumë njerëzve të shquar të asaj kohe.

Vepra e tij “Shqipëria dhe kriza osmane” (botimi i dytë më 1911, 191 faqe) ka rëndësi për njohjen e politikës xhonturke ndaj shqiptarëve. Pjesa dërrmuese e librit është shkruar në formë kujtimesh, ku një pjesë e veçantë iu kushtohet zgjedhjeve

parlamentare, politikës xhonturke që zgjedhjet t'i zbatojë sipas qejfit të vet, mbi qëndrimin e shqiptarëve kundër zgjedhjeve të imponuara, mbi kryengritjet shqiptare. Në këtë vepër janë botuar edhe mjaft letra me rëndësi, të cilat Basri beu ua ka dërguar personaliteteve të ndryshme, ose letra që i janë dërguar Basri beut, midis të cilave edhe një letër e Ismail Qemalit dërguar Basri beut nga Parisi.

Përveç autorëve të lartpërmendur, kemi shënime edhe për disa të tjerë, si p.sh. *Ahmet Hilmi pasha Bendon*, i cili botoi një vepër mbi luftën turko-malazeze, në të cilën mori pjesë edhe vetë, njëfarë *Habil Adem* botoi një libër me titull “Historia e madhe shqiptare”, të cilën s’kemi mundur ta gjejmë, *Mehmed Ferid Shpuza* përktheu një vepër historike, *Mehmed Rauf Leskoviku* botoi një libërth me titull “Ç’ka qenë komiteti ‘Bashkim e përparim’” e të tjerë.

IV. DISIPLINAT SHKENCORE

Duke mos hyrë në çështjen e klasifikimit të disiplinave shkencore, ne në këtë kapitull do të fusim ato disiplina të cilat në atë kohë merreshin si të tilla, si dhe duke ndjekur kriteret e orientalistëve evropianë, të cilët, pak a shumë, e respektojnë ndarjen që e kanë bërë arabët në mesjetë. Pra, këtu do të fusim trajtesat e ndryshme mbi letërsinë, disiplinat fetare (komentimin e Kur'anit, traditën islame /Hadithin/, të drejtën e sheriatit, trajtesa në lidhje me tesawufin /mistikën/ islame, në lidhje me moralin, veprat pedagogjike – psikologjike) etj. Për arsye praktike, historio-grafinë dhe leksikografinë e gramatologjinë i kemi dhënë në kapituj të veçantë, sado që edhe këto disiplina hyjnë këtu.

Jusuf Janinasi (Yanyali Yusuf), e shkroi në vitin 1581 “*Tenbîh al-Gâfilîn*” (Të tërhequrit vërejtje të pakujdesshmëve), e cila mbeti dorëshkrim. Nuk e kemi pasur në dorë, kështu që nuk dimë me siguri se nga cila disiplinë është, megjithqë supozojmë se është nga mistika islame.

Osman efendi Dukagjini është i biri i Mehmet pashë Dukagjinit. Edhe në burimet turke përmendet si Dukaginzade – Dukagjinas. Dihet se ishte kadi i Stambollit dhe e shkroi një vepër mbi kadilerët e Stambollit, të rreshtuar sipas rendit alfabetik. E shkroi edhe një vepër me titull “*Ezher al-xhama’il*” (Lulet e veprave të mira). Vdiq në vitin 1603.

Omer Fani efendiu ishte me origjinë nga Dibra. Vdiq më 1622. Ishte marrë me komentimin e Kur'anit dhe, për shkak se

ishte dalluar në këtë disiplinë, ia kishin dhënë ofiqin “Tefsîrî” (Komentator). Jetoj në Stamboll dhe qe vaidh (predikues) në xhaminë e Aja Sofisë, gjë që provohet vetvetiu se konsiderohej një ndër dijetarët më të shquar në disiplinat fetare.

Esat Janinasi – Në fillim të shekullit XVIII, një vend me rëndësi në shkencat ekzakte turke zë Esat Janinasi (Yanyali Es’ad efendi). Së pari u shkollua në një medrese në vendlindjen e tij e pastaj në Stamboll. Se sa autoritet kishte, tregon fakti se u emërua myderriz, d.m.th. profesor në një nga medresetë më të shquara të Stambollit, në atë të Ejubit, pastaj u emërua kadi i Gallatasë. Kur u hap shtypshkronja e parë më 1729, u bë redaktor i saj. Famë të madhe ai fitoi me përkthimin e veprave të Aristotelit nga greqishtja në arabishte, midis të cilave më e njohura është Fizika (Phisiki akroasis). Ky është përkthimi i parë i kësaj vepre në gjuhën arabe me titull “Al-Kutub as-samaniya fi simai-t-tabî’i”. Ky nuk është vetëm përkthim i thjeshtë, por ka shumë shënime dhe shtesa, gjë që e bën thuajse një vepër origjinale. Ai thotë se për shpjegimet e ndryshme kishte shfrytëzuar komentet e Ioanis Kuttiniusit nga Karaferja. Në parathënie gjithashtu flet mbi komentatorët e interpretuesit e Aristotelit si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, p.sh. mbi Albertus Magnus, Scotus Erigena dhe Shën Tomasin e Akunit, kurse nga filozofia e Lindjes në mesin e atyre që janë marrë me Aristotelin përmend al-Farabinë, filozofin e madh arab dhe Ibn Sinanë (Avicenna). Në fund, pasi që thekson se “sikur të mos ishte fizika e Aristotelit, nuk do ta kishim shkencën e sotme”, ai e fillon përkthimin. Në mesin e shtesave që bëri Esat Janina janë ato mbi teleskopin dhe mikroskopin, kështu që është i pari në Turqi i cili flet mbi këto zbulime të rëndësishme. Esat efendi është gjithashtu i pari në Turqi që përktheu një vepër di-

rekt nga greqishtja. Bashkëkohanikët thonë se greqishten e din-te si gjuhën amtare, mirëpo nuk përmendin se cila ishte gjuha e tij amtare, e ne supozojmë se ishte shqipja.

Refi Janina ishte profesor i Shkollës së Lartë Administrative (Mekteb-i Sultânî) qysh nga hapja e saj. Vdiq më 1902. Shkroi një varg veprash nga gramatika arabe dhe tradita islame, nga të cilat disa janë botuar. Kishte qenë profesor në shkollën greke në Fanar të Stambollit dhe kishte hartuar edhe një fjalor turqisht-greqisht.

Nga Janina ishin edhe *Hoxha Ymer Janinasi*, i cili e botoi më 1895 në Stamboll veprën “Mecmûatu d-durûs” (Përmbledhje ligjëratash), si dhe *Ismail Janinasi*, që e shkroi veprën “Risa-le-i kudsiye” (Trajtesa e shenjtë), botuar në Stamboll.

Abidin pasha Dino-Preveza (në burimet turke Abidin pasa, Abidin pasa Dino dhe Prevezeli Abidin pasa) ishte burrë shteti, letrar dhe patriot shqiptar. Lindi në Prevezë më 1846. I ati, Ahmet beu, ishte pronar tokash. Mësimet fillestare i kreu në vendlindje, kurse shkollimin e mesëm në Gjimnazin Zosimea të Janinës në gjuhën greke. Këtu e mësoi jashtëzakonisht mirë edhe frëngjishten. Nga Janina shkoi në Stamboll, ku hyri në shërbimin ushtarak, por nuk zgjati shumë kohë dhe u kthye në Prevezë, si ndihmësmytesarif dhe kajmekam i qytetit. Nga këtu u transferua në Izmir si zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit, e pak më vonë si kryetar i një komisioni të jashtëzakonshëm të formuar në Izmir. Kur u suprimua ky komision, u emërua si mytesarif i Sofjes, por nuk shkoi atje dhe u dërgua në Tekfurdag e pastaj në Varnë. Nga këtu e kthyen në Stamboll, ku u emërua si komisar i bursës në Gallata të Stambollit, detyrë në të

cilën mbeti pesë vjet e disa muaj. Në këtë kohë botoi një vepër mbi borxhet e Perandorisë Osmane, operacionet e bursës dhe operacionet financiare, por titullin e veprës nuk e dimë. Në këtë periudhë punoi edhe në komisionet e ndryshme. Me urdhrin e Sulltanit ai hartoi projektin mbi zgjedhjet e deputetëve. Atëherë, edhe më vonë kur ishte vali i Vilajetit të Athinës, botoi shumë vjersha në gjuhën greke në gazetën greke të Stambollit "Silogos". Gjatë luftës ruso-turke më 1877 u emërua komisar i Brusës, por atje nuk mbeti gjatë, sepse kah fundi i vitit 1878 u dërgua në Shqipëri si komisar i një komisioni në krye të të cilit ishte komandanti i ushtrisë turke të Vilajetit të Janinës Muhtar pasha. Komisioni kishte për detyrë të bënte tratativa me përfaqësuesit e qeverisë greke rreth kufirit greko-turk në Shqipërinë e jugut dhe në Thesali dhe mbi dorëzimin e disa territoreve Greqisë sipas rekomandimeve të Kongresit të Berlinit. Në këtë kohë ai ishte në udhëheqjen e pjesës jugore të Lidhjes së Prizrenit, së bashku me Abdyl Frashërin, Mehmet Ali bej Vrionin e të tjerë. Atëherë ai grumbulloi rreth vetes parësinë e Shqipërisë së jugut, kurse sipas disa burimeve edhe 30.000 vullnetarë, të vendosur që ta mbrojnë çdo pëllëmbë të tokës së tyre. Fakti që një pjesë e Vilajetit të Janinës as atëherë e as më vonë, deri më 1912, nuk i takoi Greqisë, është kryesisht meritë e Abidin pashës, i cili edhe më vonë, si ministër i Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane i përballonte presionit të fuqive të mëdha, të cilat kërkonin dorëzimin e territoreve mjaft të mëdha Greqisë. Mu për këtë aktivitet të tij, atë e tërhoqën në Stamboll dhe më 1879 u dërgua në Dijar Bekir si kryetar i komisionit për zbatimin e reformave në Kurdistan. Këtu mbeti nja gjashtë muaj e pastaj, në rangun e bejlerbeut të Rumelisë, u emërua vali i Selanikut. Prej këtu, në qershor të vitit 1880 u thirr në Stamboll, iu dha rangi i vezirit dhe u emërua ministër

i Punëve të Jashtme. Ka disa indikacione se Sulltani, duke e emëruar atë ministër të Punëve të Jashtme dhe një numër shqiptarësh të tjerë në pozita të larta në Shqipërinë e jugut, dëshironte që me anën e tyre t'i qetësonte shqiptarët dhe t'i bindte ta pranonin revidimin e kufijve me Greqinë dhe Malin e Zi. Mirëpo, ambasadorët e huaj në Stamboll ankohen në Abidin pashën se vazhdimisht e shtynte zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit. Kur u ndërrua qeveria, në krye të së cilës ndodhej Kadri pasha, u ndërrua edhe Abidin pasha dhe u emërua vali i Vilajetit të Athinës. Këtu mbeti katër vjet e nëntë muaj. Nga Athina Abidin pasha u transferua si vali në Sivas, ku arriti në janar të vitit 1886. Pas një viti u emërua vali i Ankarasë, ku mbeti shtatë vjet e shtatë muaj. Atëherë në Ankara u shfaq lija, me të cilin rast i vdiq edhe i ati, Ahmeti. Nga këtu u transferua në Rodos si vali i arkipelagut. Këtu iu dorëzua dekorata “Palme” e Akademisë Franceze. Nga Rodosi u thirr që të merrte pozitën e vezirit të madh, por vdiq papritmas. Roli i tij në lëvizjen kombëtare shqiptare ende nuk është sqaruar si duhet. Sado që në “Historinë e popullit shqiptar” (ed. i Prishtinës, II, 154, 156) Abidin pasha paraqitet si njeri që kishte ndjekur një politikë dyfytëshe, se ishte kundër idesë mbi autonominë e Shqipërisë duke pasur frikë për çifligjet e veta, në bazë të burimeve tjera mund të konkludohet me siguri se ishte një nga faktorët kryesorë të degës së jugut të Lidhjes së Prizrenit, se ai, si personalitet më autoritativ, i kishte organizuar mbledhjet e parësisë shqiptare në shtëpinë e vet, se me të gjitha fuqitë kishte luftuar për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë së jugut, se ishte ithtar i idesë që si alfabet i shqipes të merret alfabeti latin, se kishte kërkuar formimin e një vilajeti shqiptar, se kishte kërkuar që valitë dhe nëpunësit e vilajetit të jenë shqiptarë etj. Fakti se ishte kundër autonomisë shqiptare, është më tepër

shenjë e një realiteti politik sesa frikë për çifligjet e veta, se asnjë patriot në atë kohë nuk mendonte se do të bëhet nacionalizimi i çifligjeve. Idenë mbi status-quonë në Ballkan e përkrahte edhe Ismail Qemali, madje edhe në vitin 1907 në intervistën dhënë gazetës italiane “Tribina” (Romë, 27 korrik 1907, nr. 207), deklaronte se shqiptarët ishin ende të dobët për t’i mbrujtur territoret e tyre nga fqinjët e fuqishëm. Edhe i vëllai i Abidin pashës, Veysel bej Dino, gjithashtu ishte në udhëheqjen e degës së jugut të Lidhjes së Prizrenit.

1) *Veprat e Terceme ve serh-i Mesnevi-i serif* (Përkthimi dhe komenti i Mesnevisë) – është, siç shihet nga titulli, përkthimi turqisht dhe komenti i veprës së famshme të Xhelaluddin Rumisë “Mesnevi”, botuar në Stamboll më 1908 në dy vëllime. Punimi është bërë në një mënyrë krejt moderne: së pari është dhënë një dyvargësh në gjuhën persiane, pastaj përkthimi turqisht, e pastaj komentimi i dyvargëshit. Meqenëse edhe vetë Abidin pasha ishte pjesëtar i tarikatit halveti dhe e njëjtte mirë mistikën islame, komentimi i tij merret si më i miri. Vepra ka gjithsej 1.668 faqe, ndërsa në fillim të saj është biografia e Abidin pashës të cilën e shkroi vetë.

2) *Kolera hakkinda mekal-i nafia* (Trajtesë e dobishme mbi kolerën), botuar në Ankara pa shënuar vitin e botimit. Kjo është një broshurë mbi kolerën, të cilën e shkroi Abidin pasha në kohën kur u përhap kolera në Vilajetin e Ankarasë. Këtu ai jep udhëzime se çfarë masash preventive duhet marrë, si duhet izoluar i sëmuri etj. Vepra është kompiluar sipas librave medicinale francezë.

3) *Dünya-yi se’adet* (Lumturia në këtë botë), botuar së pari në Rodos, ribotuar më vonë edhe në Stamboll. Në këtë vepër kushtuar çështjeve etike, ai polemizon me ateistët dhe darvinistët. Në mbrojtjen e pikëpamjeve të veta mbështetet te Paskali, Flamarioni, Montegace etj.

4) *Terceme ve serh-i kasideti l-burda* (Përkthimi dhe komentimi i “Kasidatu l-burda”). “Kasidatu l-burda” është një vjershë e gjatë, me të cilën poeti arab al-Busiri lavdëron Muhamedin. Abidin pasha këtë kasidë e përkthen turqisht dhe e komenton. Me këtë përkthim ai provon se është njohës po aq i mirë i arabishtes, si dhe i persishtes.

5) *Mesnevi-i serifteki arabi kisas sarhi* (Komenti i tregimeve arabe në Mesnevinë e nderuar), vepër të cilën nuk e kam parë, por e cila është botuar dhe përmendet në shumë burime.

6) *Ber tarz-i nevin nahv- arabi* (Gramatika arabe sipas metodës së re), botuar në Rodos më 894. Kjo është me të vërtetë një gramatikë e arabishtes shkruar në mënyrë të re dhe dallohet nga gramatikat që botoheshin në atë kohë. Ka gjasë që autori të ketë përdorur gramatika të arabishtes botuar në Evropë.

Ibrahim Sitki efendiu ishte nga Shkodra. Mbi jetën e tij kemi shumë pak të dhëna. Dihet se kishte studiuar në medresenë e Shemsi pashës në Yskydar të Stambollit. Kishte hartuar dy vepra trajtesash të ndryshme – njëra përmban 12 trajtesa, kurse tjetra 15 trajtesa. Shumica e trajtesave janë të traditës muslimane. Veprat nuk janë botuar.

Zijaudin i biri i Ali Ajdonatit, vdiq më 1817. Shkroi një trajtesë mbi shokët e Muhamedit dhe virtytet e tyre.

Sylejman Fehmi Delvina ka qenë profesor i letërsisë turke në Idadije dhe pastaj në Shkollën e Lartë Administrative në Stamboll. Ne e kemi pasur në dorë vetëm veprën Edebiyat (Letërsi), e cila kishte tri edicione. Është një vepër tejet sistematike, precize, praktike, një lloj hyrjeje në letërsi dhe njëkohësisht hyrjeje në teorinë e letërsisë së përgjithshme dhe të letërsisë turke.

Hoxha Tahsini – Turkologu i njohur rus Smirnov në veprën e vet “Ocerk istorii literaturi”, botuar në Petrograd më 1891, për Hoxha Tahsinin thotë se është Lomonosovi i Turqisë. Hasan Tahsini lindi në katundin Ninat, në kazanë e Filatit në Çamëri më 1812. I ati i tij, Osman efendiu, ishte njeri shumë i ditur dhe Mustafa pashë Bushati e thirri në Shkodër për mësues të vet. Më vonë u bë myfti i Beratit. Hasan Tahsini në fillim mësoi tek i ati, pastaj erdhi në Stamboll, u regjistrua në një medrese dhe diplomoi te dijetari i njohur i asaj kohe Vidinli Mustafa efendiu. Reformatori i madh turk Mustafa pasha dërgoi nga mesi i shekullit XIX një grup studentësh në Paris, midis të cilëve ishte edhe Hoxha Tahsini, i cili, sado që ishte myderriz, zgjodhi të studiojë “shkencat e reja”, të cilat nuk studioheshin në Turqi. Hoxha Tahsini studioi shkencat natyrore dhe pasi i kreu studimet, u bë imam në ambasadën turke në Paris, duke i vazhduar studimet në kimi, fizikë dhe astronomi. Kur në vitin 1868 vdiq në Nicë ish-veziri i madh Fuad pasha, Hoxha Tahsini u caktua ta përcillte kufomën e tij në Stamboll. Në të njëjtin vit në Stamboll u themelua Universiteti i parë turk (Dar ul-Funun) dhe si rektor i parë u zgjodh Hoxhë Tahsini. Ligjërata e tij hyrëse, në të cilën foli mbi arsyet e prapambajtjes së botës islame dhe nevojën e studimit të shkencave moderne evropiane, nuk u pëlqeu qarqeve konservative fetare, e sidomos Shejhul Islamit. Në universitet mbante ligjërata nga kosmografia, astronomia dhe barazimet. Nga fundi i vitit 1879 erdhi në Stamboll ideologu i njohur i panislamizmit Xhemaluddin al-Afgani dhe mbajti një ligjëratë në Universitet, e cila nuk u pëlqeu as qarqeve fetare as Sulltanit. Për këtë shkak universiteti u mbyll, kurse Hoxha Tahsini u pensionua me një pension të vogël. Kjo gjë e deprimoi tepër dhe sipas këshillës së miqve dhe për arsye shë-

ndetësore, shkoi në vendlindje. Sipas disa burimeve, atje shpërndau një abetare të tij shqip botuar me alfabet arab.

Dihet se disa pashallarë dhe intelektualë shqiptarë të vendosur në Stamboll filluan të grumbulloheshin kah viti 1864 me lejen e vezirit të madh Ali pashës dhe të shqyrtojnë çështjen e alfabetit shqip. Mirëpo, duke qenë se më vonë konstatuan njëfarë rezerve te organet turke, filluan të tërhiqen dhe ta braktisin këtë ide. Kah viti 1867 Hoxha Tahsini filloi përsëri t'i grumbullojë rreth vetes këta në dhomën e tij në një medrese ku banonte. Në këto mbledhje, midis tjerash, merrnin pjesë Ibrahim Temo Starova, Konstantin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Jani Vreto etj. Meqenëse numri më i madh i pjesëmarrësve ishin muslimanë, në fillim u propozua që si alfabet i shqipes të merrtet ai i arabishtes. Prandaj, kërkuan edhe mendimin e Hoxha Tahsinit. Hoxha Tahsini tha se sipas Kur'anit të gjitha gjuhët janë të barabarta dhe të gjitha alfabetet janë njësoj të respektuara. Muslimanët i konsiderojnë si libra të shenjtë edhe Biblën, edhe Testamentin e ri, e këto nuk janë të shkruara me alfabetin arab. Për shkak të autoritetit të Hoxha Tahsinit, të gjithë muslimanët e pranishëm e aprovuan mendimin e tij. Në komisionin i cili punonte në hartimin e të njëjtit alfabet ishte edhe Hoxha Tahsini. Ai ishte më i lehtë dhe më i bukur se alfabeti latin dhe grek. Hoxha Tahsini, madje, mendonte se ky alfabet universal dhe ai më vonë do ta përpunonte idenë mbi një alfabet universal dhe mbi një gjuhë universale botërore në revistën e vet *Mecmau-i Ulum*. Por, për shkak të vështirësive teknike rreth botimit të librave, ky alfabet nuk u pranua, por u pranua ai të cilin e propozoi Samiu.

Mbi aktivitetin e mëvonshëm të Hoxha Tahsinit në lidhje me çështjen shqiptare nuk kemi të dhëna. Vetëm në një burim

turk përmendet se në kohën e Lidhjes së Prizrenit kishte qenë njëherë në Prizren, por nuk dimë me çfarë qëllimi.

Sipas mendimit unanim të burimeve turke, Hoxha Tahsini ishte njeriu më i mësuar i kohës në Stamboll jo vetëm në shkencat natyrore, por edhe në ato letrare, filologjike dhe teologjike. Sami Frashëri, në artikullin e botuar në revistën “Hafta” pas vdekjes së Hoxha Tahsinit, thotë se ishte i vetmi në Perandorinë Osmane i denjë që ta bartte titullin “Savant” (Dijetar). Hoxha Tahsini themeloi revistën “Macmuai Ulum” (Revista shkencore), nga e cila kemi gjetur vetëm 7 numra. Gati të gjithë artikujt në të janë shkruar nga Hoxha Tahsini. Siç thotë vetë në *Parathënie*, revista është e ngjashme me revistat evropiane kushtuar shkencave dhe arteve. Dhe, me të vërtetë, gjysma e revistës u kushtohet shkencave të ndryshme teknike dhe natyrore dhe zbulimeve shkencore, kurse gjysma tjetër letërsisë dhe filozofisë. Një varg veprash të Hoxha Tahsinit, të cilat janë ribotuar më vonë si libra më vete, së pari janë botuar këtu. Këtu gjejmë trajtesa tejet interesante nga lëmi i linguistikës, letërsisë dhe filozofisë, nga të cilat shihet se si Hoxha Tahsini përpiket që dijën e fituar në Paris ta transmetojë në Turqi.

Gjatë jetës së vet Hoxha Tahsini botoi disa vjersha, ndërsa një divan i tij vjershash turqisht ka mbetur i pabotuar. Pas vdekjes, disa nga veprat e tij të botuara në “Macmua-i Ulum” janë ribotuar, kurse disa kanë mbetur dorëshkrim. Ne kemi të dhëna për këto vepra:

Psikoloji jahut Ilm-i Ruh (Psikologjia), Artin Asandoryan Sirket-i Mürettebiyye Matbaasi, Stamboll, 1310; *Esas-i Ibn-i Hey’et* (Kosmografia), Matbaa-i Safa Vanur, Der Saadet 1311; *Tarih-i Tekvin jahut Hilkat* (Historia e krijimit të botës), Artin Asandoryan Sirket-i Mürettebiyye Matbaasi, Stamboll, 1910; *Esrar-i Ab-i Hava* (Sekretet e ujit dhe të ajrit), Kasbar Matbaasi,

Stamboll, 1309. Përveç këtyre, përktheu nga frëngjishtja veprën *Loi Natyrelle* nga Volney-i, pastaj bashkë me Mahmud Nedimin “Udhëtimet e Guliverit” (Küliverin Siyahati) dhe veprën *Mürebbi-i Etfal* (Edukuesi i fëmijëve), por për këto dy veprat e fundit nuk kemi të dhëna më precize. Vdiq nga tuberkulozi më 4 korrik 1881 në Erenköy afër Stambollit dhe aty u varros.

Vildan Faik Dibra ishte profesor i Medresesë në Üsküdar kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Na mungojnë të dhënat biografike. Dihet se pas revolucionit xhonturk ishte anëtar aktiv i klubit “Bashkimi” të Stambollit dhe si përfaqësues i tij mori pjesë në Kongresin e alfabetit në Manastir më 1908. Shumë pjesëtarë të Kongresit me njëfarë frike prisnin se çfarë qëndrimi do të merrte Vildan Efendiu – a do të ishte ithtar i alfabetit arab, apo latin. Mirëpo ai mbajti një fjalim patriotik, duke theksuar se feja dhe Kur’ani nuk kanë kurrfarë lidhje me alfabetin. Botoi disa vepra nga e drejta e Sheriatit. Ne kemi pasur në dorë veprat: *al-Kavlath-thabit fi kadâ’ al-favait* (Fjalë e qëndrueshme mbi zbatimin e detyrave që kanë kaluar) dhe *al-Mava’iza al-hisan* (Predikime të dobishme).

Sami Frashëri. – Përveç fjalorëve dhe enciklopedisë historike e gjeografike, disa antologjive dhe disa veprave islamologjike e arabistike, Samiu hartoi edhe disa vepra thjesht linguistike dhe dialektologjike, që kanë karakter serioz shkencor. Po kështu ai hartoi edhe nja dhjetë vepra në të cilat popullarizohen shkencat moderne evropiane. Por, duke qenë se për këto vepra kemi folur më gjatë në një punim të posaçëm kushtuar punës së Samiut në letërsinë dhe filologjinë turke¹², këtu nuk do të ndalemi në këto vepra.

¹² Hasan Kaleshi, Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke, Gjurmime albanologjike, 1/1968, fq.33-116.

Mehdi Frashëri. - Deri më sot mbeti i panjohur fakti se Mehdi Frashëri, kur ishte mytesarif (sanxhakbej) në Vilajetin e Samsunit në Anadoll, botoi një vepër juridike me titull "Imtiyazat-i ecnebiyenin Tatbikat-i haziresi" (Zbatimi i tanishëm i kapitullacioneve të huaja). Vepra ka 380 faqe. Në këtë vepër autori trajton çështjen e kapitullacioneve të shtetit osman nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, analizon keqpërdorimet e ndryshme, krahason gjendjen e Perandorisë Osmane me gjendjen e shteteve të tjera, bën një analizë të hollësishme dhe jep propozime se si duhet zgjidhur çështja që e kishte shpënë Turqinë në një gjendje koloniale. Argumentimi bazohet në një aparat të madh shkencor, duke përfshirë edhe shumë burime evropiane, kështu që mund të thuhet se për nga metoda dhe për nga trajtimi, kjo është një vepër me të vërtetë shkencore dhe një nga më të mirat nga kjo gjini.

Shkencat medicinale. - Fakultetet e mjekësisë hapen në Turqi nga mesi i shekullit të kaluar. Me kohë krijohet një kuadër i cili fillon të merret edhe me gjurmime shkencore, aq më parë se shumica e mjekëve të shquar janë specializuar në Evropë. Edhe midis tyre kemi disa shqiptarë.

Besim Omer pasha (Akalin) lindi më 1861. Ishte i biri i Omer Shefqet pashës nga Narta e Shqipërisë së jugut. Qe deputet në parlamentin e parë, të cilin e hapi sulltan Hamiti më 1876. Besimi e kreu Ruzhdijen në Shkup, pastaj Ruzhdijen ushtarake në Gylhane, në Stamboll, idadijen mjekësore në Stamboll dhe më 1883 Akademinë e Lartë Ushtarake të Medicinës në Stamboll. Pasi punoi një kohë si profesor, më 1885 u dërgua në Paris në specializim, ku mbeti deri më 1889. Pas kthimit u emërua profesor i Akademisë së Lartë të Medicinës. Me mish e

me shpirt iu kushtua profesionit të vet. Nuk u martua kurrë. Qysh i ri fitoi një famë të madhe si ekspert dhe pedagog dhe njëkohësisht edhe grada të larta ushtarake, saqë u bë edhe ferik (komandant divizioni). Ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Shëndetësisë, kryetar i këtij këshilli, dekan i Fakultetit të Mjekësisë. Pas shpalljes së Republikës ishte dhe rektor i Universitetit të Stambollit. Është themelues i Gjysmëhënës turke. Mori pjesë në një varg kongresesh ndërkombëtare. Ka merita shumë të mëdha sidomos për organizimin e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve dhe për higjienën preventive. Mu në këtë drejtim botoi afër 5 vepra nga mjekësia-disa shkencore, disa popullarizuese të medicinës, me qëllim arsimimi shëndetësor. Themeloi edhe disa revista mjekësie dhe qe redaktor i katër salnameve (kalendarëve vjetorë) të shëndetësisë.

Ibrahim Lutfi pasha ishte mjek dhe profesor fakulteti plot 30 vjet. Ishte nga katundi Berzishë i Elbasanit. Qe specializuar në fizikë dhe gjeologji. Vdiq më 1903. Edhe pse ishte profesor i Fakultetit të Mjekësisë, më tepër e interesonte gjeologjia dhe nga ky lëm botoi dy vepra (Ilm-i arz). Të dhëna të tjera për të nuk kemi.

Kohëve të fundit në lëmin e mjekësisë u dalluan edhe një varg shqiptarësh të tjerë. Do të përmendim vetëm disa. *Prof. dr. Ekrem Behxhet Tezel*, ishte nga Mitrovica. Ishte profesor universiteti deri kah viti 1940 dhe një kohë edhe kryetar i Shoqatës së Mjekëve të Turqisë. Botoi mjaft punime nëpër revistat e ndryshme. *Ahmet Rasim Onat* ishte nga Janina. Ishte specialist i sëmundjeve të brendshme. Botoi një varg punimesh në revistat e ndryshme dhe përkroi një varg sëmundjesh. *Dr. Sadullah Nutku* nga Preveza. Ishte specialist i sëmundjeve të brendshme. E përktheu një vepër nga gjermanishtja dhe është autor i një vepre tjetër të botuar më 1938 e të tjera.

V. GRAMATOLOGJIA DHE LEKSIKOGRAFIA

Për shkak të studimit të arabishtes dhe të persishtes, gramatologjia dhe leksikografia turke, ose më mirë të themi hartimi i gramatikave arabe dhe i fjalorëve dygjuhësorë arabisht – turqisht dhe persisht-turqisht, kanë një traditë të gjatë. Hartimi i gramatikave turke dhe zhvillimi i leksikografisë moderne sipas modelit të fjalorëve njëgjuhësorë apo dygjuhësorë evropianë, ndërkaq, fillon vonë, krahas evropianizimit të shoqërisë, kulturës dhe të letërsisë turke, me fillimin e përhapjes së ideve demokratike dhe të ndjenjave kombëtare dhe, së bashku me këtë, edhe të ideve për nevojën e thjeshtëzimit të gjuhës osmane-turke dhe afrimit të saj masave popullore. Dihet mirë se deri me hapjen e shkollave të reformuara, nga mesi i shekullit XIX, rëndësi kryesore i kushtohej arabishtes dhe kjo studiohet nga gramatikat e hartuara sipas metodave skolastike. Lirisht mund të themi se shqiptarët edhe në këtë lëmë kanë dhënë një kontribut mjaft të madh. Madje, ata përpiqen të hartojnë gramatika dhe fjalorë modernë, sipas metodës evropiane. Arsyeja që disa shqiptarë si Samiu, Naimi, Abidin pasha Dino iu përveshën punës që të hartojnë gramatika “sipas metodës së re”, duhet kërkuar në faktin se ata i kishin studiuar qysh në rini gjuhët klasike evropiane, e njëkohësisht, duke studiuar arabishten, persishten, turqishten, kishin mundur të konstatojnë se sa të komplikuar ishin këto gramatika për nga metoda e hartimit të tyre. Prandaj marrin e shkruajnë gramatika të arabishtes, persishtes apo të turqishtes, ku përpiqen ta nxjerrin jashtë mënyrën e vjetër skolastike dhe ta fusin metodën evropiane.

Sami Frashëri hartoi këto gramatika:

- 1) *Küçük elifba* (Abetare e vogël),
- 2) *Tasrîfat-i ‘arabiyye* (Konjugacioni i arabishtes),
- 3) *Yeni usûl Elifba-yi türkî* (Abetare turke sipas metodës së re),
- 4) *Yeni usûl sarf-i türki* (Morfologjia turke sipas metodës së re),
- 5) *Kavaid-i nahviyye-i arabiyye* (Rregullat e morfologjisë arabe).
- 6) *Kavaid-i sarfiyye-i arabiyye* (Rregullat e sintaksës arabe).

Duke qenë se mbi këto vepra të Samiut kemi folur më gjatë në një vend tjetër¹³, këtu do të theksojmë vetëm dy çështje:

a) Samiu e lë ndarjen klasike të fjalëve në tri kategori: isim (emër), fi'l (folje), zarf (pjesë të pandryshueshme) dhe fillon të bëjë ndarjen sipas gramatikave evropiane;

b) Ai është i pari që e quan *gramatikë turke* dhe heq dorë nga termi gramatikë osmane, siç e përdornin paraardhësit e tij, gjë që është shumë me rëndësi.

Abidin pasha Dino Preveza, për të cilin folëm më gjatë në kapitullin mbi shkencëtarët, e shkroi një gramatikë të arabishtes me titull *Ber tarz-i nevin nahv-i ‘arabi* (Gramatika e arabishtes sipas mënyrës së re), botuar në Rodos më 1895. Dihet mirë se edhe ai kishte studiuar në gjimnazin e Janinës dhe se e zotëronte në mënyrë të përsosur greqishten e vjetër, greqishten e re dhe frëngjishten. Me siguri, edhe ai duhet t’i ketë pasur si model gramatikat evropiane për studimin e arabishtes.

¹³ Krahaso shënimin 12.

Naim Frashëri, që ishte me të vërtetë njohës i mirë i persishtes, e shkroi edhe një përmbledhje vjershash persisht, hartoi një gramatikë të persishtes për turqit me titull *Kavaidi fârisiyye ber tarz-i nevin* (Rregullat e persishtes sipas metodës së re), të cilën e botoi në Stamboll më 1871. Në parathënie Naimi shkruan: “Gramatika është kyç i çdo gjuhe dhe faktori kryesor i të mësuarit të gjuhës me lehtësi. Duke e ditur rëndësinë e gjuhës persiane, e duke qenë se nuk ekziston një gramatikë sipas metodës së re, e mora iniciativën që ta shkruaj.”¹⁴

Refi Janina, për të cilin folëm në kapitullin mbi disiplinat shkencore, e shkroi gjithashtu një gramatikë të arabishtes, por na mungojnë të dhëna bibliografike mbi të.

Abdylhaqim Hiqmet Dogani është autor i librave të shumtë shkollorë dhe pedagog. Lindi më 1880 në Gostivar. Studioi në Stamboll, ku u njoh me shumë patriotë shqiptarë dhe me veprat e shumë shqiptarëve të Stambollit. Më 1911, afër gjashtë muaj, e jepte shqipen në Shkollën Normale (Darul-mu'allimîn) të Shkupit. Një kohë ishte deputet në parlament, gjë që shihet nga nënshkrimet e tij: “Sabik Gostivar meb'usu mu'al-lim Abdulkhakim Hikmet” (Ish-deputet i Gostivarit, mësues Abdylhakim Hikmeti).

Abdylhakim Hiqmeti qe autor i shumë librave shkollorë në gjuhën turke. Ne kemi të dhëna të sigurta bibliografike për 16 libra shkollorë, të cilët vetëm do t'i numërojmë me këtë rast:

- 1) *Sabah Yildizi yahot Musavver Osmanli Elifbasi* (Ylli i mëngjesit apo Abetare e ilustruar e osmanishtes),
- 2) *Yeni Elifba – Nesh harflariyla tab'edilmis yeni imla ilifbasi* (Abetare e re – Abetare ortografike e botuar me shkronjat tona),

¹⁴ Më tepër krahaso shënimin 11.

- 3) *Muslumanlik* (Feja islame),
- 4) *Arnavutça elifba – Arap harflariyla* (Abetare shqip – me alfabetin arab),
- 5) *Pedagoji kavaidine mutabik yeni sistem ilm-i hal-Birinci Kisim* (Sistemi i ri i mësimi fetar sipas parimeve pedagogjike – pjesa e parë),
- 6) *Pedagoji kavaidine mutabik yeni sistem elifba* (Sistemi i ri i abetares sipas parimeve pedagogjike),
- 7) *Kur'an-i Kerim Derslaerine Baslangiç* (Hyrje në mësimet e Kur'anit të nderuar),
- 8) *Birinci Kisim Turkçe Dersleri – Elifba* (Pjesa e parë e mësimave të turqishtes – Abetare),
- 9) *Ikinci Kisim Turkçe Dersleri* (Pjesa e dytë e mësimave të turqishtes),
- 10) *Uçuncu Kisim Turkçe Dersleri* (Pjesa e tretë e mësimave të turqishtes),
- 11) *Dorduncu Kisim Turkçe Dersleri* (Pjesa e katërt e mësimave të turqishtes),
- 12) *Birinci Kisim Din Dersleri* (Pjesa e parë e mësimave të fesë),
- 13) *Ikinci Kisim Din Dersleri* (Pjesa e dytë e mësimave të fesë),
- 14) *Uçuncu Kisim Din Dersleri* (Pjesa e tretë e mësimave të fesë),
- 15) *Dorducu Kisim Din Dersleri* (Pjesa e katërt e mësimave të fesë),
- 16) *Birinci Kisim Tarih Dersleri* (Pjesa e parë e mësimi të historisë).

Në një burim përmendet gjithashtu që Hikmeti kishte shkruar një broshurë me titull “Cili alfabet është më i mirë për gjuhën turke”, në të cilën ishte përpjekur për alfabetin latin. Gjithashtu, ai e shkroi edhe një abetare shqip me 1945, të cilën në të njëjtin vit e botoi *Fronti Popullor*.

Përsa u përket veprave leksikografike, edhe këtu vendin e parë e zë Sami Frashëri, por jo vetëm midis shqiptarëve, por në tërë leksikografinë turke. Veprat leksikografike të Samiut janë:

1) *Kâmûs-i fransevi, Fransizoadan Turkçeye Lugat (Dictionnaire français-turc)*, nga i cili kanë dalë katër edicione, në 1.680 faqe, me afër 50.000 fjalë:

2) *Kamûs-i fransevi. Turkçeden fransizcaya Lugat (Dictionnaire turc-français)*, nga i cili janë botuar tri edicione, 1.208 faqe.

3) *Kâmûs-i Turkî* (Fjalor i gjuhës turke, d.m.th. turqisht-turqisht), fjalor i cili përfaqëson një datë me rëndësi në leksikografinë turke. Fjalori ka 1.575 faqe dhe është fjalori më i mirë i gjuhës osmano-turke, deri më sot i pakaluar dhe shërben si bazë e të gjithë fjalorëve të mëvonshëm.

4) *Kâmûs-î arabî* (Fjalor arabisht-turqisht), të cilin Samiu nuk e kreu, sepse, pasi që botoi disa pjesë, botues *Mihrani* nuk donte ta vazhdonte botimin deri në fund. Fjalori është hartuar sipas modelit të fjalorëve dygjuhësorë evropianë të arabishtes dhe ajo pjesë që është botuar provon që, sikur ta kishte kryer, ky do t'ishite fjalori më i mirë arabisht-turqisht.

Kemi edhe një varg fjalorësh, si për shembull atë të Kelekianit dhe të Develiolglut, të cilët nuk janë gjë tjetër veçse kopje të fjalorëve të Samiut, por, duke qenë se mbi të gjitha këto probleme kemi folur në një vend tjetër¹⁵, ne këtu nuk do të ndalemi.

Ref'i Janina, të cilin tashmë e kemi përmendur, e shkroi një fjalor turqisht-greqisht. Të dhëna të tjera mbi këtë fjalor nuk kemi.

Haxhi Ali Haqî babai, për të cilin folëm më gjatë në kapitullini mbi poezinë e teqeve, e shkroi një fjalor terminologjik të

¹⁵ Krh.shënimin 12.

mistikës islame (tasavvuf) me titull “Istilâhat-i sufiye”, i cili mbeti dorëshkrim në teqenë e Gjirokastrës.

Dr.Riza Teufiku nga Dibra e botoi vetëm vëllimin e parë të fjalorit filozofik me 1.200 faqe.

Me dashje e kemi lënë në fund veprën monumentale të Sami Frashërit Kamûsu l-a’lâm (Fjalor i emrave të përveçëm), ose më mirë të themi “Enciklopedi historike e gjeografike”, në 6 vëllime, vepër në të cilën Samiu punoi plot 12 vjet dhe e cila ka 4.830 faqe. Në këtë vepër futi shumë shqiptarë dhe shumë vende shqiptare. Si e tillë që është, kjo vepër ka rëndësi të madhe për historinë dhe gjeografinë historike shqiptare. Edhe mbi këtë vepër kemi folur në punimin tonë të lartpërmendur.

VI. PUBLICISTIKA

Shumë ide të reja dhe zbulime të mëdha evropiane, të cilat shpesh shënuan kthesë në zhvillimin e qytetërimit evropian dhe në mendimin shkencor e filozofik, depërtuan me shumë vështirësi në Perandorinë Osmane. Kështu, shpikja e Gutenbergut – të shtypurit e librave – depërtoi në Turqi plot 289 vjet pas fillimit të botimit të librave në Evropë. Libri i parë është botuar në Turqi më 1729. Duhej të kalonin edhe afër njëqind vjet derisa doli gazeta e parë, dhe kjo qe në gjuhën frënge, “Moniteur ottoman”, e cila filloi të botohet në Izmir më 1831. Thuajse në të njëjtin vit doli gazeta zyrtare “Takvim-i vekai” (Kalendar i ngjarjeve), kurse dhjetë vjet më vonë filloi të dalë gazeta e përjavshme “Geride-i Havadis” (Gazeta e lajmeve). Mirëpo, si fillim i vërtetë i gazetarisë turke merret dalja e gazetave “Tercûman-i ahval” (Interpretues i ngjarjeve) dhe “Tasvir-i efkar” (Përshkrim i mendimeve), që filluan të dalin më 1860 dhe më 1862. Pas kësaj fillon një zhvillim i shpejtë i gazetarisë, kështu që midis viteve 70 dhe 80 vetëm në Stamboll botohen afër 15 gazeta. Në vitet që pasojnë, me gjithë censurën e Sulltanit, numri i gazetave e i revistave gjithnjë shtohet e lulëzon dhe shtypi ka merita të mëdha në evropianizimin e opinionit publik turk e në përhapjen e ideve përparimtare midis intelektualëve turq. Në zhvillimin e gazetarisë turke një kontribut jo të vogël kanë dhënë edhe shqiptarët. Ne këtu do t’i përmendim më të rëndësishmit, do të kufizohemi me dhënien e biografisë së tyre të shkurtër, sepse për disa - për shembull për Dervish Himën e dr.Ibrahim Temon - kemi shkruar punime të gjera.

Ismail Qemal Vlora. Nga memoaret e Ismail Qemalit dhe nga shumë burime të tjera e dimë se në fillim të vitit 1866, me ftesën e Mid'hat pashës, valiut të Vilajetit të Tunës, Ismail Qemali shkoi në Rushçuk (Ruse) të Bullgarisë, qendër vilajeti, me detyrë shëf i seksionit të korrespondencës në kuadër të vilajetit. Atëherë filloi të botohet gazeta e përjavshme “Tuna”, si organ i vilajetit. Kryeredaktor i gazetës ishte Ismail Qemali. Duke qenë se nuk e kam pasur në dorë këtë gazetë, nuk mund të jap kurrfarë mendimi mbi fizionominë e saj, mbi rolin e Ismail Qemalit në të, mbi artikujt e Ismail Qemalit të cilët me siguri i shkroi në këtë gazetë. Me siguri, sipas zakonisht të atëhershëm në shtypin turk, shumicën e kryeartikujve duhet t'i ketë shkruar I.Qemali. Në fund të vitit 1867 doli numri i parë i revistës dygjuhësore, turqisht e bullgarisht, me titull *Mecray-i efkâr* (Istocnik mnenia). Deri tash janë gjetur dy numra të kësaj reviste – numri i parë është botuar në dhjetor 1867 dhe i dyti në janar 1868. Ismail Qemali nuk është vetëm kryeredaktor, por edhe autor i të gjithë artikujve të botuar. Numri i parë ka 25 faqe turqisht dhe 25 faqe bullgarisht, kurse numri i dytë 48 faqe turqisht dhe 48 faqe bullgarisht. Të njëjtët artikuj janë botuar edhe turqisht edhe bullgarisht. Në numrin e parë janë botuar këta artikuj:

Pasqyra e shkurtër e istorisë turke,

Kosmografia,

Karakteret e njerëzve,

Disa të dhëna mbi puset arteziane,

Përshkrimi i lumit të Tunës.

Numri i dytë përmban këta artikuj:

Pasqyra e shkurtër e historisë turke – vazhdim,

Kosmografia – vazhdim,

Karakteret e njerëzve – vazhdim.

Bisedimi midis Kuzu e Ku – biseda të urta para 2.285 vjetësh midis Ku, të birit të mbretit Lo dhe Kuzu, nxënësit të Konfuçit, sipas Volterit; duket se I. Qemali e ka përkthyer nga frëngjishtja.

Të dy numrat ndodhen në Bibliotekën Kombëtare të Sofjes dhe në “Mil-let kûtûbhanesi” në Ankara. Sado që jemi përpjekur të gjejmë disa numra të tjerë të kësaj reviste, nuk patëm sukses. Duket se nuk janë botuar numra të tjerë, sepse nuk ka-
loi shumë kohë pas botimit të numrit të dytë dhe I. Qemali u largua nga Rushçuku.

Duket që në Rushçuk, në shtypshkronjën e vilajetit, është botuar edhe *Tuna Vilayeti Salnamesi* (Almanak i Vilajetit Danubian), redaktori i të cilit ka qenë gjithashtu Ismail Qemali.

Pasi që Ismail Qemali më 1 maj 1900 iku nga Stambolli në Athinë dhe nga Athina nëpër Napoli arriti në Bruksel, më 1901 ai filloi të botojë një gazetë në tri gjuhë: turqisht, shqip dhe greqisht (sipas disa burimeve-turqisht, frëngjisht dhe greqisht). Gazeta mbante titullin frëngjisht *Le Salut d’Albanie*, kurse turqisht *Selamet*. Teksti shqip radhitej në Bruksel, ku është botuar edhe “Albania” e Faik Konicës, teksti greqisht në Athinë, kurse teksti turqisht me karakterin arab në Falkestone në Angli. Sado që kjo gazetë përmendet në disa burime, e në një burim turk theksohet se ajo luftonte për autonominë shqiptare, kurrkush deri më sot nuk na ka dhënë një përshkrim të saj. Edhe unë nuk kam mundur ta gjej.

Sipas memoareve të I. Qemalit, pas vitit 1892 ai e themeloi në Stamboll revistën *Mecra-yi Efkar*, pra me të njëjtin titull si ajo e Rushçukut. Në këtë revistë I. Qemali trajtonte problemet e reformave. Por, pas numrit të parë Sulltani e ndaloi botimin e saj.

Sami Frashëri zë vend shumë të dalluar në gazetarinë dhe në publicistikën turke. Me të ardhur në Stamboll, ai hyri në botën e gazetarisë dhe qysh në vitin 1872 filloi të bashkëpunojë me gazeta të ndryshme. Ndërkaq, punën më të madhe Samiu e kishte bërë si redaktor i këtyre gazetave dhe revistave:

1) *Tarabulus* (Tripolis, 1874), gazetë e përjavshme arabisht dhe turqisht, organ i Vilajetit të Libisë.

2) *Sabah*, gazetë e përditshme, kryeredaktor i së cilës ishte Samiu që nga numri i parë (9.III. 1876) e deri në numrin 256 (5 janar 1877);

3) *Tercûman-i Sark*-gazetë e përditshme, kryeredaktor i së cilës që nga numri 74 ishte Samiu (10 prill 1878);

4) *Aile* – revistë e përjavshme kushtuar grave. Të gjithë artikujt i kushtohen gruas dhe punëve shtëpiake dhe rritjes së fëmijve. Unë i gjeta vetëm tre numra. Të gjithë artikujt i shkroi vetë Samiu.

5) *Hafta* – revistë të cilën e themeloi Samiu më 1881. Të gjitha shkrimet janë nga dora e Samiut. U botuan vetëm 20 numra¹⁶ të kësaj reviste.

Përveç kësaj, Samiu bashkëpunoi me gazetatat dhe revistat e ndryshme të Stambollit, duke trajtuar çështje të ndryshme, kryesisht çështje gjuhësore dhe letrare.

Jusuf Ali Albani është një figurë tejet interesante nga koha e Rilindjes Kombëtare. Lindi në katundin Premkë të Kërçovës. Gjatë luftës ruso-turke më 1877, si i besuar i Ruisë, udhëtoi nëpër vendet shqiptare me qëllim që të çonte në kryengritje kundër Turqisë¹⁷. Në atë kohë ai shkruan edhe një vjershë të

¹⁶ Më tepër krahaso Hasan Kaleshi, Burimet lidhur me studimin e Sami Frashërit, "Buletini i Fakultetit Filozofik të Prishtinës", VIII/71, fq.35-40.

¹⁷ J.G.Senkeviç, Albanija v period Vostocnogo krizisa, Moskë, 1965, fq.111-120.

gjatë turqisht kundër Sulltanit dhe përpiqet për një federatë ballkanike, nën protektoratin rus. Në shtypshkronjën ushtarake të Edrenes, e cila në atë kohë ishte nën okupacionin rus, A. Jusuf Albani boton një broshurë në të cilën flet mbi historinë e popullit shqiptar, për kërkesat e tij, por mjerisht nuk kemi mundur ta gjejmë. Është interesant se ai është ndoshta i pari publicist i cili në shkrimet e veta nuk përdor termat turke *Arnavutluk*, por *Albanya* dhe *Albanyalilar*. Prandaj edhe vetë në shumë vende nënshkruhet Jusuf Ali Albani.

Me 1883 atë e gjejmë si drejtor dhe kryeredaktor të gazetës së përjavshme politike dhe letrare *Dikkat* (Vëmendja). Gazeta botohej turqisht dhe bullgarisht. Sipas të gjitha gjasave, gazeta finançohej nga qeveria bullgare. Kemi të dhëna se doli nga 7 prill deri më 12 maj 1883.

Në vitin 1892-3 Jusuf Ali beu fillon të botojë në Sofje gazetën e përjavshme *Tarla* (Ara), e cila botohej në katër faqe-tri faqe turqisht dhe një faqe bullgarisht. Gazeta përpiqej për një sjellje lojale të turqve të Bullgarisë ndaj pushtetit të ri bullgar dhe kundër politikës antibullgare turke. "*Tarla*" është gazeta e parë turqisht në përgjithësi e cila mban një emër bujqësor dhe trajton edhe probleme agrare. Nuk dimë sa kohë doli kjo gazetë.

Në vitet 1894-1895 Jusuf Ali beu filloi të botonte gazetën *Ittifak* (Bashkim). Programi i gazetës ishte: 1) Të njihte popullsinë turke në Bullgari me masat ligjore të qeverisë bullgare; 2) Të popullarizonte masat shëndetësore; 3) Të përgatiste popujt e Ballkanit për një konfederatë ballkanike nën protektoratin e Sulltanit.

Nuk dimë se a ka dalë kjo gazetë vazhdimisht, sepse në vitet 1898-99 e gjejmë përsëri këtë si gazetë të përjavshme. Në një gazetë tjetër bullgare gjejmë një lajm ku thuhet se redaktori Jusuf Ali beu kishte shkuar në Stamboll dhe se atje ishte burgosur me urdhër të Sulltanit, sepse gazeta përkrahte tendencat

xhonturke. Në një burim tjetër bullgar thuhet se Jusuf Ali beu kishte kaluar në Turqi dhe se kishte hyrë në shërbim të Sulltanit. Ka gjasë se ky lajm do të jetë i vërtetë, sepse Jusuf Ali beu, sipas të dhënave të pasardhësve të tij, e kishte marrë titullin e pashës dhe kishte vdekur në Stamboll, duke lënë pas vetes pasuri të madhe.

Dr. Ibrahim Temo ishte gjithashtu publicist i shquar. Drejtoi disa gazeta turqisht, shkroi artikuj frëngjisht, turqisht, romanisht dhe shqip me alfabet arab. Duke qenë se së shpejti do të dalë nga shtypi një punim i gjatë i yni kushtuar dr.Ibrahim Temos, ku flitet gjerësisht edhe mbi aktivitetin e tij publicistik, ne me këtë rast nuk do të ndalemi më gjatë.

Dervish Hima. – Shembulli i Dervish Himës, njërit nga luftëtarët më revolucionarë dhe flamurtarët më të flaktë të autonomisë shqiptare, njërit prej intelektualëve më të shquar, publicistëve më të dalluar nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX – provon më së miri se sa njerëz të spikatur të historisë shqiptare kanë mbetur në harresë. Kur them *njerëz të spikatur*, mendoj njëkohësisht edhe për Haxhi Zekën, Nexhip Dragën, Dr. Ibrahim Temon e të tjerë, me origjinë nga Kosova e Maqedonia, për të cilët nuk kemi asnjë artikull të botuar¹⁸. E, ta krahasosh Dervish Himën me shumë vetë të cilët kanë zënë vend me rëndësi nëpër publikacionet tona të ndryshme, është

¹⁸ Duke mos pasur qëllim që t'i bëj vetes reklamë, do të përmend se artikujt e parë për këto personalitete të shquara i kam shkruar unë; disa janë botuar e disa do të botohen gjermanisht në Biographische Lexicon zur Geschichte Sudosteuropas (Leksikon biografik për historinë e Evropës Juglindore), që botohet në Gjermani. Deri tash janë botuar dy vëllime, ndërsa edhe dy përgatiten për shtyp. Për këtë enciklopedi i kam shkruar afër 30 artikuj nga historia dhe letërsia shqipe dhe turke.

sikur ta krahasosh Guliverin me Liliputanët. Vetë fakti se D. Hima kishte botuar afër njëzet broshura kundër Sulltanit dhe për zgjimin e popullit shqiptar dhe të drejtat e tij, se e kishte kryesuar Kongresin e dytë të Manastirit, se kishte themeluar dhe drejtuar një varg gazetash dhe revistash shqip, frëngjisht e turqisht, se kishte marrë pjesë në një varg kongresesh shqiptare dhe gjithmonë ishte në udhëheqje, se Ballkanikusi (Dr. Stojan Protiq) e shkroi librin e vet “Albanski problem i Srbija i Austrongarska” (Beograd 1913) duke polemizuar me Dervish Himën, se shkroi një varg artikujsh në shtypin evropian dhe bullgar, se tërë jetën dhe pasurinë i shkriu për kauzën shqiptare – provojnë më së miri se D. Hima meriton jo vetëm një artikull, por edhe një monografi. Me këtë rast, duke qenë se D. Hima na intereson vetëm për nga veprat e veta publicistike të shkruara në gjuhën turke, ambiciet tona janë që vetëm të japim një biografi të shkurtër të tij dhe të numërojmë shumicën e veprave të tij turqisht, si dhe të themi ndonjë fjalë për to, nëse kemi të dhëna. Ndërkaq, e kemi ndër mend që këtij vigani t’i kushtojmë një punim më të gjerë, për të cilën kemi mbledhur mjaft material në Stamboll, në Ankara dhe në Arkivin e Vjenës.

Dervish Hima, emri i vërtetë i të cilit është Ibrahim Mehmet Naxhi, lindi në Ohër më 1873 (sipas disa burimeve, më 1875), si djalë i një pronari tokash. Prandaj, në disa burime e gjejmë si Ibrahim Naxhi Spahiu. Shkollën fillore e kreu në Ohër, ruzhdijen në Manastir, kurse idadijen në Selanik. Pastaj e kreu liceun ushtarak në Stamboll dhe i filloi studimet në Akademinë e Lartë Ushtarake të Medicinës. Këtu i vazhdoi studimet dy vjet, bashkë me bashkëvendasin dhe mikun e tij dr. Ibrahim Temo. Qysh këtu angazhohet në lëvizjen xhonturke. Në vitin 1895, si 22-vjeçar, ra në burg, por me ndihmën e Dr.Temos iku nga Stambolli dhe kaloi në Shqipëri për të bërë

agjitacion kombëtar. Gjatë dy viteve, sa zgjati ky qëndrim në Shqipëri, vizitoi gati të gjitha qytetet, bënte agjitacion, hapte shkolla të vogla, shpërndante broshura dhe gazeta shqip. Qendrat kryesore i kishte të Dervish bej Elbasanit dhe Murat bej Toptanit. Por, edhe këtu vazhdimisht e ndiqte policia turke. Në gusht të vitit 1897 u detyrua të ikte në Bukuresht, ku tashmë kishte kaluar Dr.Temo. Atje i vazhdoi studimet e mjekësisë, por nuk i kreu kurrë. Këtu u bashkua me grupin e Naços, në të cilin merrnin pjesë edhe Dr. I.Temo, Jani Mehal Lehova, Kristo Luarasi, Jashar Erebara dhe të tjerë. Ky grup bashkëpunonte me xhonturqit e ikur nga Turqia në Rumani. Në kongresin e kolonisë shqiptare të Bukureshtit, të mbajtur më 13 nëntor 1898, të kryesuar nga Faik Konica, D. Hima ishte ndër pjesëmarrësit më aktiv. Ai ishte njëkohësisht edhe kryetar i qarkut të studentëve shqiptarë të Bukureshtit. Mu për këto arsye qeveria turke as këtu s'e la të qetë. Pas protestave të shumta turke pranë qeverisë rumune, Hima u detyrua të largohej nga Rumunia dhe të shkonte në Romë, ku ra në kontakt me profesorin e Tubingenit Kurt Hasset dhe profesorin e Bolonjës Antonio Baldaçi (Baldacci). Bashkë me Mehmet bej Frashërin, Hima nxori në Romë gazetën e re “Zëri i Shqipërisë” (L'écho d'Albanie). Në numrin e parë të kësaj gazete Hima i paraqet kërkesat e shqiptarëve për autonomi. Meqenëse ambasadori turk në Romë ia mbushi mendjen Mehmet bej Frashërit që të kthehet në Stamboll, Dervish Hima, i cili refuzoi të kthehej në Turqi, e vazhdoi vetë botimin e gazetës, por me titull të ri, “Albania”. Por, pas një kohe të shkurtër, edhe qeveria italiane ia revokoi mikpritjen. Ai u kthye përsëri në Bukuresht. Në Romë botoi në mënyrë litografike veprën “Uyanalim” (Të zgjohemi), një nga veprat më revolucionare të lëvizjes shqiptare, për të cilën një kohë të gjatë mendohej se e kishte shkruar Samiu, deri sa unë e korr-

igjova këtë gabim. Në Bukuresht, bashkë me disa shokë, e filloi agjitacionin për mbajtjen e një kongresi shqiptar, por ai u ndalua në çastin e fundit për shkak të demarshit të qeverisë turke.

Në fillim të vitit 1900, bashkë me Ismail Qemalin, Hima udhëtoi në Egjipt, për të bërë agjitacion për themelimin e një shoqërie shqiptare. Në fillim të vitit 1901, në të kthyer nga Egjipti, Hima mori pjesë në një kongres shqiptar në Napoli. Prej këtu përsëri kaloi në Romë, ku në prill të vitit 1901 e ringjalli organin e vet “Albania”. Këtu shkroi me dorë dhe botoi në mënyrë litografike, pa vënë emrin e vet si autor, nja dhjetë broshura, 10-30 faqesh, të gjitha të drejtuara kundër absolutizmit të Sulltanit në një anë, dhe kah zgjimi i vetëdijes kombëtare, në anën tjetër. Titujt e këtyre broshurave flasin qartë mbi përmbajtjen e tyre: “Mjeti i shpëtimit (të shqiptarëve – H.K.) është besabesë”, “Sulltan Hamiti dhe mënyra e vrasjes së Sheh Hamdiut”, “Efendiu – Sulltani – dhe unë”, “Shqiptarëve muslimanë një apel ligjor”, “Varri i njerëzve liridashës”, “Një pasqyrë e krimeve të sulltanit”. Në këtë të fundit, të botuar me 3 mars 1901 në Romë, Dervish Hima thekson se qëllimi i kësaj vepre ishte t’i informonte për krimet e Sulltanit jo vetëm lexuesit, por sidomos ata të cilët e rrethojnë Sulltanin, shumica e të cilëve janë shqiptarë. Në fund të broshurës gjejmë një apel drejtuar “vëllezërve për nga atdheu”, ku thuhet se do t’ua dërgonte falas broshurat e lartpërmendura nëse ia dërgojnë adresat. Ai njëkohësisht shton se do të dalin edhe afër dhjetë broshura të reja, titujt e të cilave janë: “Haremi i sulltanit dhe shqiptarët”, “Vrasësi i vërtetë i shqiptarit Gani beu dhe mjetet e vrasjes”, “Sulltan Hamiti dhe vrasja e përgjithshme e ermenëve”, “Një krahasim midis sulltan Hamitit dhe katilave të famshëm të shekujve të kaluar” etj. Nuk e dimë se a i ka botuar Dervish Hima të gjitha këto broshura apo jo, sepse vetëm disa i kemi pasur në dorë,

por pa marrë parasysh këtë, titujt e tyre provojnë ashpërsinë e luftës që bënte Hima. Mu për këtë është e çuditshme si është injoruar Hima edhe në historinë shqiptare, edhe në historinë turke, i cili i kushton mjaft vëmendje luftës kundër sulltan Hamitit. Për shkak të artikujve dhe broshurave antiturke, me intervenimin e ambasadës turke Hima u shtrëngua në maj të vitit 1902 të largohej nga Italia dhe të kalonte në Paris. Në shtator të vitit 1902, bashkë me kapitenin Dimitri Papazoglu, vllah nga Manastiri, themeloi një komitet shqiptar. Nga këtu ai përsëri vjen në Bukuresht dhe merr pjesë në një kongres më 1902, që u mbajt në kryesinë e Princ Albert Gjikës. Edhe këtu Hima mban një fjalim të ashpër antiturk dhe kërkon haptas autonominë shqiptare. Në pranverë të vitit 1903 ende e gjejmë në Paris, ku me ndihmën e zhurnalistit francez Parzhienis, bashkëpunëtor i “Agence Fourner”, mban një varg konferencash dhe boton një seri artikujsh në gazetë franceze mbi gjendjen në Shqipëri dhe në Perandorinë Osmane. Në qershor të vitit 1903 merr pjesë në një kongres në Napoli, por me kusht që me të mbaruar kongresi, të largohet nga Italia. Ka gjasë se prej këtu shkoi në Gjenevë, ku botoi broshurën “Vrasja e Xhavit begut, të birit të Rifat pashës” (Gjenevë, 2 shtator 1903), si dhe broshurën “Kali-fati i rrejshëm i sulltan Hamitit”. Me iniciativën e Princ Albert Gjikës dhe Faik Konicës, më 1904 shkoi në Londër për të marrë pjesë në një kongres armeno-maqedonas, si përfaqësues i interesave shqiptare dhe të përpiqet të vë bashkëpunim me ta, por u kthye i zhgënjyer, sepse konstatoi se puna ishte për një tubim të organizuar nga bullgarët me qëllime revolucionare-terroriste. Prej këtu u kthye në Gjenevë, nga ku, më 12 shtator 1904, nga redaksia e përkohshme e gazetës “Albania” i dërgoi një memorandum Pashiqit. Atëherë ai e shkroi memorandumin pasi që Pashiqi i kishte urdhëruar ambasadorit serb në Paris,

dr. Vesniq, që të binte në kontakt me Himën. Në Gjenevë Hima u njoftua me Leninin dhe u miqësua me të.

Këtë luftë D. Hima e vazhdoi deri në revolucionin xhonturk, kur u kthye në Shqipëri me flamurin e parë shqiptar, siç e vërtetojnë Konica dhe Lehova. Menjëherë e filloi agjitacionin për hapjen e shkollave dhe realizimin e kërkesave shqiptare për emancipimin politik dhe kulturor. Në shtator të vitit 1908, me rastin e një banketi në Shkodër, Hima mbajti një fjalim që ishte në kundërshtim me politikën xhonturke. Këtu e burgosën dhe e dënuan 8 muaj dhe e çuan në Selanik. Në burg shkroi turqisht broshurën “Një jehonë nga burgu në periudhën e lirisë”, të cilën ia kushtoi “Rinisë liridashëse shqiptare”. Kjo është ndoshta akuza e parë e politikës xhonturke ndaj shqiptarëve. Në sajë të ndërhyrjeve të Temos, i cili ishte kthyer në Turqi dhe disa miqve të tjerë, në burg qëndroi vetëm katër muaj. Në raportet e konsujve austriakë të asaj kohe, Temo përmendet si njeriu më popullor shqiptar. Me qëllim që ta largojë nga Shqipëria, qeveria xhonturke i ofroi detyrën e konsullit të përgjithshëm të Tiflies ose të valiut në Kastamuni, por ai refuzoi. Ndër të gjithë njerëzit e politikës së asaj kohe, Dervish Hima i pati, ndoshta, qëllimet politike më të qarta dhe më të përcaktuara: autonomia shqiptare, ngritja kulturore e popullit, zgjimi kombëtar, por jo vetëm i masave, por edhe i bejlerëve dhe i deputetëve në parlament, të cilët i kishte zënë një gjumë letargjik dhe, në fund, ngritja e ekonomisë së Shqipërisë. Pas daljes nga burgu, bëri udhëtime nëpër vende të ndryshme dhe kudo u prit triumfalisht. Sipas disa burimeve, mori pjesë në Kongresin e Dibrës në fund të korrikut 1909. Në fillim ishte anëtar i klubit “Bashkimi” të Selanikut, por duke mos u pajtuar me Lumo Skendon, për të cilën gjë flasin edhe dokumentet austriake, u angazhua rreth aktivitetit të klubit “Bashkimi i kombit” të Manastirit. Mori pjesë në Kongresin e Elbasa-

nit, të mbajtur në gusht të vitit 1909, ku luajti një rol me rëndësi. Në dhjetor të vitit 1909 D. Himën e gjejmë në Stamboll, ku më 31 dhjetor 1909 doli numri i parë i gazetës së përjavshme “Shqiptari” (Arnavud), në gjuhën shqipe dhe turke. Drejtor i gazetës ishte D. Hima, kurse redaktor Hilë Mosi. Në edicionin e gazetës “Shqiptari”, kah fundi i vitit 1910 doli “Shqiptari i ilustruar” (Mûsavver Arnavud), gjysma në gjuhën shqipe dhe gjysma në gjuhën turke – materiale tepër interesante, sidomos pjesa turke. Më 20 mars 1910 filloi Kongresi i dytë i Manastirit, i cili vazhdoi punën gjatë dhjetë ditëve. Kongresin e hapi dhe fjalimin zyrtar e mbajti Dervish Hima, i cili midis tjerash tha: “Në këtë mbledhje ne nuk përfaqësojmë vetëm klubet që na kanë dërguar delegatë; ne përfaqësojmë gjithë Shqipërinë. Jemi mbledhur të bisedojmë mbi nevojat tona kombëtare, për diturinë, për lulëzimin e gjuhës sonë dhe për mbrothësinë e kombit shqiptar.” Pasi vuri në pah kontributin e shqiptarëve në revolucionin xhonturk dhe premtimet e xhonturqve, Dervish Hima vazhdoi: “Turqit e rinj na i harruan të mirat tona. Kur ishte Hamiti në fron, nuk na linin të tregoheshim si komb, nuk na linin të mësonim gjuhën tonë. Ata që përdornin gjuhën shqipe, burgoseshin atje ku piqet buka në diell... Ne sot jemi rrethuar prej rreziqeve: Bullgaria, Serbia, Greqia, kërkojnë ngatërresa që të na gllabërojnë. Ne mund të shpëtojmë vetëm po të edukohemi në gjuhën tonë... Ne shqiptarët kemi nevojë të madhe për mësonjëtorë; meqenëse qeveria nuk na ndihmon, prandaj themeluan shoqërinë *Parparimi*, që të ndihmojë disa mësonjëtorë. Ta mbrojmë gjuhën tonë të dashur, se pa gjuhën tonë shqipe humbëm... armiqtë na kanë çelur luftë në fushën e shkronjave – ne do t’i mbajmë shkronjat tona kombëtare me mish e me shpirt”.

Thamë se kah fundi i vitit 1910 Dervish Hima që i detyruar të pushonte botimin e gazetës “Shqiptari”. Ai u përpoq më

vonë që të marrë leje për vazhdimin e botimit të së njëjtës gazetë, por meqenëse s'ia arriti qëllimit, në maj të vitit 1911 filloi të botojë gazetën "Shkumbi". Në këtë kohë Hima është shqiptari të cilin e sulmojnë më së shumti qarqet reaksionare xhonturke dhe qarqet shqiptare të lidhura me politikën xhonturke. Kur u bë përçarja definitive e udhëheqjes xhonturke dhe e udhëheqjes përparimtare shqiptare, Dervish Hima e la Stambollin dhe arriti në Shqipëri që ta organizojë popullin për ngjarjet e ardhshme vendimtare. Nga këtu sigurisht do të ketë shkuar në Bukuresht, sepse A. Xhuvani përmend një takim të tij me Fan Nolin, Luigj Gurakuqin dhe Dervish Himën në Bukuresht në dyqanin e Pandeli Evangjelit. Në mars të vitit 1912 atë e gjejmë në Manastir, nga ku e nisi agjitacionin për zgjedhjet parlamentare për sesionin e dytë. Duke shtegtuar, me vete e mbante listën e kandidatëve me biografite të tyre. Gjatë disa muajve vizitoi gati të gjitha qytetet e Shqipërisë. Këtë listë ai e kishte paraqitur përpara Komitetit shqiptar të Stambollit, mirëpo xhonturqit e penguan zgjedhjen e patriotëve shqiptarë. Në korrik të vitit 1912, bashkë me bashkëpunëtorin e vet Hilë Mosin, atë e gjejmë në Vilajetin e Janinës. Shkoi deri në Korfuz, ku bënte përgatitje për kryengritjen shqiptare. Në kryengritjen shqiptare në gusht të vitit 1912 ai i udhëhoqi kryengritësit në rrethin e Manastirit dhe të Ohrit. Sipas raporteve austriake, me rastin e shpalljes së pavarësisë më 1912 në Vlorë, aty mori pjesë edhe Dervish Hima, bashkë me Hilë Mosin, por ne nuk kemi mundur ta vërtetojmë këtë lajm.

Gati me siguri mund të vërtetojmë se në fillim të vitit 1913 Dervish Hima ndodhet në Vjenë, ku me 8 janar 1913, në gazetën e njohur vjeneze "Neue Freie Presse" boton një artikull mbi Shkodrën, gjë që e shtyri *ballkanikusin* (Dr.Stojan Protiq) ta shkruajë librin e vet "Albanski problem i Srbija i Austroun-

garska”. Dy muaj më vonë, nga 1-3 mars 1913, në Trieshtë mbahet një kongres i madh shqiptar, ku marrin pjesë afër 300 delegatë. Nëse mund t’i besojmë Nikollë Ivanajt (Historia e Shqipërisë së re, pjesa e parë, Tiranë, 1943), në këtë kongres Konica dhe Dervish Hima “e kanë patur rolin e kapadaive diktatorë”. Por, megjithatë Ivanaj me plotë krenari përmend se kishte pasur korrespondencë me Faik Konicën, Dervish Himën, Shahin Kolonjën dhe Fan Nolin. Deri në vitin 1915 Hima mbetet në Vjenë, nga ku “në kushte të disfavorshme – siç shkruan në një letër dërguar konsullit të përgjithshëm austriak në Shqipëri, Raportit – e lëshon Vjenën dhe arrin në Sofje”. Në një varg arktikujsh botuar në “L’echo de Bulgarie”, organ i qeverisë bullgare, Hima lufton haptazi për fitoren e fuqive qendrore dhe i sulmon aleatët. Kjo nuk duhet të na çudit, sepse Hima qysh me kohë kishte qenë i lidhur me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë dhe ushqente shpresa të mëdha tek Austro-Hungaria. Në vjeshtë të vitit 1917 organet austriake në Shqipëri e emërojnë Himën inspektor shkollash, për qarkun e Tiranës. Në fillim të vitit 1918 në Elbasan formohet “Shoqëria letrare”, në të cilën marrin pjesë Aleksandër Xhuvani, Lef Nosi, Dervish Hima, Dervish bej Elbasani, Aqif pashë Elbasani e të tjerë. Pas kësaj kohe kemi të dhëna të pakta për Himën. Dihet vetëm se në kohën e Zogut ishte shef i zyrës së shtypit. Vdes më 21 maj 1928, pas një viti me radhë lëngimi. Në të gjitha shkrimet e atëhershme ai vazhdimisht përmendet si Veterani D. Hima.

Veprat e Himës (Bibliografi provizore):

1) *Cinayet-i seniyyeden bir levha* (Një pasqyrë mbi krimin e sulltanit),

2) *Ûmid-i Ikaz Besabesadadır* (Shpresa e shpëtimit është te besa-besa),

3) *Uyanalim* (Të zgjohemi),

- 4) *Çare-i Necat* (Medikamenti i shpëtimit),
- 5) *Sultan Hamid ve Seyh Hamdinin vak'a-i sehadeti* (Sulltan Hamiti dhe ngjarja e vdekjes martire e Sheh Hamdiut),
- 6) *Müslûman Arnavudlara beyanname-i ser'i* (Proklamatë ligjore shqiptarëve muslimanë),
- 7) *Makber-i Ahrar* (Varri i liridashësve),
- 8) *Sadrazam Halil Rif'at pasaoglu Cavit bey'in katli* (Vrasja e Xhavit beut, të birit të sadrazem Rifat Pasha),
- 9) *Hamidin yalanci Halifligi* (Kalifati i rrejshëm i Hamitit),
- 10) *Sark Mes'elesine bir nazar* (Një shikim në çështjen lindore),
- 11) *Harem-i Hûmayun Arnavutlar* (Haremi i sulltanit dhe shqiptarët),
- 12) *Arnavut Gani Bey'in hakiki katili ve vesait-i katli* (Vrasësi i vërtetë i shqiptarit Gani beu dhe mënyra e vrasjes),
- 13) *Sultan Hamid ve Ermenlilerin katli âmi* (Sulltan Hamiti dhe vrasja e përgjithshme e armenëve),
- 14) *Sultan Hamid ve Sarayda Falciligin Terekkisi* (Sulltan Hamiti dhe përparimi i fallxhorit të Sarajit),
- 15) *Kurûn-i sâbika mesahir-i zalimanile Abdûl Hamidin mûkayese-i efâl-i tarihiyyesi* (Krahasimi i veprave historike të sulltan Hamitit me zullumqarët e famshëm të shekujve të kaluar),
- 16) *Timarhane mi? Saray mi?* (A është stallë? A është saraj?),
- 17) *Sultan Hamidin Mezari* (Varri i sulltan Hamitit),
- 18) *Ahmed Celal pasa ve genç Tûrkler* (Ahmet Xhelal pasha dhe turqit e rinj),
- 19) *Efendi ve ben* (Zotëriu dhe unë),
- 20) *Devr-i Hûrriyyette zindanadan bir Sada* (Një jehonë nga burgu në kohën e Hyrijetit),
- 21) *Mûsavver Arnavud* (Shqiptari i ilustruar),

Nga veprat e lartpërmendura, një pjesë kemi pasur rastin t'i shohim, ndërsa një pjesë jo. Mund të ndodhë që ndonjëra nga këto vepra është paralajmëruar nga Hima se do të botohet e të mos jetë botuar.

Gazetat dhe revistat e redaktuara nga shqiptarët ose ato në të cilat me siguri kanë bashkëpunuar shumë shqiptarë. – Pa dyshim numri i publicistëve shqiptarë, madje edhe i letrarëve, do të jetë shumë më i madh nëse do të kontrollonim një varg gazetash dhe revistash të cilat kanë filluar të botohen me shumicë, me përjashtim të disa gazetave të Stambollit dhe organeve të vilajetit, pas revolucionit xhonturk. Disa nga këto gazeta qenë botuar vetëm turqisht në Shkup, Manastir, Janinë, disa u botuan në Stamboll ose në vendet tjera, kryeredaktorët e të cilave ishin shqiptarë, e disa botoheshin shqip e turqisht drejtuar gjithashtu nga shqiptarët. Pjesa turqisht e këtyre gazetave nuk është kontrolluar nga kurrkush, e kontrollimi është i domosdoshëm, sepse ne kemi raste që shumë shqiptarë ishin të aftë të shkruajnë turqisht, por jo edhe shqip. Edhe një gjë: asokohe numri i shqiptarëve që dinin të lexonin turqisht ishte më i madh se sa i atyre që dinin të lexonin shqip. Nëpër këto gazeta apo revista ne kemi shumë artikuj mbi shqiptarët, ngjarjet e ndryshme në *Arnautllëk*, mbi politikën xhonturke ndaj shqiptarëve – të dhëna që shpesh nuk mund t'i gjejmë në asnjë vend tjetër. Mjafton nëse themi se ne ende nuk dimë gjë mbi përmbajtjen e gazetës “Shqiptari”, të Dervish Himës, e artikujt polemizues me xhonturqit Hima i shkruante turqisht e jo shqip. Ne këtu do të numërojmë disa publicistë dhe disa gazeta e revista, pa pretendime që të japim të dhëna bibliografike komplete për to apo mbi fizionominë e tyre, me të cilat me siguri bashkëpunuan shumë shqiptarë, vetëm për të provuar se sa duhet gjurmuar në këtë drejtim:

Kosova – organ i Vilajetit të Kosovës,
Iskodra – organ i Vilajetit të Shkodrës,
Yanya – organ i Vilajetit të Janinës,
Bashkim (1909-1910) – drejtor përgjegjës M. Shani Tepe-
 lena – dy faqe shqip e dy turqisht,

Alem – Journal humoristique et satirique paraissant le Jeu-
 di. Directeur Arif de Yacovo, kurse tuqisht: Yakovalizade Arif.
 Pra, këtë revistë humoristike e redaktonte njëfarë Arif Gjakova.

Sûngû – botohej në Manastir, kryeredaktor Zija Mati, tur-
 qisht,

Intibah – revistë letrare, botohej në Janinë, turqisht,
Saika (Rrëfeja) – numri i parë doli më 20 shkurt 1909, pro-
 nar dhe kryeredaktor Mehmet Naxhi Gjyrokastri (Er-girili),
 turqisht,

Firtina – kryeredaktor dhe drejtor Ahmet Xhevdet Gjyro-
 kastri. Në një numër janë botuar dy artikuj mbi shqiptarët
 dhe xhonturqit, turqisht,

Shqiptari (Arnavut) – drejtor Dervish Hima, redaktor i
 pjesës shqipe Hilë Mosi; dy faqe shqip e dy faqe turqisht,

Besa – redaktor Mehmet Frashëri, drejtor M. Shani Tepe-
 lena, shqip e turqisht,

Besa-Bashkim – gazetata “Besa” e “Bashkimi” qenë shkrirë dhe
 vazhduan të dilnin me titullin “Besa-Bashkim”, shqip e turqisht.

Dogru Söz (Fjala e drejtë) – pronar dhe kryeredaktor Arif
 Hikmeti. Botohej shqip me alfabetin arab dhe turqisht,

Shkumbi – pronar Kasim Frashëri, drejtor përgjegjës Salih
 Hikmet. Duket se filloi të botohej me iniciativën e Dervish
 Himës, pasi që gazeta “Shqiptari” u ndalua nga organet turke,
 shqip e turqisht,

Yûrek (Zemër) – drejtor përgjegjës Haxhi Ali Elbasani –
 botohej shqip me alfabet arab dhe turqisht,

Ars – botohej turqisht në Shkup,
Kasatura – botohej në Manastir, turqisht,
Neyyir-i Hakikat – botohej në Manastir turqisht,
Uskûp (Shkupi) – drejtor Jashar Erebara, botohej shqip e turqisht; pjesën turke kurrkush s’e ka kontrolluar,
Vatan – botohej në Manastir turqisht,
Yeni mekteb (Shkolla e re) – botohej turqisht në Manastir,
Yildiz (Ylli) – botohej turqisht në Shkup,
Zülal-i Irfan – gazetë shkencore, politike, letrare, shoqërore; drejtor Mustafa Ruhi; botohej turqisht në Janinë etj.

Duke i përmendur të gjitha këto gazeta e revista, numri i të cilave është shumë më i madh, duam të theksojmë se sa vështirë është çështja e studimit të kulturës sonë kombëtare, nga një anë, dhe, nga ana tjetër, se ne, në gjurmimet tona, e kemi thjeshtëzuar krejtësisht çështjen – përmendim vetëm Jashar Erebarën, Himën, Shahin Kolonjën e mendojmë se puna ka marrë fund. E, sa mund të jetë numri i bashkëpunëtorëve shqiptarë vetëm në gazetatat dhe revistat që i përmendëm? Çfarë materiali mund të gjendet në to? Kurrkush s’e di!

VII. LETËRSIA E MEMOAREVE

Në shekullin XIX në letërsinë turke kemi një literaturë shumë të zhvilluar të memoareve, e cila vazhdon deri më sot. Pashallarë të ndryshëm, vezirë të mëdhenj, komandantë në fronte të ndryshme, ambasadorë etj. i kanë botuar memoaret e tyre. Edhe sot kjo gjini e letërsisë është në Turqi shumë popullore – ndoshta edhe për arsye sentimentale – kujtime nga e kaluara e madhe historike. Midis autorëve të kësaj letërsie kemi edhe disa shqiptarë, memoaret e të cilëve i dedikohen periudhës xhonturke dhe aktivitetit të komitetit xhonturk “Bashkim e përparim” dhe lirisht mund të thuhet se këto memoare janë ndër më të rëndësishmet për ndriçimin e kësaj periudhe. Këta janë Dr. Ibrahim Temo, Nijazi Resna dhe Syreja Vlora.

Dr. Ibrahim Temo. – Duke folur për publicistët shqiptarë, ne e përmendëm edhe dr. Ibrahim Temon, por nuk u ndalëm të flasim më gjatë për të, për shkak se së shpejti do të dalë nga shtypi një punim i ynë i gjatë kushtuar Temos. Prandaj edhe këtu nuk do të flasim mbi biografinë e tij, por do të ndalemi vetëm te memoaret dhe do t’i përmendim edhe veprat e tjera të Temos, se kjo është hera e parë që përmenden të gjitha veprat e botuara të Temos.

Memoaret e Temos mbajnë titullin: *Ittihad ve Terakki Cemiyetinin Tesekkülü ve Hidemat-i vataniye ve inkilâbi millîye dair Hatiratim* (Formimi i shoqërisë “Bashkim e përparim” dhe kujtimet e mia mbi shërbimet patriotike dhe mbi revolucionin kombëtar) Mecidiye, 1939, f.303. Memoaret e Temos fillojnë me vendlindjen e tij, “Strugën e bukur”, dhe mbarojnë me

vitin 1935, ndërkaq rëndësi kryesore iu kushtohet ngjarjeve rreth themelimit, zhvillimit dhe ardhjes në pushtet të komitetit xhonturk “Bashkim e përparim”, të cilin e themeloi Temoja. Këto memoare nuk janë kujtime të thjeshta mbi ngjarjet në të cilat kishte marrë pjesë Temoja në mënyrë direkte dhe ishte një nga aktorët kryesorë, por edhe një dëshmi mbi një kohë, mbi një lëvizje e cila ia ndryshoi fatin Perandorisë Osmane dhe në një përmasë të madhe edhe fatin e popujve ballkanikë. Në këtë vepër Temoja botoi edhe një varg letrash. Vlera e këtyre memoareve është aq e madhe edhe për arsye se mbi fazën e parë të lëvizjes xhonturke thuajse nuk kemi një literaturë memoaresh. Prandaj, edhe sot memoaret e Temos citohen rregullisht si një burim me rëndësi në lidhje me ndriçimin e lëvizjes xhonturke.

Përveç memoareve të veta, Temoja shkroi edhe këto vepra ose themeloi këto gazeta:

1) *Sada-yi millet* (Jehona e popullit), gazetë që doli në Bukuresht, botimi i së cilës pas disa numrave pushoi.

2) *Isik* (Drita), gazetë botuar në Mexhidje të Rumanisë kah viti 1913, por nuk e dimë se sa kohë qe botuar, sepse kemi pasur në dorë vetëm një numër.

3) *Hareket* (Lëvizje), broshurë botuar më 1898 në Bukuresht, publikacioni i parë turk në Rumani. Broshura është një lloj manifesti xhonturk,

4) *Aile Tabibi* (Mjeku i shtëpisë), botuar në Stamboll kah viti 1894. Veprën nuk e kemi pasur në dorë, por atë e përmend Temoja në memoaret e veta.

5) *Tegaddi ve devam-i hayat* (Ushqimi dhe jeta e gjatë), vepër e botuar, por nuk kemi të dhëna mbi të,

6) *Tababet-i avâm ve Hifz-i sihhat* (Arsimimi shëndetësor i masave dhe ruajtja e shëndetit), vepër 96 faqesh, botuar në Mexhidje të Rumanisë më 1914.

7) *Conducatonul Conservatei* (Konverzacion turko-rumun), libër konverzacioni për ata që dinë turqisht e duan të mësojnë rumanisht, botuar në Mexhidije më 1914, 127 faqe,

8) *Elifba* (Abetare) – abetare për shkollat turke në Rumani, botuar në Mexhidije më 1915.

9) *Atatürkü niçin severim* (Përse e dua Ataturkun), broshurë 16-faqëshe botuar në Mexhidije më 1937. Në këtë broshurë Temo paraqet simpatitë e veta ndaj Ataturkut, duke theksuar se Ataturku ia realizoi ëndrrat atij, për të cilat luftoi si i ri.

Nijazi Resna. – Më 3 korrik 1908, kapiteni i ushtrisë turke dhe komandanti i batalionit të Resnjës, Nijazi Resna (Resneli Niyazi bey), doli në mal me batalionin e tij të përbërë nga 200 ushtarë, oficerë dhe disa civilë shqiptarë, me qëllim që të luftonte për rivendosjen e kushtetutës së vitit 1876, për heqjen e absolutizmit të Sulltanit, për “bashkimin” e të gjithë elementëve të Perandorisë, pa dallim feje e kombësie, nën parullën e osmanizmit të Sulltanit, ide e cila duhej t’i përfshinte dhe t’i bashkonte të gjithë. Kjo ngjarje, si dhe tubimi i Ferizajit një muaj më vonë, qenë faktorë kryesorë që çuan drejt revolucionit borgjez xhonturk më 23 korrik 1908. Në vitin 1910 Nijazi Resna i botoi memoaret e veta: *Kol Ağâsi Ahmed Niyazi, Hatirat-i Nyazi yahod Tarihçe-i Inkilab-i kebir-i osmaniden bir sahife* (Kujtimet e Nijaziut apo një faqe nga historia e revolucionit të madh osman), në të cilat e jep edhe biografinë e vet.

Nijazi Resna lindi në Resnjë më 1883. Sado që në memoaret e veta kurrkund nuk përmend se është shqiptar, por gjithnjë paraqitet si osmanlli, ide e cila dominonte midis xhonturqve, të gjitha burimet turke e marrin si shqiptar. Kështu, Shefqet Syreja Ajdemiri thotë: “Ja, ky Nijazi bej Resna është një osmanlli idealist me rrënjë dhe me plot kuptimin e fjalës. Sepse, pikësë-

pari, ai nuk është turk, ai është shqiptar. Por, ai nuk e numëronte veten shqiptar, por osmanlli.” Nga tre vëllezërit që ishin, dy morën rrugën e profesionit ushtarak. Shkollimin fillestar e kreu në Resnjë. Pastaj u regjistrua në Idadijen e Manastirit, por pas një kohe të shkurtër kaloi në gjimnazin usharak, ku gjithashtu kishin kryer edhe Enver pasha, edhe Qemal Ataturku. Në këto dy shkolla një ndikim të dukshëm ushtruan tek ai profesorët Brusali Mehmet Tahir, shkrimtar i njohur dhe autor i veprës së famshme “Osmanli Müellifleri” (Autorë osmanë) dhe një nga anëtarët më të rëndësishëm të komitetit ekzekutiv xhonturk të Manastirit, pastaj profesori i historisë Mehmet Teufiku, autor i veprës “Manastir Tarihçesi” (Histori e shkurtër e Manastirit), si dhe profesori i frëngjishtës, i cili iu fliste mbi Revolucionin francez dhe liritë demokratike. Me të kryer gjimnazin, u regjistrua në Akademinë Ushtarake në Stamboll, e cila, sipas fjalëve të tij, ishte e rrethuar me spiunë të ndryshëm, për shkak se tashmë dihej se pjesa dërrmuese e kadetëve ishin të përfshirë nga idetë antiabsolutiste. Me gjithë këtë, idetë përparimtare po depërtounin vazhdimisht, sa që ideja e nevojës së përmbyesjes së tërë sistemit u bë një obsesion i tij. Në vitin 1896 e kreu Akademinë Ushtarake të Stambollit dhe si togër u dërgua në një garnizon. Ende nuk kishte kaluar një vit kur shpërtheu lufta turko-greke. Nijaziu merr pjesë në këtë luftë, dallohet për trimëri dhe pas mbarimit të luftës gradohet dhe fiton edhe një dekoratë. Me këtë rast bindet edhe vetë se si gradoheshin dhe dekoroheshin fëmijët e pashallarëve të ndryshëm, të cilët as që merrnin pjesë në luftë. Pas mbarimit të luftës dërgohet si oficer furnizimi në Ohër, afër vendlindjes së tij. Në këtë detyrë mbetet deri më 1904. Meqenëse këtu kishte lidhje me të gjitha shtresat e popullit, të të gjitha kombësive, kishte mundësi që të njoftohej përditë se si vite me radhë bëheshin përgatitjet e popullit maqedonas

për kryengritje, se sa i madh ishte roli i bullgarëve, i misioneve ruse, i klerit ortodoks etj. Nga Ohri transferohet si komandant vendi në Resnjë, ku, sipas fjalëve të tij, udhëheq luftën kundër komitëve, kështu që brenda një kohe të shkurtër e pastron këtë terren nga komitetë maqedonas (ai i quan bullgarë). I zhgënjyer gjithnjë e më tepër nga paaftësia e pushtetit, nga korrupcioni në ushtri, sidomos midis oficerëve të lartë, nga influenza e huaj në Maqedoni, ku pushteti turk s'mundte të zbatonte kurrfarë masash, ai bashkohet me organizatën xhonturke "Bashkim e përparim", e cila tashmë kishte përfshirë një numër të madh intelektualësh dhe shumë oficerë të rinj, një pjesë e të cilëve ishin shqiptarë. Më 3 korrik 1908 doli në mal me çetën e vet, në të cilën, sipas fotografive, një numër ishin shqiptarë me tesha kombëtare. Gjatë një muaji shtegtoi me çetën e vet nëpër Shqipërinë e jugut, krahinat e Ohrit, Prespës, Resnjës e të Dibrës, duke bërë propagandë për idetë xhonturke mbi bashkimin e të gjithë popullit, pa marrë parasysh fe apo kombësi, nën flamurin e osmanizmit. Gjatë kësaj periudhe ai nuk bëri kurrfarë lufte me fuqitë legale turke. Mu atëherë arriti në Manastir Shemsi pasha për ta ndjekur Nijazi beun, por një anëtar i komitetit xhonturk e vrau në Manastir, kështu që kjo vrasje e turbulloi edhe më tepër oborrin në Stamboll. Kur u shpall Hyrijeti, Nijaziu, si dhe çeta kombësish të tjera, hynë triumfalisht në Manastir. Nuk përfitoi gjë nga këto merita pas ardhjes në pushtet të xhonturqve, sado që kudo pritej si *Hero i lirisë* (Hürriyet Kahr-amani). Edhe pas revolucionit bëri një detyrë në Maqedoni. Sipas burimeve turke, Nijazi Resnën e vrau një njeri i Isa Boletinit më 1914 në Vlorë, kur ky kishte hipur në vapor për të shkruar në Stamboll. Burimet turke shtojnë se Isa Boletini e vrau për t'iu hakmarrë për vrasjen e Shemsi pashës, i cili ishte pobratim i Isa Boletinit, gjë që vërtetohet nga shumë burime turke.

Memoaret e veta N. Resna i fillon me një hyrje të gjatë, ku gjerësisht flet mbi gjendjen në Perandorinë Osmane, mbi korrupcionin në ushtri, degjenerimin e të gjitha institucioneve ushtarake, administrative e gjyqësore. Shkollimin e vet në Manastir dhe në Stamboll e jep në vija të përgjithshme, ndërsa diçka më tepër ndalet në ndikimet e ndryshme që lanë mbresa në shpirtin e tij. Pjesa kryesore e memoareve i kushtohet periudhës nga ardhja e tij në Ohër (1898), kalimi në Resnjë (1904) e deri te Revolucioni xhonturk më 1908. Këtu kemi mjaft të dhëna mbi përgatitjen e maqedonasve për kryengritje, mbi aksionet e komitëve maqedonas, serbë e bullgarë, mbi situatën e popullsisë muslimane të frikësuar nga këto aksione, si dhe mbi aksionet e tij në ndjekje të komitëve. Përshkrimet më të hollësishtme janë ato nga dalja e Nijazi beut në mal e deri te Revolucioni, ku e përshkruan çdo hap që kishte kaluar me çetën e vet. Këtu kemi mjaft të dhëna mbi disponimin e popullsisë shqiptare ndaj lëvizjes xhonturke, vizitat në fshatra të ndryshme, përpjekjet që të takohet me Çerçiz Topullin në Shqipërinë e jugut etj. Memoaret shoqërohen me shumë letra dërguar Komitetit xhonturk në Manastir dhe të Komitetit dërguar Nijazi beut, proklamata të lëshuara popullit mbi qëllimet e daljes së tij në mal, përkthime proklamatah shkruar në gjuhën bullgare, memorandumit e komitetit xhonturk në Manastir, letra të dërguara autoriteteve të ndryshme, telegramet e Shemsi pashtës dërguar nga Manastiri në Stamboll etj. Gjatë përshkrimeve, kemi të dhëna mbi shumë persona nga këto vise, pastaj mbi çetat e tjera të ushtrisë që kishin dalë në mal, si ajo e Osman efendiut nga Prespa, Muhjiddin Janinës, mbi shumë shqiptarë që kishin qenë në çetat e ndryshme, si Adem beu në çetën shqiptare të Çerçiz Topullit, Zunnunini nga Dibra, si dhe mbi dy çeta shqiptare në katundet e Dibrës: të Emin Piso-

çanit dhe të Kurtish Novosellës, të cilët kishin nga 30 veta me vete. Në fund jep përshkrimin e hyrjes triumfale të çetës së tij dhe të Ejub Sabriut, oficer nga Ohri, i cili do të luajë një rol me rëndësi edhe në Kongresin e Dibrës më 1909, në Manastir me 10 korrik. Pas tyre, më 11 korrik, hyjnë edhe çetat e kombësive të tjera, midis të cilave edhe ajo e Çerçiz Topullit dhe e Adem beut me 30 vetë.

Në letërsinë e memoareve jo të shumta kushtuar këtyre ngjarjeve, në të cilat Nijazi beu ishte faktor me rëndësi, memoaret e tij zënë një vend të posaçëm për ndriçimin e ngjarjeve të turbullta në vigjiljen e Revolucionit xhonturk.

Memoaret e *Xhelaledin pashë Vlorës*. – Më 1970 publicisti turk Samih Nafiz Tansu botoi një libër me titull: *Medaliyanin tersi. Anlatan: Sadrazam avlonyali Ferid pasa'nin oglu Gelaleddin pasha (Vlora)* (Ana tjetër e medaljes. Rrëfen: Xhelaledin pashë Vlora, i biri i vezirit të madh Ferid pasha). Siç shihet nga vetë titulli, Xhelaledin pasha ishte i biri i Ferid pashë Vlorës (1903-1908). Xhelaledin pasha ishte nëpunës në Ministrinë e Jashtme. Në vitin 1909 ishte sekretar i dytë në Paris, pastaj nëpunës i lartë i Vilajetit të Rumelisë. Më 1913 martohet me të bijën e Hidiv Abas Hilmi pashës, prej së cilës, pas 9 vjetësh, ndahet. Ka gjasë që pas ardhjes së Qemal Ataturkut nuk kishte jetuar në Turqi, por nëpër Evropë, një kohë edhe në Shqipëri, pastaj në Zvicër e në fund në Egjipt. Nga Egjipti e përjashtoi Naseri dhe vjen në Turqi, ku i jep memoaret e veta. Memoaret janë interesante për ndriçimin e jetës dhe të karrierës së të jatit, Ferid pashës, dhe mund të shërbejë si shembull mbi degjenerimin e një familjeje të madhe bejlerësh, siç ishin Vlorianët. Natyrisht se ka edhe shumë të dhëna interesante mbi oborrin e Sulltanit, rolin e shqiptarëve në të etj.

Këtu duhet rikujtuar edhe memoaret tashmë të përmen- dura të *Syreja Vlorës* “Hatirat ve Teracim-i Ahval”, si dhe kujt- imet e *Kazim Nazim Duru* “Arnavutluktan ve Makedonyadan hatiratim”, Stamboll, 1959 (Kujtimet e mia nga Shqipëria dhe Maqedonia). Kazim Nazim Duru, për të cilin unë kujtoj se është shqiptar, por nuk kam kurrfarë prove, ishte për një kohë të gjatë, përpara dhe pas Revolucionit xhonturk, me shërbim në Maqedoni si oficer. Ai kishte për detyrë edhe ta ndiqte Çer- çiz Topullin dhe çetën e tij. Por, nuk jam krejt i sigurt se a është shqiptar ose jo. Sidoqoftë, memoaret e tij janë me rëndësi për ndriçimin e asaj periudhe të historisë së këtyre vendeve.

PËRFUNDIM

Kjo pasqyrë e shqiptarëve në letërsinë turke dhe në disiplinat e ndryshme shkencore, sado që e mangët, provon mbi një inkorporim të madh të shqiptarëve në kulturën orientale. Sikurse thamë në fillim, ne këtu nuk mundëm t'i përmendnim të gjithë autorët, midis të cilëve kemi një numër të madh të atyre për të cilët nuk jemi të sigurt se a janë shqiptarë ose jo; pastaj kemi një numër të tyre për të cilët i dimë vetëm emrat dhe veprat e mbetura në dorëshkrim, ndërsa për disa kemi vetëm disa të dhëna biografike, por nuk i dimë veprat. Kjo pasqyrë do të zgjerohet sidomos pas gjurmimeve në terrenin tonë. Po kështu kemi disa shënime për disa shkrimtarë të cilët janë dalluar edhe në letërsinë arabe, siç është p.sh. Ma'lûf al-Arnaûati, një nga pionierët e letërsisë moderne arabe të Sirisë nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Gjurmimet e mëtejshme me siguri do të nxjerrin në dritë edhe një varg emrash. Thamë se ne kemi ndër mend që këtë punim ta zgjerojmë në disa drejtime: të japim shënime më të shumta për ata për të cilët kemi të dhëna, të japim biografinë complete të veprave të tyre, shënimet nga katalogjet dhe bibliotekat në të cilat ndodhen dorëshkrimet e tyre, si dhe literaturën complete të burimeve të cilat flasin për çdo autor. Por, planet dhe dëshirat janë një gjë, ndërsa mundësitë e koha janë një gjë tjetër. Prandaj, edhe nëse nuk arrijmë ta kryejmë këtë punë, ky punim do të shërbejë si pikënisje për gjurmimet e ardhshme, kështu që kjo punë me të cilën hapim një rrugë të re në studimet e kulturës sonë do të mund të vazhdohet.

LITERATURA KRYESORE

Përveç dorëshkrimeve të ndryshme nëpër biblioteka, katalogjeve, librave të botuar, artikujve të ndryshëm nëpër revista, të cilat nuk i kemi cituar që të mos e ngarkojmë punimin me një aparaturë të madhe, si literaturë kryesore na kanë shërbyer këto vepra:

- 1) Semseddin Sami (Frashëri), *Kamûs al-a'lâm*, I-VI, Istanbul, 1899.
- 2) *Islam Ansiklopedisi*, I-XIII.
- 3) Mehmed Sureyya, *Sicill-i Osmani*, I-IV, Istanbul, 1890-1893.
- 4) Bursali Mehmed Tahir, *Osmanli Müellifleri*, I-III, Istanbul, 1915.
- 5) Mahmud Kemal Inal, *Son Asir Türk Sairleri*, I-15.
- 6) Franz Babinger, *Die Geschichtschreiber der Osmanen und-ihre Werke*, Leipzig, 1927.
- 7) Joseph von Hammer, *Geschichte der osmanischen Dichtkunst*, I-II, 1836.
- 8) Gibb, A History of Ottoman Poetry, I-IV, London, 1902.
- 9) Alessio Bombaci, *La litteratura turca*, Milano, 1969.
- 10) Ismail Hakki Uzunçarsili, *Osmanli Devletinin Ilmiye Teskilati*, Ankara, 1965.
- 11) *Ibniye Sâlnamesi*, Istanbul, 1334.
- 12) *Katib Çelebi Keshf adh-dhunun*, I-II, Ankara, 1941.
- 13) Baba Rexhepi, *Misticizma islame dhe bektashizma*, New York, 1970.
- 14) Sadeddin Nüzhet Ergin, *Bektasi sairleri*, I-II.
- 15) Hadayiku-Sekayik, Istanbul, 1969.
- 16) *Teshkiret* (biografitë) e poetëve nga Latifi, Ashik Çelebi, Salimi etj.
- 17) Dr. Adnan Adivar, *Osmanli Türklerinde ilim*, Istanbul, 1970.
- 18) *Mustakim-zade Suleyman*, *Devhatü l-mesayih*, Istanbul, (-).
- 19) Teza doktorate (asistentura) në *Turiyat Enstitüsü*.
- 20) Hasan Kaleshi, *Prizren kao kulturni centar turskog perioda*, Gjurmime albanologjike, 1/1965.

PASTHËNIE

Hasan Kaleshi (1922-1976)

-Vështrim i shkurtër mbi jetën dhe veprën -

Prof. dr. Hasan Kaleshi është një ndër orientalistët më të njohur shqiptar dhe ballkanas. U lind më 7 mars 1922 në fshatin Serbicë, rrethina e Kërçovës, në Maqedoni. Rrjedh nga një familje fetare, ku edhe i mori themelet fillestare të edukatës dhe të arsimimit. Babai i tij, Ahmet efendiu, që nga moshja gjashtëvjeçare ka filluar t'ia mësojë të birit Hasanit shkronjat e Kur'anit dhe mësimet e para islame. “Kjo”, thotë Hasani, “ka zgjuar tek unë dashurinë ndaj botës arabe, ndaj kulturës dhe këtij civilizimi.” Kjo dashuri e parë ka bërë që Hasani gjatë tërë jetës së tij të mbetet i lidhur me Lindjen Islame.

Hasani shkollën fillore e kreu në fshat, kurse gjashtë vitet e gjimnazit në Medresenë e Madhe të Shkupit. Në këtë kohë filloi Lufta e Dytë Botërore, për shkak të së cilës Hasani e ndërpret shkollimin. Mësimet i vazhdoi në gjimnazin e Prishtinës, ku maturoi në vitin 1944. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore Hasani studimet i vazhdoi në Beograd, në Fakultetin Filozofik, në Katedrën e Orientalistikës, ku diplomoi në vitin 1951. Gjatë studimeve ai tregoi sukses në mësimet, e veçmas në mësimin e gjuhëve të huaja. Kjo e shtyri edhe dr. Fehim Bajraktareviqin, orientalistin e mirënjohur jugosllav, që ta angazhojë Hasanin për asistent në Katedrën e Orientalistikës. Ishte ky viti 1952. Gjatë tetë viteve vijuese punoi si asistent. Në vitin 1960, pas një pune të zellshme, Hasani me sukses e mbrojti temën e doktoratës me titull “Dokumentet më të vjetra vakëfore në Jugosllavi në gjuhën arabe”.

Gjatë vitit akademik 1966-1967 Hasan Kalessi specializoi turkologjinë në Hamburg. Prej vitit 1967 e deri në vitin 1970 punoi në Institutin Albanologjik në Prishtinë, në cilësi të bashkëpunëtorit të lartë shkencor. Jeta e tij e gjallë shkencore, prej vitit 1970 e solli në detyrën e profesorit të rregullt në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, në Katedrën e Historisë, ku punoi deri në vitin 1973. Këtë vit në kuadër të Fakultetit Filozofik u hap Katedra e Orientalistikës; pa dyshim, me meritën më të madhe të Hasanit, i cili njëherit u zgjodh shef i Katedrës dhe arsimtar i rregullt i saj për arabisht dhe turqisht. Këtu punoi deri më 19. 7. 1976, kur befasisht ndërroi jetë në moshën 54-vjeçare. Kjo datë që një humbje e madhe për këtë katedër të re dhe me arsimtarë të rinj e të papërvojë profesionale dhe shkencore, por edhe për opinionin e gjerë shkencor.

Do theksuar se Hasani disa vite me radhë që ligjërues në disa universitete të Evropës, ku u mirëprit dhe zgjoi interesim të caktuar.

Gjallëria dhe ambicioziteti, pastaj themelësia në punë, nga një anë, dhe njohja e shumë gjuhëve botërore (arabisht, turqisht, latinisht, italisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, pastaj boshnjakisht, maqedonisht dhe gjuha shqipe si amtare), nga ana tjetër, bënë që Hasani të inkuadrohet në botën e shkencës dhe të radhitet në rangun e shkencëtarëve të merituar.

Nga shkrimi i tij i parë në 1949, të botuar në “Jeta e Re”, e deri në vdekje Hasani ka publikuar mbi 300 shkrime nga më të ndryshmet, shumica e të cilave ka zgjuar vëmendjen e opinionit shkencor. Në periudhën e dytë të jetës së tij si krijimtar, Hasani kryesisht u orientua në historinë kulturore të popujve të Ballkanit e të Lindjes dhe në raportet reciproke mes këtyre kulturave dhe qytetërimeve, e sidomos mes Lindjes Islame dhe popullit shqiptar, serb e maqedonas. Ka shkruar në disa gjuhë:

shqip, boshnjakisht, maqedonisht, turqisht, gjermanisht, frëngjisht etj. Njohja e të gjitha këtyre gjuhëve dhe puna vëllimore shkencore bënë që zëri i Hasan Kaleshit të dëgjohet në vend dhe jashtë. Kështu, ai mori pjesë në disa simpoziume në vend, kurse jashtë vendit në disa tubime ndërkombëtare: Stamboll, Sofje, Bukuresht, Bratisllavë, Napoli, Munih, Paris, Çikago etj.

Pa tendencë që disa shkrime të Hasanit t'i mbivlerësojmë e disa të tjera jo, do t'i theksojmë disa nga ato që në këtë çast kanë një peshë të caktuar në aspektin kulturo-historik të të kaluarës sonë nacionale islame.

Është për t'u veçuar puna e Hasanit si redaktor shkencor në vëllimin II të *"Katalogut të dorëshkrimeve arabe, turke dhe persiane"* në bibliotekën e Gazi Husref-beut në Sarajevë. Mirëpo, vdiq para se ky vëllim të botohej.

Me rëndësi është edhe studimi i tij me titull *"Letërsia shqiptare me alfabet arab"*, botuar në Vjetarin e Institutit Ballkologjik të Sarajevës më 1956.

Studimi mjaft informativ i tij *"Prizreni si qendër kulturore gjatë periudhës turke"* gjithashtu është me rëndësi në këtë fushë, ndërsa është botuar në *"Gjurmime albanologjike"* 1/1962.

Si koautor me Ismail Rexhepin, më 1960 në POF të Sarajevës (XIII-IX) bëri përkthimin kritik të *Vakëfnames së Kuklibeut*, një ndër vakëfet dhe personalitetet më të mëdha të kohës së tij.

Nuk mund të shkruhet a të flitet për Hasanin e të mos përmenden dy veprat e tij më kapitale:

1) *"Dokumentet më të vjetra vakëfore në Jugosllavi në gjuhën arabe"*, botuar në Prishtinë më 1972, fq. 356. Kjo vepër paraqet temën e tij të disertacionit, të mbrojtur më 1960, dhe është kontribut i konsiderueshëm në shkencën e historiografisë sonë, si në aspektin metodologjik të shtrimit të temës, ashtu dhe të vetë lëndës. Vepra përbëhet nga *Hyrja, Parathënia*, shta-

të kaptina dhe *Përfundimi*. Vepra është e pajisur edhe me aparaturën shkencore (transkriptimin, burimet, literaturën, regjistrin e emrave gjeografikë e topografikë dhe regjistrin e emrave personalë). Fatkeqësisht, vepra është botuar kaheërë, dhe në boshnjakishte, dhe për lexuesin tonë është kryesisht e panjohur.

2) *"Fjalor serbokroatisht-arabisht"*, Sarajevë, 1988, fq.709 + XVI, është, mbase, kryevepra e tij në koautorësi me dr. Kamil Buhin, e botuar 12 vjet pas vdekjes së autorit. Fjalori është i pari i këtij lloji te ne dhe përmban mbi 50.000 fjalë dhe shprehje të ndryshme. Është e nevojshme që kompetentët të mendojnë rreth hartimit të fjalorëve të këtillë edhe në gjuhën shqipe, përkatësisht arabisht-shqip dhe shqip-arabisht. Kjo nevojë fiton në peshë kur sot ekzistojnë disa medrese, fakultete, katedra të orientalistikës e të tjera, nga një anë, dhe nevoja për përdorimin e saj në përkthime, diplomaci, tregti e të tjera, nga ana tjetër.

E fundit për çka dëshirojmë të shkruajmë në këtë rast është studimi me titull *"Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale"*, botuar në *Përmbledhje të ligjëratave të mbajtura në seminarin e vitit 1975*. Nëpërmjet nëntitujve: *Poezia, Poezia e teqeve, Historiografia, Disiplinat shkencore, Gramatologjia dhe leksikografia, Publicistika, Letërsia e memoareve*, Hasani, shkurtimisht, por qartë dhe konstruktivisht, i ka vënë bazat e një studimi monografik të kësaj teme. Përkatësisht, i ka përfshirë, kryesisht, të gjitha sferat e krijimtarisë diturore të proviniençës islame.

Përveç shkrimeve të publikuara, Hasani ka lënë pas vetes edhe shkrime të tjera, prej të cilave disa edhe të papërfunduara. Do ta përmendim vetëm librin universitar *"Antologji e letërsisë arabe"*, *libri I Proza*, por në mungesë të botuesit, vepra deri tash ka mbetur pa u botuar.

Çka na shtyri ta botojmë këtë vepër?

Kaherë kemi dashur që opinionit shkencor dhe atij të gjerë t'i ofrojmë një pasqyrë nga e cila do të shihej, së paku edhe shkurtimisht, se shqiptarët me përkatësi fetare muslimane kanë krijuar një kulturë të mirëfilltë dhe mjaft cilësore. Meqë deri në ditët e sotme nuk kemi pasur ndonjë studim monografik rreth kësaj teme, e pamë të udhës që studimin e Hasan Kaleshit "Roli i shqiptarëve në letërsitë orientale", të botuar dhe pothuajse të harruar tashmë para një dekade e gjysmë, ta nxjerrim në një dritë të re, si botim të veçantë. Ky kontribut ka për qëllim që të ofrojë pikëpamje dhe mbështetje për më të thirrurit që t'i përvishen punës për një paraqitje shumë më të plotë, më konstruktive e më analitike, të kësaj teme.

Besojmë se edhe institucionet përkatëse do ta përkrahin këtë ndërmarrje dhe se kjo temë më nuk do të radhitet ndër të "padëshiruarat", përkundrazi, do ta zë vendin meritator në trungun e përbashkët të kulturës sonë kombëtare.

Ç'të thuhet për fund?

Krijimtaria e Hasan Kaleshit është mjaft e pasur dhe e llojllojshme. Është e pamundur të shkruhet diç për krijimtarinë e shqiptarëve të provinencës muslimane dhe për temat e ngjashme e mos të konsultohet Hasan Kaleshi. Me punën e tij të palodhshme, ai ka lënë emër dhe gjurmë në historiografinë tonë kombëtare e fetare. Duke e marrë parasysh këtë, e shohim të udhës që të përmbliidhen në një vend shkrimet që ka lënë dhe me një shikim kritik të botohen veprat e zgjedhura të tij. Me këtë akt, më së miri do t'i falënderoheshim autorit (*rahmetullahi alejh*) për punën e tij, ndërsa brezave të rinj do t'u mundësonim të njiheshin me veprimtarinë mjaft interesante dhe produktive të Hasan Kaleshit. Amin!

Nexhat Ibrahim

Prizren, 9.3.1411/29. 9.1990

LITERATURA E KONSULTUAR:

1. Hasan Kaleši, *Prilog poznavanju arbanaske knjizevnosti iz vremena preporoda*, Godišnjak I. Balkanološkog Instituta, Naucno društvo BiH, Sarajevë, 1956, fq.352-387.
2. Hasan Kaleši, *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, fq.101-113.
3. Hasan Kaleši, i Ismail Rexhep, *Prizrenac Kukli-beg i njegove zaduzbine*, Separat nga POF, VIII-IX, 1958-1959, Sarajevë, 1960, fq.143-168.
4. Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale*, Seminari i kulturës shqiptare për të huaj, Përmbledhje e ligjëratave të mbajtura në seminarin e vitit 1975, 2, botim i Fakultetit Filozofik të Prishtinës, Prishtinë, 1976, fq.151-217.
5. Mahmud Traljic, *In memoriam*, Anali GHBB, VII-VIII, Sarajevë, 1982, fq.273-274.
6. Feti Mehdiu, *Prof. dr. Hasan Kaleši*, POF, XIV/1975, Sarajevë, 1977, fq.8-9.
7. Hasan Kaleši, *Najstariji arapski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku*, Prishtinë, 1972, fq.356 + 2.
8. Hasan Kaleši, *Srpsko-hrvatski rjecnik*, Sarajevë, 1988, fq.VI.

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në
Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

821.18(091)

KALESHI, Hasan

Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame / Hasan Kaleshi. -

Shkup : Logos-A, 2013. – faqe 120 ; 21 cm. - (Biblioteka Mendimi Islam)

Fusnota drejt tekstit – Bibliografija faqe. 119


978-9989-58-479-4

a) Letërsi Shqiptare - Histori

COBISS.MK-ID 93946634

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2013



LOGOS·A